

Polemikë në vend të replikës

Nga Astrit Kola

Pas shkrimit-replikë të z.Murat Basha ndaj shkrimit të z.Kastriot Myftaraj dhe pas replikës së këtij të fundit, botuar sërish në të përditshmen “TemA”, ndjeva detyrimin moral të përgjigjem me këtë shkrim polemik.

Them ‘polemik’, sepse që në fillim jam përpjekur dhe kam synuar ta ngrej debatin për çeshtjet dhe personazhet madhore në diskutim, drejt një polemike të vërtetë në rrafshin e ideve, fakteve historike, interpretimeve serioze dhe mendimit politik gjithëkohor, qoftë edhe për shkak të kapërcimit të saj të detyruar drejt thellësive kohore. Dhe për të krijuar kushte sa më të favorshme për një polemikë serioze, kam vendosur të shmang gjuhën e fyerjeve, e cila e ul atë në nivelin e një debati ordiner, ku argumentat ia lënë vendin denigrimeve dhe sharjeve, që nuk nderojnë askënd.

Zogistët nuk kanë pse të tremben

Që në fillim të shkrim-replikës së z.Myftaraj ndaj shkrimit të z.Basha, z.Myftaraj gabon kur thekson se “... zogistëve u ka hyrë paniku nga zbulimi i disa të vërtetave historike dhe bashkëkohore, mjaft të hidhura për ta”.

Unë, duke qenë në mes të zogistëve, nuk kam vënë re ndonjë panik pas botimit të shkrimeve të z.Myftaraj, përveçse shqetësimin për sulmet brutale në to, fyerjes së pamerituar e të rëndë ndaj idhujve dhe idealeve të atyre që gjithë jetën sakrifikuan dhe vuajtën, që prej 65 vjetësh, e që sot sulmohen pikërisht në një organ të cilin e kanë konsideruar deri vonë për të djathtë. Unë, personalisht, nuk i kam përjetuar sulmet në fjalë si zogistët, jo vetëm sepse nuk kam vuajtur e sakrifikuar si ata dhe sa ata, por sepse e kuptoj luftën politike dhe shkaqet që e ushqejnë e motivojnë atë. Madje, lartësimin e toneve dhe agresivitetin e sulmeve të befasishme, si në rastin në fjalë - e përkthej si panik të krahut të sulmonjësve dhe jo të të sulmuarve.

Ndërsa lidhur me shpалosjen e të vërtetave, zogistët shqiptarë, me ankth dhe emocion të justifikuar, kanë pritur përgjigje të kualifikuara, për të davaritur çdo konfuzion që lind natyrshëm në kësi rastesh, për të argumentuar dhe shterruar me skrupulozitet, vërtetësi historike dhe analizë politike e logjike tezat-akuzë, të imponuara nga një debat i panevojshëm e i padëshirueshëm, që fatkeqësisht e kapërceu skajshëm sensin e masës në të gjitha drejtimet.

Replika e z.Basha nuk dëshmoi kurrfarë paniku por, në të kundërt, dëshmoi pjekuri e maturi, qoftë në ofrimin e fakteve, qoftë në nivelin e lartë të artikulimit politik të koncepteve dhe ideve të lidhura me ngjarjet dhe personazhet në diskutim.

Por për arsye të gravitetit të problemeve dhe të rëndësisë aktuale të tezave të trajtuara, do të përpiqem të bëj një renditje të ndryshuar në analizën e tezave dhe në trajtesën polemike të

mëposhtme, pa anashkakuar asnjë moment të rëndësishëm.

A. Zogu, “Ikonë politike” për të Djathtën e vërtetë

Me pohimin se “E djathta nuk mund ta pranojë Ahmet Zogun si ikonë politike”, z.Myftaraj gabon kur i referohet të Djathtës që njeh ai për të tillë, por që, në të vërtetë, është e djathta e së Majtës, pra as më pak e as më shumë se e Majta e së Djathtës klasike shqiptare. Ndaj, qoftë për shkak të këtij pozicionimi, qoftë edhe për shkak të republikanizmit të spikatur programor, e të demonstruar gjatë pushtetit republikan 1992-1997, “e Djathta” që nënkupton z.Myftaraj, nuk mund të ketë asnjë arsye për ta njohur Mbretin Zog si “ikonë politike”. I tillë, pra Ikonë Politike, Mbreti Zog është për të djathtët e vërtetë dhe jo për formacione e individë të pozicionuar në qendër apo rrotull qendrës, frymëzimet, praktikat qeverisëse, qëndrimet dhe programet e të cilëve nuk kanë kurrfarë lidhjeje me të Djathtën klasike.

Ata që z.Myftaraj nënkupton si të “djathtë” dhe të cilëve u ngarkon padrejtësisht djathtëzimin, që në krye të herës së angazhimit politik kanë patur si ikonë politike Nolin dhe Nolizmin.

Pikërisht F.S. Nolit, këta ia trashëguan filozofinë politike e qeverisëse dhe i glorifikuan meritat, teksa i ngritën, (në vitin 1995), edhe një monument në formë trangu peme, të cilin ia vendosën qëllimisht (pra me paramendim), bash para Tempullit të Parlamentarizmit, ish parlamentit të dikurshëm (të viteve 20-24, e më pas, që nga viti 1926 e deri në ditët e sotme). Dhe këtë monument, që përfaqëson një skandal pseudoskulpturor, (të vetmin të ngritur gjatë qeverisjes 5 vjeçare, mesa duket jo rastësisht, por ngaqë nuk njihnin askënd më të madh se ky “idhull” politik, sipas tyre i denjë për t’u nderuar e përjetësuar në bronx), ia ngritën pikërisht atij që e dëshmoi veten si kundërshtari më i egër i parlamentarizmit, teksa kryesoi dhe kurorëzoi me gjak e terror alla-leninist “Revolucionin demokratiko-borgjez të Qershorit 1924”!!!

Dhe a e dini ju z.Myftaraj se cilit ia ngarkuan të “djathtët” tuaj, detyrën për të bërë monumentin e Nolit? Ia ngarkuan Th. Th., njërit nga pseudoartistët më të indoktrinuar gjatë diktaturës, obskurantit më të egër dhe njërit ndër ekspertët dhe iduesit më të lartë të Arteve figurative të Soc-realizmit, i cili pikërisht për këto merita ishte ndër më të përkëdhelurit e diktaturës së Hoxhës, ngaqë ishte bash dhëndëri i Pirro Kondit dhe Vito Kapos.

Nuk e di nëse e mbajnë më për “ikonë politike” Nolin, ata që e pësuan nga e njejtja filozofi dhe frymëzim nolist gjatë rebelimit të përgjakshëm të vitit 1997 dhe më 12 shtator 1998, pas jetësimit të thirrjes gjakatare “Ngrihuni dhe bjeruni / korrini dhe shtypini / katundarë dhe punëtorë / që nga Shkodra gjer në Vlorë...”, pra, ‘që nga Moska gjer në Vlorë...’.

Pa patur asnjë arsye dhe duke e gjykuar të panevojshëm një diskutim mbi pozicionimet klasike në spektrin politik të partive - e lë në dëshirën e z.Myftaraj të deklarojë se cilës së “djathtë” i referohet ai, duke e ndihmuar njëkohësisht të shpëtojë nga detyrimi personal apo i bashkëmendimtarëve të tij, për ta njohur Mbretin Zog si “ikonë politike”.

Inkoherenca konceptuale nuk e ndihmon analizën

Me sulmin tuaj të tërbuar ndaj Mbretit Zog, Mbretit Leka, Familjes Mbretërore dhe Zogizmit, ju z.Myftaraj e flakët “obligimin”, qysh kur pranoni në shkrimin tuaj se “Unë, ashtu si të gjithë ata që kanë bindje të djathta, e kam ndjerë obligim për ta mbrojtur Ahmet Zogun, i cili historikisht është goditur nga e majta komuniste dhe postkomuniste...”, dhe kjo është puna dhe e drejta juaj.

Po përse vallë, me shkrimet e fundit kundërshtuat vlerësimet dhe qëndrimet e dikurshme pozitive për Mbretin Zog në librat tuaja!?? Pra cila ishte shtysa që ju çoi të përgënjeshtroini veten dhe të bëni objektiv të sulmeve të paprincipia e të mbushura me fyerje, pikërisht Ahmet Zogun, i cili, sikundër e pohoni edhe në shkrimin tuaj “... historikisht është goditur nga e majta komuniste dhe postkomuniste...”!!!

Ajo që ju keni shkruar nuk është “... analizë gjakftohtë për Ahmet Zogun, të cilën sot po na e imponojnë ndjekësit e tij, të cilët duan ta kthejnë Ahmet Zogun në një ikonë politike për të kërkuar me të në dorë votat e shqiptarëve, me arsyetimin se LZHK me Leka Zogun në krye do të sjellin ‘kohën e artë’ të qeverisjes së Ahmet Zogut”. Shtrembërimi i të vërtetave historike nuk mund të jetë analizë gjakftohtë, aq më tepër kur shoqërohet me fyerje skandaloze ndaj figurës që analizohet, sepse fyerjet dëshmojnë të kundërtën e gjakftohtësisë.

Noli nuk ka qenë kryetari i parë i Partisë Popullore

Në replikën tuaj me z.Murat Basha, ju z.Myftaraj shkruani: “Që Partia Popullore pati një orientim bolshevik kjo provohet lehtë. Mjaft të tregohet se kush qe kryetari i kësaj partie, për ta vërtetuar këtë. Kryetar i parë kësaj partie qe Fan Noli”. Jo zotëri, Fan Noli nuk ka qenë kryetari i parë i Partisë Popullore, por ju e përdorni cilësorin “i parë”, me qëllimin që t’i paraprini skemës suaj që synon ta nxjerrë këtë parti “me orientim bolshevik”, meqenëse Noli kishte, shfaqje dhe demonstroi, ndërmjet të tjerash, edhe pikëpamje të majta gjatë viteve në fjalë. Gabimi juaj, (nëse në rastin më të mirë do ta konsiderojmë si naivitet dhe aspak të qëllimshëm), vjen për shkak të mungesës së informacionit, ose për shkak të burimeve të pasakta që ju citoni.

Ajo që ju e quani “provë e lehtë”, nuk përbën provë. Noli ka qenë anëtar dhe, më pas, kryetar i Partisë Popullore, dhe kjo madje për një kohë shumë të shkurtër, por kjo nuk do të thotë se ai ka qenë kryetari i parë i saj. Kryetar i parë i Partisë Popullore është Qazim Kokoshi, e pas tij u bë Noli.

Noli përfaqësonte në Këshillin Kombëtar shoqërinë “Vatra”, si i deleguar i saj në Shqipëri dhe respekti i shqiptarëve ndaj saj, (për shkak të aktivitetit të spikatur patriotik në raport me të gjithë diasporën shqiptare në botë), ishte shumë i rëndësishëm dhe determinues në vlerësimin tejet pozitiv të Nolit nga shqiptarët, në atë kohë. Po këtë respekt Noli e gëzonte edhe brenda Partisë Popullore, çka përcaktoi edhe zgjedhjen e tij si kryetar i saj.

Pas rebelimit të marsit 1922, Noli u largua nga radhët e Partisë Popullore, pas 9 muajsh aderimi, meqenëse u ngarkua me detyrën e ministrit të Jashtëm në kabinetin e drejtuar tashmë

nga Xhaferr Ypi, kabinet në të cilin Ahmet Zogu mbajti portofolin e ministrit të Brendshëm.

Pas largimit të Nolit nga Partia Popullore, kryetar i saj u bë Sejfi Vllamasi.

(“Bisedimet e Këshillit Kombëtar 1923”, faqe 1035).

Vllamasi ia la vendin Bedri Pejani i cili, në shtator 1923, u largua nga kreu i partisë dhe më pas, përfundimisht, edhe nga vetë partia. Në kohën kur Partia Popullore po përjetonte një krizë të saj, kryeministri Ahmet Zogu mori edhe drejtimin e partisë, e cila në zgjedhjet e atij viti doli si forca e parë politike në vend, ndonëse nuk arriti shumicën absolute.

Pas sukseseve mbi rebelimet e Mirditës dhe atyre të dhjetorit 1921 dhe marsit 1922, Zogu u imponua dhe u pranua njëzëri, pa kushte, si “violina e parë” e klasës politike. Një ndër arsyet se përse kryeministri Xhaferr Ypi e emëroi Nolin në postin e kryediplomatit, ishte sepse ky i fundit nuk u implikua në trazira, si dhe për shkak të aftësive të shkëlqyera prej polemisti, diplomati e negociatori, për të cilat vendi kishte shumë nevojë në atë kohë. Qëndrimet dhe fjalimet e Nolit në Lidhjen e Kombeve, ishin shembuj atdhetarie, kulture poliedrike dhe elokucence brilante në mbrojtje të interesave shqiptare. Dhe koha e vërtetoi sërish drejtësinë e vlerësimeve të merituarra në adresë të Nolit për suksesin në kryerjen e detyrës delikate e atdhetare të kryediplomatit.

Noli nuk ka qenë i dërguari i Kominternit në Shqipëri

Ju z.Myftaraj shkruani se “Fan Noli ka qenë inicuesi dhe ideologu i parë i komunizmit shqiptar. Ai ka qenë njeriu i Kominternit. Në rast se zogistët e mohojnë këtë gjë ata bëhen qesharakë”.

Nga dokumentet e deritanishme, ne zogistëve nuk na rezulton që Noli të ketë qenë “inicuesi dhe ideologu i parë i komunizmit shqiptar”. Nëse ju keni dëshmi dhe dokumenta për këtë, nxirrini dhe hajde të diskutojmë, por jo kështu, duke na vënë para definimeve të dhunshme e në formë postulati.

Kominterni dhe Komunizmi në Shqipëri u futën në vitin 1924, pas Revolucionit të Qershorit, dhe këtë e favorizoi politikisht largimi i eksponentëve të së Djathtës me në krye Zogun dhe mosnjohja e Qeverisë së Nolit nga Fuqitë e Mëdha dhe vendet fqinjë. Pikërisht ky boshllëk politik u shfrytëzua nga Internacionalja Komuniste, e cila kur pa se elementë bolshevikë si Sejfulla Malëshova, arritën deri në postin e sekretarit personal të kryeministrit Noli, si dhe duke i vlerësuar zhvillimet politike dhe situatën revolucionare brenda vendit si mjaft oportune për diversion dhe ndikim ideologjik e politik - dërgoi emisarët e saj në Shqipëri, si Vardarac, Antonio Grupshiqi e Marko Sulioti, me misionin e studimit të situatës politike, rekrutimit të njerëzve, si dhe krijimit e shfrytëzimit të kushteve dhe rrethanave të favorshme për formimin e Partisë Komuniste.

I dërguari special i Kominternit, Vardarac, me ndihmën e Kostandin (Kostë) Boshnjakut, (në këtë kohë tregtar në Durrës), takoi njerëzit kryesorë të Komitetit të Kosovës, si Hysni Currin (vëllai i Bajram Currit) dhe major Ibrahim Gjakovën, tek të cilët gjeti mirëkuptim dhe gatishmëri të plotë për zhvillimin dhe përhapjen masive të ideve komuniste.

Duhet theksuar se Bajram Curri dhe Hasan Prishtina, në këtë kohë, ishin mjaft këmbëngulës në kërkesën e tyre ndaj qeverisë së Nolit për lidhjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe B.S. Dhe kjo jo se ata kishin pikëpamje komuniste, por sepse synonin njohjen e qeverisë në arenën ndërkombëtare dhe për shkak të ideve të tyre utopike, të cilat i shtynin të mendonin se, pas denoncimit nga Lenini të Traktatit të fshehtë të Londrës, (të vitit 1915), dhe për arsye të diferencave ideologjike midis BS komunist dhe Mbretërive jugosllave e Greke - bolshevikët në pushtet në BS do të ndihmonin për zgjidhjen e Çështjes Kombëtare shqiptare, për të cilën ata ishin të përkushtuar. Më vonë, për të njëjtat arsye dhe për motive të sëmura arriviste, Hasan Prishtina, Noli e Gurakuqi, krijuan lidhje edhe me qeverinë e Musolinit. Ky pragmatizëm naiv, solli zhgënjimin më të dhimbshëm tek shumica e politikanëve antizogistë shqiptarë, që ranë viktimë e iluzioneve absurde për idetë komuniste dhe socializmin real në pushtet, në BS.

Kostandin Boshnjaku, komunist i vendosur, i premtoi Vardarac-it se do të krijonte një celulë komuniste, në këmbim të financimit nga Kominterni.

Në raportin e tij dërguar Kominternit, Vardarac theksonte: “Sipas mendimit tim, është më tepër sesa e nevojshme t’i kushtohet Shqipërisë një vemendje e plotë, meqenëse atje nuk ka partira të konsoliduara, dhe ne, me një propagandë dhe punë të mirë, mund të arrijmë shumë gjëra...”.

(Arkivi i Shtetit. Fondi Dokumenta të Kominternit për Shqipërinë. Raporti i Vardarac për Kominternin, viti 1924).

Noli nuk guxoi të lidhë marrëdhënie diplomatike me BS

“Më datën 5 korrik 1924, përfaqësuesi i Qeverisë së Fan Nolit në Romë, i dërgon një notë zyrtare qeverisë sovjetike, dhe kërkon lidhjen sa më të shpejtë të marrëdhënieve diplomatike.

Përfaqësuesi i Moskës mbërriti nga Roma shumë shpejt në Tiranë, për të vendosur marrëdhëniet diplomatike midis BS dhe Shqipërisë...

Presidiumi i Federatës Komuniste Ballkanike, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Italiane dhe Partia Komuniste Jugosllave, dolën me deklarata përkrahjeje për “Revolucionin demokratik të Qershorit 1924”.

Për këto veprime me tendencë majtiste, kundërshtarët politikë të Fan Nolit i vunë atij nofkën “Peshkopi i kuq”.

Qeveritë fqinje dhe ato evropiane, mbajtën një qëndrim armiqësor kundër këtij Revolucionit shqiptar, duke e akuzuar se kërkonte të vendoste një regjim bolshevik në Shqipëri...

“Presioni dhe propaganda ndërkombëtare e trembi Nolin, dhe qeveria e tij nuk guxoi të vendoste marrëdhënie diplomatike me B.S”.

E ndodhur para faktit të mosnjohjes ndërkombëtare, e për të legjitimuar marrjen e pushtetit me dhunë, “qeveria e Fan Nolit vendosi që të bëheshin zgjedhjet e përgjithshme kombëtare”.

Zgjedhjet nuk mundën të realizohen.

Është interesant fakti që “Kominterni, me anën e funksionarit të tij Ivan Vladetiç, i kërkonte Kostandin Boshnjakut që të merrte “pjesë në zgjedhje si grup komunist, ose si aleancë me një formacion tjetër politik, por me një fytyrë të qartë komuniste”.

Kominterni jepte edhe udhëzime për njerëzit që do të futeshin në grupin komunist, si Llazar Fundo, Ibrahim Gjakova, etj..

(Arkivi i shtetit. Fondi Dokumenta të Kominternit për Shqipërinë. Letra e Ivan Vladetiç për Kostë Boshnjakun. Vjenë 6 Tetor 1924).

E vërteta mbi Nolin dhe komunizmin e viteve 20-të

Më poshtë ju sërish insistoni tek “komunizmi” nolist, teksa shkruani se “Lidhjet e Nolit me komunizmin ndërkombëtar, sigurisht që nuk filluan në qershor 1924, por logjikisht ato kanë filluar më herët. Noli me siguri që ka krijuar lidhje me qarqet komuniste që kur qe emigrant në SHBA, ku shkoi në 1906. Ai vetë thotë se në SHBA ka pasur lidhje me emigracionin rus. Dihet se tek emigracioni rus në SHBA kishte një rrymë të fuqishme bolshevike. Nga SHBA do të vinte në Rusi Trocki, njeriu i dytë pas Leninit në Revolucionin e Tetorit”.

Jo për të mbrojtur Nolin, por vetëm të vërtetën - jam i detyruar t’i kujtoj z.Myftaraj se është pikërisht “Rezoluta e hartuar nga grupet komuniste në Shqipëri dhe e miratuar në mbledhjen për themelimin e PKSH më 8 nëntor 1941. Kapitulli II”, ajo që rrëzon referimin tuaj të mësipërm në adresë të Nolit.

Në të, tekstualisht thuhet: “... Në periudhën që nga 1922 deri më 1924, Shoqëria ‘Bashkimi’..., me presionin e saj në parlament bëri që ky të përkujtojë Leninin me qëndrim në heshtje, (ja pra ku fillon dhe shfrytëzohet politikisht mashtrimi i madh për “heshtjen në nderim të Leninit”), dhe të shtrëngojë qeverinë e Nolit që të njohë BS. Në vitet 1925-1926, anëtarët e majtë të Shoqërisë ‘Bashkimi’, pas rënies së Nolit shkojnë në BS dhe aty krijojnë një grup komunistësh shqiptarë. Themelohet edhe Konareja (Komiteti nacional-revolucionar). Në vitin 1928 ky komitet u riorganizua... Ai boton fletoren “Lirija Kombëtare”. Ky Komitet ishte lidhur me Konfederatën ballkanike dhe, me anën e saj, me Kominternin. Në vitin 1930, komunistët shqiptarë nga BS vijnë në Shqipëri për të punuar dhe lidhen me lëvizjen e masave, e cila porsa pat filluar të shfaqet në Korçë...”.

(Vladimir Dedijer “Marrëdhëniet Jugosllavo-Shqiptare 1939-1948, Beograd, 1948, faqe 8).

Sipas logjikës suaj z.Myftaraj, pra nëse “Noli ka qenë “i lidhur me komunizmin ndërkombëtar”, i bie që ai të ketë qenë komunist që në Amerikë!!! Dhe meqenëse Noli ka

qenë përfaqësuesi më i shquar i shoqërisë “Vatra”, deduktohet se kjo shoqëri duhet të ketë qenë e molepsur nga idetë komuniste dhe, duke ndjekur linjën e arsytimit tuaj, del si konkluzion se “Vatra” duhet të paskësh punuar për bolshevizmin në SHBA-të. Po për të provuar këtë, pra për Nolin-komunist në SHBA, ju duhet të sillni prova! Minimalisht, duhet të gjeni qoftë edhe ndonjë fjalim të Nolit pro komunizmit deri në vitin 1921.

Ju nuk sillni prova dhe nuk bindni askënd teksa përdorni ndajfoljet supozuese “sigurisht”, “logjikisht”, “me siguri” etj., apo kur me anë të pohimit të “pranuar” nga Noli për “lidhje me emigracionin rus”, kaloni tek “rryma e fuqishme bolshevike” e tij, për të kulmuar tek Trocki, si një ndër krerët bolshevikë, vetëm e vetëm për ta nxjerrë Nolin komunist që në kohën e Plehanovit, madje që në kohën e Kongresit të PSD Ruse të vitit 1905.

Gjithsesi, nga dokumentat dhe analiza e ftohtë e kundërshtarit më eminent të zogizmit, Nolit, nuk na rezulton që ai të ketë qenë “njeriu i Kominternit”, përveçse njëri nga të shumtët e budallallëpsur nga idetë bolshevike.

Hallakatjet politike të Nolit

Noli, nën dritën e një analize të rreptë rezulton një personazh inkonsekuent, shpesh kontradiktor dhe inkoherent me vetveten dhe pikëpamjet e qëndrimet e tij politike gjatë karrierës prej politikani por, për të qenë të ndershëm dhe objektivë, Nolit nuk mund t’i atribuojmë pikëpamje terroristo-komuniste në kohë të papërcaktuara. Noli i vitit 1921, është tjetër personazh dhe krejt i ndryshëm në pikëpamje e qëndrime nga ai i vitit 1924. Akoma më majtas rrëshqet Noli kur, në vitin 1927, shkon në BS në krye të një delegacioni emigrantësh shqiptarë. Pas vitit 1927 Noli ndryshon sërish, duke dhënë profilin e një njeriu të paqëndrueshëm politikisht.

Konfuz dhe të paqëndrueshëm në pozicionet dhe pikëpamjet politike, e gjejmë Nolin edhe në vitet 1942, 1944, apo 1950. Vetë mosardhja e Nolit në Shqipëri dhe refuzimi i ofertës së Hoxhës për postin e Presidentit të Republikës komuniste, pas vendosjes së regjimit komunist, është një tregues tejet domethënës, që flet për distancimin e tij nga idetë majtiste.

Noli, për shkak të formimit të tij kulturor të spektrit të gjerë, “notonte” që nga ujërat e iluminizmit, kristian-demokracisë, pacifizmit social-demokrat, anarkizmit, jakobinizmit, fashizmit e deri tek bolshevizmi. Truri i tij i pazakontë, përfaqësonte një “magazinë të rrëmujshme e pa inventar”, ku kufinj të teorive politiko-filozofike shkriheshin dhe, shpesh herë, nuancat e tyre ravijëzoheshin në vartësi të gjendjeve emotive. Ai jo vetëm që nuk mund të ishte “ideolog...”, (pasi nuk mund të ketë ideolog pa vepra të shkruara për ideologjinë e tij), por duke qenë konfuz dhe i pasistemuar ai nuk mund të përfaqësonte kurrësi ideologun, i cili gjithëheret është konsekuent, koherent, pa ekuivoqe dhe i qartë në bindje dhe qëndrime. Pasionet e Nolit dhe “intransigjenca” prej politikani, e largonin nga tryeza e qeveritarit që po i shket toka nën këmbë dhe që qeverisja i ka marrë tatëpjetën - drejt muzave muzikore, tek rrëmbente flautin në mes të krismave të armëve.

Partia Popullore – rrumpallë allashqiptare

Partia Popullore nuk ka qenë parti “prokomuniste”, por thjesht një parti e cila, gjatë gjithë veprimtarisë së saj, është karakterizuar nga inkoherencë dhe paqartësi qëndrimesh, dobësi dhe impotencë politike në momente kryesore, indisiplinim, lidërsip dhe anëtarësi të paqëndrueshme, humbje të orientimit dhe paaftësi për përcaktimin e prioriteteve politike e programore.

Për të ilustruar këtë konkluzion, studiuesi Kastriot Dervishi shkruan: “Partia Popullore si grupim kompleks, i organizuar në një kohë kur nuk kishte kuptim as e Majta dhe as e Djathta, pati një ndryshim të shpejtë dhe të përhershëm të radhëve të saj. Brenda vitit 1921, deputetët e saj u copëzuan në disa grupe politike. Kjo ndodhi edhe me rivalen e Partisë Popullore, Partinë Përparimtare”.

Pas shpërbërjes së dy grupeve më të mëdha parlamentare, në 9 tetor 1921 u krijua grupi i ri politik, i njohur me emrin ‘Bashkimi i Shenjtë’, në të cilin bënë pjesë këta deputetë: Haxhi Jusuf Banka, Bahri Omari, Hoxha Kadri, Ramiz Daci, Gjergj Fishta, Ferit Vokopola, Anastas Pandeli, Qazim Koculi, Vissarion Xhuvani, Mustafa Kruja etj..

Më 16 tetor 1921, deputetët më tipikë të Bashkimit të Shenjtë, Bahri Omari dhe Mustafa Kruja, kërkuan interpelancë me kryeministrin për çështjen e zv/ministrit të Luftës, pasi kryeministri kishte ushtruar kompetencat e tij në mungesë të ministrit të Luftës, Selahudin Shkoza. Për këtë shkelje dhe dhunim kompetencash, zv/ministri Mustafa Maksut protestoi kundër kryeministrit Vrioni.

Interpelanca, në dukje e parëndësishme, u bë mjete kryesor që rrëzoi qeverinë e koalicionit të Iljaz Vrionit, duke dëshmuar më tepër prishjen e raporteve të vjetra politike. Në fjalën e tij, kryeministri Vrioni tha se 4 vetë i kishin “kërkuar dorëheqje, të cilën nuk e ka pranuar”

(“Bisedimet e Këshillit Kombëtar 1921”, faqe 482 – 486).

Gradualisht, kjo çështje jo dhe aq e rëndësishme, përfundoi në votëbesim për qeverinë, duke sjellë rrëzimin e saj me 39 vota kundër.

“Bashkimi i Shenjtë” kishte arritur kështu, një sukses të shpejtë politik, por shumë shpejt u pa që edhe “Bashkimi i Shenjtë” nuk i kënaqi interesat e pjesëmarrësve në të. Deputetët e Korçës u shkëputën nga ky formacion politik dhe iu bashkuan grupit të ri të formuar nga Iljaz Vrioni, që filloi të quhej grupi “Indipendent”. Nga ana tjetër, ish-anëtarët e Partisë Popullore formuan një parti të re të quajtur “Partia Kushtetuese”, me deputetë të Elbasanit, Beratit, Tiranës e disa të tjerë. Në këtë situatë, rënia e qeverisë pasardhëse të Pandeli Evangjelit, dukej e shpejtë

(Hysen Kordha “Ngjarjet e dhjetorit 1921”, “Studime historike” nr.1, 1974, faqe 49).

“Në dhjetor 1922, Zogu arriti të kontrollonte plotësisht, si Krahun Kombëtar, ashtu edhe Partinë Popullore, e cila kishte në pamje të jashtme një fizionomi komplekse. Partia (në Këshillin Kombëtar) në këtë kohë përbëhej nga 20 përkrahës të Shefqet Vërlacit, nga 18

përkrahës të Ahmet Zogut si dhe 3 të tjerë të grupit (Independent) të Iljaz Vrionit, që përkrahnin Ahmet Zogun.

(“Populli” 18 janar 1923, sipas “Gazzeta di Puglia”).

Partia Popullore pati jetë deri në qershor 1924. Rrethanat e reja të krijuara, e kishin nxjerrë atë jashtë lojës politike, pavarësisht rolit dominant në të kaluarën e saj.

Avni Rustemi nuk ka aderuar kurrë në Partinë Popullore

Ju z.Myftaraj shkruani se “Një tjetër provë për të treguar se kjo parti qe prokomuniste (pra Partia Popullore), është fakti se në rradhët e saj bënte pjesë edhe Avni Rustemi, leninisti i deklaruar që, në 1924, i kërkoi parlamentit shqiptar që të mbante 5 minuta zi për Leninin, gjë që e bënte të gjithë ata parlamentarë që, në 1921, qenë anëtarë të Partisë Popullore”.

Së pari, Avni Rustemi nuk ka qenë asnjëherë anëtar i Partisë Popullore, sikundër shkruani ju, por ka qenë anëtar i grupit “Demokrat” të Gjirokastës. Avni Rustemi nuk ka qenë as deputet i Partisë Popullore, sepse përfaqësues të saj në parlament kanë qenë: Bahri Omari, Agathokli Xhitoni, Zija Toptani, Banush Hamdi, Leonidha Frashëri, Pandeli Cale, Ali Këlcyra, Petro Harito, Koço Tasi, Loni Kristo, Kristo Kirka, Bajram Fevzi, Eshref Frashëri, Tefik Panariti, Stavro Vinjau, Sulejman Delvina, Sotir Peci, Ahmet Zogu, Fan Noli, Osman Nuri (Haxhiu), Dhimitër Kacimbira, Mustafa Maksut (Shehu), Syrja Pojani, Qazim Kokoshi, Ibrahim Xhindi, Tefik Mborja, Sejfi Vllamasi.

Këta janë - për saktësi historike - Deputetët nënshkrues të Partisë Popullore.

(“Taraboshi”, 22 maj 1921).

Partia Popullore nuk ka qenë prokomuniste

Për të vërtetuar se Partia Popullore nuk ka qenë parti “prokomuniste”, pra me pikëpamje të tilla, të përcaktuara qartë e të mishëruara në frymën dhe filozofinë politike, bazohemi tek programi i saj, në të cilin nuk gjenden aspak referenca për “proletariatit, apo pushtetin e tij; për rrugët e dhunshme të marrjes së pushtetit (pra me revolucion apo kryengritje të armatosur e të udhëhequr nga një shtab revolucionar të kryesuar nga partia komuniste); për armiq ideologjikë dhe reaksionarë; për devijatorë e revizionisto-oportunistë; për pronë shoqërore mbi mjetet e prodhimit; për shfrytëzues e shpronësimit të tyre; për zhdukje të pronës private dhe triumf 100 % të pronës shoqërore mbi mjetet e prodhimit; për likujtime të latifondistëve, tregtarëve e industrialistëve si klasa shfrytëzuese; për revolucion botëror e internacionalizëm proletar; për klasë punëtore e fshatarësi punonjëse; për luftë klasash; për besimet fetare dhe institucionet e kultit si armiq ideologjikë të komunizmit dhe ‘opium për popullin’, e të tjera si

këto, që janë shtyllat programore të një partie komuniste, “prokomuniste” apo kuazi-komuniste.

Ja Programi i Partisë Popullore:

“Partia Popullore asht një parti politike dhe parlamentare, e cila do të mbrojë një program reformash fjesht moderne, nga shpirti, por të urta e të shkallëzuara që të mos tronditet asnjë ndjenjë ose zakon i vendit.

Partia do të përpiqet ta rrisë, ta edukojnë e ta pasunojnë popullin e ta vëri në radhën e popujve europianë të Perëndimit.

Partia do të mprojë njësinë e të gjithë gjytetasve shqiptarë pa ndryshim fejet, si dhe për lirinë personale, të fesë, së shtypit të fjalës, mbledhjes e shoqnisë.

Pikat kryesore të partisë, janë këto:

1-Parlamentarët të plotësojnë e të zgjanojnë statutin e Lushnjes dhe të votojnë një kod kanunesh të bazuara në bazë shkencetare, duke marrë nën sy zakonet e Shqypnies.

2-Politika e jashtme e Shqypnies të jetë paqëse dhe kombëtare.

3-Asnji intervencion i huej në punët e mbrendshme të Shqypnies, një administratë moderne e vendit, e cila të sigurojë ndjesitë, ndjesinë, rregullën dhe paqen, të bahet një ligjë për të mbrojtun të drejtat e nëpunësve.

4-Asnji koncesion, i cili ta robërojë kombin ekonomikisht.

Një sistem taksash, e cila mos ta rëndojë popullin e vobekët. Mbrojtja e industrive kombëtare. Udhë për të lidhun qytetet, fshatrat e limanet e Shqypnies.

5-Një ushtri për të mrojtun kufit e për të forcue vendin, e rekrutueme me konskripë. Çdo shqiptar të jetë i detyruar të shërbejë ushtar, shërbimi ushtarak të shërbehet në një mënyrë, që të mos jetë e rëndë, as për popull, as për shtetin. Të formohen bataliona për të ndërtuar udhë, ura dhe godina.

6-Çifligjet e shtetit të vehen në një administratë shkencëtore që të punohen sistemërisht, të sjellin të ardhura, të lehtësojnë pagesat e popullit e të jenë një shkollë praktike për bujqësinë e rritjen e baktisë. Stacione bujqësore ku bujqit të msohen darovisht (udobisht) prej ekspertash qysh ta punojnë dhenë pas methodave të fundme. Asnji i huej mos të ketë të drejtë të blejë tokë a të zotërojë tokë në Shqipni.

Një bankë bujqësore.

7-Të organizohet mësimi e të veket në një bazë të gjanë, duke themelue një tokicë shkollash me mjeshtër të huej, krejt moderne në sistem e në shpirt me gjithë mnyrët e nevojshme, jo vetëm për diturinë, por edhe për zbukurimin e jetës, zbutjen e zakoneve dhe shëndetësinë e brezit të ri...

8-Të dahet vendi në disa zona shëndeti, secilado nën një grup mjeksosh modernë për të lëftuar sistematikisht sëmundjet, për të përhapë diturinë e rregullave të shëndetit, e për të përmirësuar racën. Të themelohen salla operacionesh, klinika senatore, e shoqëria atletike.

9-Nji luftë sistematike kundra gjaqeve. Luftë kundra alkolizmës dhe kumarës.

10-Ekspertë të huaj për të gjitha degët e shërbimeve publike, veç punëve të jashtme, të cilat për arsye shteti duhet të mbeten në durr shqiptare.

11-Të riorganizohen gjyqet me rajë dhe të vehen jashtë kapriciteve të politikës.

12-Ky program mund të shtohet me shumicën e votave dhe mund t'arohet me 2/3 e votave t'antarëve të partisë.

U këndue, u pëlqye dhe u nënshkrue.

Sekretar i partisë, Qazim Kokoshi (pra kryetari i partisë, sepse kështu cilësohej).

Tiranë, 24 prill 1921.

Kuvendi Kombëtar nuk mbajti zi për Leninin

Për të provuar se Partia Popullore ka qenë “prokomuniste”, ju z.Myftaraj ofroni si provë pohimin e pabazuar “... se në radhët e saj bënte pjesë edhe Avni Rustemi, leninisti i deklaruar që, në vitin 1924, detyroi parlamentin shqiptar që të mbante zi për Leninin, gjë që e bënte të gjithë ata parlamentarë që në 1921 qenë anëtarë të Partisë Popullore”

Në Kuvendin Kombëtar të Shqipërisë nuk është mbajtur zi për Leninin. Të vërtetën për këtë ngjarje e kanë manipuluar disa gazeta të drejtuara nga njerëz të papërgjegjshëm, të pasuara nga të tjera që synonin “scoop”-in, ose të interesuara politikisht për një spekulim të tillë, si dhe burimet që ushqyen historiografinë zyrtare komuniste. Interesant është fakti se ky spekulim u shoqërua me një efekt kaskadë, sipas një skeme të paramenduar. Ndonëse burimet arkivore ishin të hapura, askush nuk guxoi të zbardhte të vërtetën gjatë viteve të diktaturës. Mesa duket, studiuesit apo rrëmuesit e pasionuar të arkivave për punimet e parlamentit të asaj kohe, e kuptuan se ky “gabim” në citim është i qëllimshëm dhe me prapavijë politike, sipas interesave të regjimit komunist.

Dhe kështu, ky spekulim i trashë u shndërrua në një mashtrim të madh, që më pas u zyrtarizua me vulën e së “vërtetës” nga prekursorët e komunizmit dhe komunistët në pushtet.

Në të vërtetë, Partia Popullore e vitit 1921, në janar 1924 ndryshon në përbërje dhe lidërsip nga ajo e fillimeve të saj. Tashmë (pra në vitin 1924), Fan Noli, pas largimit nga Partia Popullore u pozicionua në Partinë Liberale, ndërsa Avni Rustemi bënte pjesë në grupin “demokrat” të Gjirokastrës, i cili (grupi) u ndëshkua me humbje të rëndë në zgjedhjet e 27

dhjetorit 1923.

Për ta ndihmuar z.Myftaraj të kuptojë gabimin e rastit në fjalë (gjithmonë nëse nuk e ka të qëllimshëm), më poshtë po zbardhim një pjesë nga proces-verbali i seancës parlamentare të 4 shkurtit 1924, në të cilin u propozua, por nuk u miratua mbajtja e heshtjes së zisë për Leninin:

Deputeti Rauf FICO: Zoti kryetar! Pa hy në bisedimin e rendit të ditës, dua të bëj një proponim (propozim). Me hidhërim muarmë vesht se ish-kryetari i Shteteve të Bashkuara t' Amerikës E. Eilson-i vdiq. Duke marrë parasysh shërbimet e mbëdha që i ka bërë Shqipërisë, proponoj të bëhen 5 minuta pushim si shenjë hidhërimi, edhe t' i hiqet (dërgohet) një telegram ngushëllimi familjes së të ndjerit.

Pranohet.

Bahen 5 minuta pushim dhe pas 5 minutash mbledhja mbështjelllet prapë.

Deputeti Jashar EREBARA: Para se të hymë në bisedim, proponoj të bahen 5 minuta pushim edhe për Leninin, se në qoftëse Wilson-i do të flitëte për të mirën e Shqipërisë, ma tepër do të flitëte Lenini për një Shqipni të madhe.

(Ilaritet në sallë)

Deputeti Avni RUSTEMI: Më vjen shumë keq zoti kryetar që, kur përmendet emëri i Leninit, ndigjohen qeshje nga ana e disa përfaqësuesve të kombit. Nuk due që Shqipëria të jetë bolshevike, sepse gjendja dhe pozita e saj nuk e don, por për principet e larta njerëzore duhet që, me një respekt, të zihet në gojë emëri i tij (Leninit – shën. i A.K.). E dini fare mirë zotërinj, se qysh ay mbrojti principet e larta të njerëzisë, e se që i pari që denoncoi traktatin e mëçeft (të fshehtë) të 1915, që ishte për copëtimin e Shqipërisë.

E dinja se proponimi i bërë prej zotni Erebara nuk do të pranohej, por neve, megjithatë, e kemi për detyrë të proponojmë që të bëhen 5 minuta pushim si shenjë hidhërimi për vdekjen e tij.

Deputeti Eqrem VLORA: Për nderin e kaqë mijë shpirtave që theri me duar të tija?...

Deputeti Ali KËLCYRA: Zoti kryetar! Në këtë rast që po nisim të bëjmë 5 minuta pushim për njerës të huaj, më duket se do t' ishte më e drejtë të bëjmë edhe 5 minuta pushim për ata që kanë derdhur gjakun për krijimin e Shqipërisë, e që këtë tokë e kanë vaditur me gjakun e tyre. Mbasi..., proponoj të bëhen 5 minuta pushim për Vani Cico Kosturin, të cilit i kanë vdekë, të vvarë, i biri nga ana e grekëve dhe i nipi nga ushtërija turke, dhe t' i hiqet një telegram ngushëllimi familjes së tij.

(“Bisedimet e Kuvendit Kushtetues 1924”, Tiranë 1924, nr. 5, faqe 63-65).

Ja pra z.Myftaraj! Me pohimin e Avni Rustemit se “...Nuk due që Shqipëria të jetë bolshevike, sepse gjendja dhe pozita e saj nuk e don...”, del qartë se, pavarësisht simpatisë së hapur për Leninin, Avni Rustemi nuk guxonte të vetshpallej si leninist, e aq më tepër të guxonte që, idetë dhe praktikat leniniste të pushtetit të sovjetëve t' ua sugjeronte, si alternativë ideologjike dhe qeverisëse, shqiptarëve.

Tashmë shqiptarët e kanë të qartë fundin e rremë dhe poshtëruës të përrallës, sipas së cilës

prekursorët e komunizmit shqiptar e detyruan atëkohë parlamentin që të mbante zi për Leninin.

E vërteta e kulluar dëshmon se deputetët e parlamentit, më 4 shkurt 1924, mbajtën zi për Willsonin e madh dhe për patriotin Vani Cico Kosturin, por jo për Leninin. E kësisoj, meqenëse nuk është miratuar mbajtja zi për Leninin, i bie që edhe pohimi juaj z.Myftaraj, se mbajtjen e zisë "... e bënë të gjithë ata parlamentarë që në 1921 qenë anëtarë të Partisë Popullore.”.

Vijon

Polemikë me z.Kastriot Myftaraj rreth shkrimit "Zogistëve u hyn paniku nga zbulimi i të vërtetave" (3)

Si hyri Ahmet Zogu në politikën kombëtare

Nga Astrit Kola

Vijon nga numri i kaluar

Në vitin 1924 nuk ka patur parti të majtë

Ju z.Myftaraj, shkruani: “Që Ahmet Zogu hyri në politikën shqiptare, në rradhët e një partie të majtë, kjo është një e vërtetë e pamohueshme dhe zogistët bëhen qesharakë, duke e mohuar”. Por duke analizuar programin politik të Partisë Popullore, del që kjo parti nuk ka qenë asnjëherë e majtë. Pra bie poshtë edhe pohimi juaj se “... Ahmet Zogu hyri në politikën shqiptare, në rradhët e një partie të majtë...”. Dhe kjo do të thotë se, Ahmet Zogu, jo vetëm që nuk e ka nisur karrierën politike duke aderuar në një parti të majtë (nënkupto Partia Popullore – A.K.), por edhe se, kësisoj, logjika më elementare rrëzon vetvetiu edhe pohimin tuaj pasues, sipas të cilit “... krerët e kësaj partie (pra të Partisë Popullore të etiketuar dhunshëm si “e majtë” nga z.Myftaraj) e donin Ahmet Zogun për të përçarë të djathtën...!!!”.

Frika e Avni Rustemit për të bërë propagandë majtiste (sikundër cituam më lart) e për të mbrojtur Socializmin Real në pushtet në Rusi, të promovuar nga “Revolucioni Socialist i Tetorit”, duke e motivuar “proponimin” e tij me argumentin “patriotik” se “qe i pari (Lenini) që denoncoi traktatin e mëçeft të 1915, që ishte për copëtimin e Shqipëris. E dinja se proponimi i bërë prej zotni E... nuk do të pranohej...” – dëshmon fuqinë e së Djathtës dhe intolerancën e saj ndaj së Majtës. Asokohe, e Majta ndoshta kish infiltruar si ideologji në nivelet politike, porse në planin organizativ nuk na rezulton që të ish konturuar. Maksimumi i mundshëm që mund të pranohet, është se në nivelet politike dhe në aspektin organizativ (gjithmonë klandestin), e Majta atëkohë mund të ndodhej në fazë embrionale dhe skenën politike e dominante totalisht e Djathta, e fraksionuar që nga Qendra e Djathtë e deri tek e Djathta ekstreme.

Pra del e qartë z.Myftaraj se, në Shqipërinë e asaj kohe, jo vetëm që nuk ka patur ndonjë parti të Majtë, por edhe idetë probolshevike mbuloheshin pas ‘gjoja’ përkimit me interesa patriotike, por edhe kjo guxonte të manifestohej vetëm në ndonjë rast tejet të volitshëm. Dhe për habinë e të gjithë atyre që u kanë besuar legjendave për “trimërinë e çartur” të Avni Rustem-atentatorit, ky, megjithëse mes shokësh kriminelë kërcënonte për eliminime fizike, nuk guxonte t’i deklaronte hapur simpatitë probolshevike, sepse e dinte mirë se çfarë e gjente.

E vërteta mbi “Krahu Kombëtar”

Më poshtë ju z.Myftaraj shkruani se “Partia Popullore qe instrumenti politik zyrtar i organizatës famëkeqe të llojit masonik, që njihej me emrin “Krahu Kombëtar” dhe që mori epitetin “Klika”.

Studiuesi dhe historiani prestigjioz Kastriot Dervishi, njëri nga njohësit më të mirë të arkivistikës shqiptare, dhe njëkohësisht cituesi më skrupuloz i arkivave tona, lidhur me organizatën “Krahu Kombëtar”, shkruan: “Në vitin 1914, në skenën politike shqiptare filloi të shfaqej organizata Krahu Kombëtar, që ishte një komitet i fshehtë politik (por jo bolshevik – A.K.), i krijuar në Durrës, që njihej edhe me emrin ‘Partia Nacionale’. I gjithë qëllimi i organizatës ishte të ndikonte në jetën e brendshme të vendit, duke marrë frenat e pushtetit në dorë. Pasi Mbreti Vid u largua nga Shqipëria, në shtator 1914, Krahu Kombëtar u shpërngul përkohësisht në Shkodër”.

Sejfi Vllamasi, në kujtimet e tij shkruan se “Krahu Kombëtar përfshinte elementët nacionalistë përkundrejt politikës shoviniste që ndiqnin vendet fqinje ndaj Shqipërisë.

Organizata nuk kishte kriter shoqëror, profesional apo politik. Në të hynë pa dallim moshe, civilë e ushtarakë, shumica të ardhur nga jashtë atdheut”.

(S. Vllamasi “Ballafaqime politike...”, botimi i dytë, Tiranë 1995, faqe113).

Po ku e shihni llojin “masonik” tek “Krahu Kombëtar” ju z.Myftaraj?! Mos vallë e shihni tek cilësori “kombëtar”. Po çfarë lidhjeje ka masoneria me kombëtarën more zotëri, sidomos po të kemi parasysh situatën tragjike të vitit 1914, pra në kohën kur u krijua “Krahu Kombëtar”, alias “Partia Nacionale” në Durrës, dhe më pas në Shkodër, të cilat përveçse kryeqendra të qytetërimit shqiptar, (pra edhe të kombëtarizmit të kultivuar), ishin njëkohësisht edhe epiqendra të luftës politike, tradhtive, ndikimeve antishqiptare dhe synimeve për t’u gllabëruar dhe aneksuar nga armiqtë e kombit.

A e dini ju z.Myftaraj se, në vitin 1914 Durrësi synohej njëkohësisht nga serbët dhe italianët?

A e dini ju se atëkohë, Durrësi konsiderohej “limani shpëtimtar i Serbisë për daljen në Adriatik”, ndërsa për Italinë, krahas Vlorës, si korridori allacezariano-pompeas, ku fillonte “Via Egnatia” e famshme për Perandorinë Romake, që kalonte mu në zemër të Ballkanit?

Ismail Qemali në kujtimet e tij flet hapur për interesimin e jashtëzakonshëm të Italisë për Shqipërinë dhe për situatën kritike që u krijua gjatë 6 mujorit të parë të vitit 1914, kohë që përkoji me drejtimin e qeverisë së emëruar prej Vidit. Qemali flet gjithashtu edhe për kontaktet intensive me konsujt italianë në Vlorë e Durrës dhe personalisht me ministrin e Jashtëm italian San Giuliano, i cili e ftoi me urgjencë Qemalin në Romë për të biseduar “kokë më kokë” e për t’i dhënë zgjidhje situatës së kaosit dhe tmerrit në të gjithë vendin, që kulmoi me të qëlluarin me top të shtëpisë së Esat Pashë Toptanit (ministër i Brendshëm dhe i Luftës i Vidit) dhe përkrahësve të tij nga mbështetësit e Vidit, çka shkaktoi ndërhyrjen emergjente të Italisë dhe marrjen me anije të Esatit e strehimin e tij politik në Itali.

A e dini ju z.Myftaraj se, në vitin 1915, kur trupat serbe hynë në Durrësin e pushtuar pas masakrave të përbindshme, ushtarët serbë, të marrosur, u futën në ujën e detit duke thirrur në delir “more, more bozhe moj... - det, det o Zoti im”? Dhe kjo sepse atyre u ishte premtuar se do të bëheshin zotër të Durrësit e të gjithë Shqipërisë, ashtu si kolonët serbë në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare, të aneksuara me vendimet e vitit 1913.

Shqipëria dhe sidomos portet e saj, kishin rëndësi jetike për Serbinë, pasi kështu sigurohej “çelësi i Adriatikut” dhe karakollet e Pansllavizmit në Adriatik, Jon dhe Mesdhe - ideuar që në kohën e Careshës Ekaterina.

Në terminologjinë gjeopolitike serbe, “tre limanet shqiptare (Vlora, Durrësi dhe Shëngjini)”, jo vetëm që ishin kryeobjektivë madhorë, por edhe Ylli Polar i politikës shoviniste serbomadhe, madje ishin kuintesenca e “Naçertanies”. Kjo shpjegon edhe praninë e vazhdueshme të konsullatave serbe në Vlorë, Durrës dhe Shkodër dhe infiltrimet agjenturore

të jashtëzakonshme, që kushtëzuan madje edhe zhvillimet dramatike brenda shtetit shqiptar deri në fund të vitit 1999, infiltrimet të pranishme edhe sot e gjithë ditën në këto kryeqendra dhe shpjeguese të hedhjes në erë të shtyllave të tensionit të lartë, sabotazhit dhe zbatimit të praktikave qeverisëse antishqiptare. Dhe këto synime, atëkohë, i njihnin mjaft mirë atdhetarët shqiptarë të “Krahu Kombëtar”.

Po përse nacionalistët që u organizuan politikisht “për të marrë në dorë fatet e Atdheut”, pra për ta mbrojtur atë, meritokërkan të etiketohen “masonë”?!

Po ju z.Myftaraj, që e konsideroni veten nacionalist dhe që shkruani aq shumë duke iu referuar “interesave shqiptare”, sidomos kur propagandoni edhe “Realpolitikë”, mos vallë do t’u vinte mirë t’ju etiketonin “masonë”?!

E si mund të etiketohen masonë “elementët nacionalistë përkundrejt politikës shoviniste që ndiqnin vendet fqinje ndaj Shqipërisë”!!!

Hyrja e Ahmet Zogut në politikë

Ju z.Myftaraj shkruani se “Zogu hyri në politikë si anëtar i Klikës...” dhe përsëri gaboni, sepse synoni ta nxirrni atë si produkt të Klikës, pra të “masonëve”, madje edhe “kryemason”. Jo! Zogun nuk e ndihmoi Klika, apo aderimi në Klikë, për t’u futur në politikën shqiptare. Ahmet Zogu hyri në politikë që në vitin 1912, që kur mori pushkën për të luftuar për Atdheun, në vazhden e detyrimit familjar për fatet e vendit. Pra ai hyri në politikë 2 vjet para se të krijohet Krahu Kombëtar në Durrës. Asokohe, hyrja në politikë kushtëzohej nga “kredencialet” familjare dhe sidomos nga vlerat dhe kontributet individuale, ndër të cilat cilësitë prej luftëtari në fushën e luftës dhe ideve politike, ishin determinante. Sa për “kredencialet”, Zogu i kish të shkëlqyera, si në derën ku lindi, ashtu edhe aty ku ishte nip, pra si pinjoll i dy dinastive më të famshme shqiptare, Zogollëve dhe Toptanëve. Për të hyrë në politikë, në ato kohëra tragjike kur vendoseshin fatet e Shqipërisë, Zogu e pati shumë të lehtë, që në momentin kur vendosi të “firmosë” me plumba mbi armiqtë.

Ju z.Myftaraj shkruani se “Ahmet Zogu nuk shkrehu kurrë asnjë pushkë, u ndejti larg fushëbetëve...”

Në tetor 1912 Zogu kthehet në atdhe. Pas marrëveshjes serbo-bullgare për aleancë ushtarake dhe sulm kundër Turqisë, me synimin e ndarjes së tokave shqiptare, më 16 tetor 1912 Turqia u shpalli luftë Bullgarisë dhe Serbisë dhe i përqëndroi trupat e Armatës së Perëndimit në Kosovë.

Duke shfrytëzuar rastin, malazezët sulmuan Shkodrën. Kështu Ahmet Zogu, në krye të 2 mijë matjanëve nisët drejt Shkodrës.

“Në malet e Kakarriqit, në jug të Shkodrës, Zogu u ndesh me trupat malazeze, me ç’rast u ndez një luftim i gjatë dhe i përgjakshëm... Udhëheqësi i ri, gjithmonë në vijë të parë, ngjalli entuziazmin e besnikëve, duke dhënë njëherit prova të mëdha trimërie ndaj armiqve...”

Ruhet akoma në shenjë relike familjare xhoka e tij e shpuar nga një plumb, mu në lartësinë e zemrës. Dhe kjo ishte një prej atyre xhokave të zeza që kanë veshur shqiptarët që nga viti 1467, në shenjë zie për vdekjen e paraprijësit të tij Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Mjerisht, në këtë kohë..., një korrier nga ana e Nënës Sadije, e njoftonte Zogun se Matit po i kanosej një rrezik i madh, ushtria serbe...”

Zogu u detyrua të tërhiqte trupat dhe të kthehet me shpejtësi në Mat, ku menjëherë mbledhi parinë e vendit dhe u mbajti këtë ligjëratë: "Perandoria turke po shpartallohet, madje nuk ekziston më. Atdheu ynë... po kërcënohet nga rreziku i tmerrshëm i copëtimit, kështu që sërish rrezikohemi që të biem në skllavëri. Shpresojmë se drejtësia ndërkombëtare nuk do të na braktisë, por ama, së pari e mbi të gjitha, ne ua besojmë sigurinë tonë armëve tona dhe... ja të rrojmë, ja të vdesim! Duke... mos harruar se forcat i kemi të shpërndara dhe se na mungojnë ndërlidhjet ndërmjet krahinave të ndryshme të vendit, nuk na mbetet tjetër gjë për

të bërë, vetëmse të ngujohemi nëpër grykat e maleve tona...”.

(Terenc Toçi Titulli i origjinalit: "Il re degli albanesi" {Mbreti i shqiptarëve}, përkthyer nga Beqir Ajazi, gazeta "Atdheu", tetor 2000).

Zogu në prag të shpalljes së Pavarësisë

Pas fillimit të luftës nga turqit më 16 tetor 1912, serbët, brenda dy javësh e thyen Korparmatën turke të Perëndimit në Kosovë, çka solli edhe dorëheqjen e kabinetit të Gazi Myftar Pashës më 29 tetor dhe zëvendësimin e tij me Qamil Pashën, që ishte anglofil me ndikim të fuqishëm në Londër. Qamil pasha iu drejtua për ndihmë Londrës, dhe diplomacia angleze u vu në lëvizje për të ndalur sulmin serb, duke kërkuar armëpushim të përkohshëm. Por serbët, pasi i sulmuan përsëri turqit në Çernalovë, pushtuan Prizrenin më 1 nëntor, Gjakovën më 7 nëntor dhe Manastirin më 19 nëntor.

Pas këtyre fitoreve, për ta vënë Londrën para faktit të kryer, nën inkurajimin e Ruisë dhe Francës serbët nisën marshimin drejt Lumës, Dibrës dhe Pogradecit për t'u pykëzuar në Shqipërinë e Mesme. Kjo shkaktoi alarm në qarqet patriotike shqiptare. Pikërisht në këtë kohë, Ahmet Zogu me trupat e tij përgatiti mbrojtjen e krahinës së Matit nga invazioni serb, duke i vendosur forcat nëpër grykat nga mund të depërtonte armiku, dhe menjëherë u nis drejt Vlorës.

Pas shumë peripecive, i shoqëruar nga trima të sprovuar dhe njerëz besnikë, sëbashku me Riza bej Zogun dhe Kurt Agë Kadiun, që ishin zgjedhur delegatë (kongresarë), mbërriti në Vlorë dhe firmosi shpalljen e Pavarësisë, bashkë me të gjitha vendimet e Kuvendit. Ndërkohë, fatkeqësisht, serbët kishin pushtuar Tiranën, Kavajën, Shijakun e Durrësin, deri më 30 nëntor, por nuk kishin shkelur në Mat.

Ju z.Myftaraj pretendoni se "Ahmet Zogu nuk ka qenë në Vlorë në 28 nëntor 1912 dhe se "Murat Basha" bën një falsifikim të hapur historik, duke thënë se Ahmet Zogu 17 vjeçar ka qenë në Vlorë, në krye të qindra matjanëve, në 28 nëntor 1912... Këto përralla që i shkruanin lakejtë e Ahmet Zogut kur ky qe vetëshpallur mbret, nuk është në interesin e vetë zogistëve që të përsëriten sot. Për atë që ndodhi në 28 nëntor në Vlorë ka dokumente historike dhe kujtime të pjesëmarrësve. Dokumenti i shpalljes së Pavarësisë ekziston së bashku me firmat e pjesëmarrësve në Kuvend. Emri i Ahmet Zogut nuk figuron midis tyre. Dikur Enver Hoxha shtoi në rradhët e firmatarëve 'Baba Çenin', ndërsa sot 'Murat Basha' shton Ahmet Zogun". Fakti që Ahmet bej Zogu dhe Efendi Hysen Hoxha kanë qenë delegatë në Kuvendin e Vlorës, është i pamohueshëm dhe nuk është "përrallë lakenjsh" të Zogut apo Hoxhës. Pavarësisht se cili ishte Enver Hoxha, nuk duhet të biem në pozita të mohimit të të vërtetave dhe fallsifikimit të historisë, sepse paraardhësit nuk mund të fajësohen për mëkatet e pasardhësve, sikurse edhe nuk duhen pompuar për hir të meritave, arritjeve apo vlerave të brezave vijues.

Efendi Hysen Hoxha nuk ka kurrfarë faji se qëllori të ishte xhaxhai i diktatorit, ashtu sikurse Enveri nuk ka kurrfarë merite për pjesëmarrjen dhe kontributin modest të xhaxhait të tij në Kuvendin e Vlorës.

Nëse ne do ta bëjmë historinë, jo mbi fakte e interpretime serioze por bazuar mbi mllefe dhe të pavërteta, atëherë brezat që do të vijnë, (e që nuk do të kenë kurrfarë mllefi ndaj Hoxhës apo Zogut, sikundër ju sot), do të qeshin me ne dhe nuk do të na marrin seriozisht.

Nëse Enveri mori guximin të fshijë nga dokumenti nënshkrues i kongresarëve që shpallën Pavarësinë, firmën e Ahmet Zogut - ju z.Myftaraj nuk duhet të bini në të njejtat pozita, i shtyrë nga i njejtë frymëzim urrejtjeje ndaj personazheve historikë. Historia është ajo që është, dhe nuk duhet të fallsifikohet apo zhbëhet.

Zogu në Kuvendin e shpalljes së Pavarësisë

Ju z.Myftaraj shkruani se “Ahmet Zogu shkoi në Vlorë disa javë pasi u ngrit flamuri, siç ka thënë në kujtimet e veta Eqerem bej Vlora, në shtëpinë e të cilit bujti Ahmet Zogu. Sigurisht që Zogu erdhi në Vlorë sepse e pa që po ngrihej një pushtet i ri në Shqipëri dhe ai donte të ishte në lidhje me të për të përfituar një copë nga torta e pushtetit, siç thuhet sot”.

Por në proces-verbalin e Kuvendit Kombëtar, të botuar në gazetën “Përlindja e Shqipërisë”, Vit’i II, Nr. 10, datë 14 shkurt 1914 dhe sipas “Dokumente Historike” të Lef Nosit, Nr. 4, faqe 119-125, qershor 1924, dhe Nr. 5, faqe 152-157, korrik 1924, Elbasan, si dhe të materialeve të Arkivit të Shtetit, shkruhet se në Kuvendin e Vlorës morën pjesë këta delegatë:

Berati: Sami bej Vrioni, Iljaz bej Vrioni, Taq Tutulani, Babë Dud Karbunara; Skrapari: Xhelal bej Koprencka (Skrapari); Hajredin bej Cakrani; Lushnja: Qemal bej Mullai, Ferid bej Vokopola (Lushnja), Nebi Efendi Sefa; Dibra: Myfti Vehbi Dibra, Sherif Lengu; Mati: Ahmet bej Zogolli, Riza bej Zogolli, Kurt Agë Kadiu; Ohri dhe Struga: Zyhdi bej Ohri, Dr. H. Myrtezai, Nuri Sojlliu, Hamdi bej Ohri, Mustafa Baruti, Dervish bej Hima; Durrësi: Abaz Efendi Çelkupa, Mustafa Agë Hanxhiu, Jahja Ballhysa, Dom Nikollë Kaçorri; Tirana: Abdi bej Toptani, Murat bej Toptani; Shijaku: Xhelal Deliallisi, Ymer bej Deliallisi, Ibrahim Efendiu; Kruja: Mustafa Kruja; Elbasani: Lef Nosi, Shefqet bej Daiu, Qemal bej Karaosmani, Dervish bej Biçaku; Peqini: Mahmud Efendi Kaziu; Gramsh-Tomorrinë: Ismail Qemali (jo Ismail bej Qemal Vlora); Gjirokastra: Azis Efendi Gjirokastra, Elmaz Boçe, Veli Harxhi, Myfid bej Libohova, Petro Poga, Jani Papadhopulli, Efendi Hysen Hoxha (xhaxhai i Enver Hoxhës); Përmeti: Veli bej Këlcyra, Syrja bej Vlora; Tepelena: Feim bej Mezhgorani; Janina: Kristo Meksi, Aristidh Ruci; Çamëria: Veli Gerra (Rashadia), Jakup Veseli (Margëlliçi), Rexhep Demi (Filati), Azis Tahir Ajdonati; Delvina: Avni bej Delvina; Korça: Pandeli Cale, Thanas Floqi, Spiro Ilo, Pogradeci: Hajdar Blloshmi; Kosova, Gjakova, Plavë-Gucia: Rexhep bej Mitrovica, Bedri bej Ipeku (Pejani), Salih Gjuka, Mit’hat bej Frashëri, Mehmet Pashë Derralla (Tetova), Isa bej Boletini, Riza bej Gjakova, Hajdin bej Draga, Dervish bej Ipeku, Zenel bej Begolli (Peja), Qerim Begolli; Shkodra: Luigj Gurakuqi; Vlora: Ismail bej Qemal Vlora, Zihni Abaz Kanina, Zyhdi Efendi Vlora, Qazim Kokoshi, Jani Minga, Eqerem bej Vlora; Kolonia shqiptare e Bukureshtit: Dhimitër Zografi, Dhimitër Mborja, Dhimitër Berati, Dhimitër Ilo.

Zogu nuk krijoi mite, por luftoi

Ju z.Myftaraj shkruani se “Ahmet Zogu krijoi për vete mitin e komandantit të shquar ushtarak, e luftëtarit të madh, çka ashtu si në rastin e Enver Hoxhës që vetëm një përrallë e rreme”.

Zogu mori edukim ushtarak, dhe në kohën që ai hyri në politikë, pra në vitin 1912, “profesioni më i kërkuar” ka qenë ai i luftëtarit, ndërkohë që mundësitë për të shfaqur talentin drejtues e administrativ ishin minimale, për shkak të mungesës së shtetit, gjendjes së luftës dhe anarkisë totale.

Zogu, “profesionin” e luftëtarit e kreu me nder dhe shkëlqyeshëm.

Krahasimi i Zogut me Enver Hoxhën është absurd, pasi ky i fundit jo vetëm ka qenë profan në artin ushtarak, por ka qenë drejtues i një ushtrie që ka bërë sikur ka luftuar, (nëse mund të quhet luftë, vrasja e robërve italianë, e fshatarëve të lidhur, apo pushkaktimi i partizanëve si dezertorë ose “shkelës të moralit komunist”). Dhe për këtë flet më së miri bilanci i okupatorëve të vranë nga partizanët e Hoxhës gjatë LDB.

Enveri ka qenë “komandant” bazash ilegale dhe shtabesh në zonat e çliruara, ndërsa Ahmet Zogu ka qenë prijës popullor i besnikëve fshatarë të thjeshtë, që donin të shihnin komandantin në krye, dhe jo fshehur pas ferre. Për aftësitë prej strategu ushtarak të Zogut, flasin më mirë

sukseset në betejat në krye të malësorëve (pra ku nuk kish ushtarakë karriere), si dhe sukseset në operacionet për shtypjen e rebelimeve dhe vendosjen e rendit, të cilat e mbuluan me lavdi, qoftë për nga rezultati, qoftë për nga kostot minimale njerëzore të njësive që komandoi. Ja si e përshkruan Faik Konica Ahmet Zogun në bisedën në Radio “Uashington Times”, më 17 janar 1932: “Unë e pashë Mbretin Zog për herë të parë në vitin 1913. Atëherë ai ishte djalosh 18 vjeçar, por me një reputacion të madh personal, për patriotizëm, kurajo të jashtëzakonshme dhe mendjehollësi. Në këtë moshë, në krye të 2 mijë trimave, ai ka luftuar për Pavarësinë e Shqipërisë, duke qenë gjithmonë i pari atje ku është rreziku. Në fillim të Luftës së Parë Ballkanike, Zogu organizoi forcat e tij dhe i komandoi në Kakarriq të Shkodrës, ku u ndesh me forcat serbo-malazeze. Më 28 nëntor – 7 dhjetor 1912, Zogu përfaqësoi Matin në Kuvendin e Vlorës”.

Ndërsa ish ambasadori i SHBA-ve në Shqipëri gjatë viteve 1935-1939 në Mbretërinë Shqiptare, z. Hugh H. Grant, në kujtimet e tij të botuara në librin “Me jetue në shekullin e sotëm” (“Dardania Tiranë, botim i vitit 1995), shkruan: “... Unë besoj se historia, në gjykimin e saj të fundit, të drejtë dhe të paanshëm, do ta përmendi Zogun e Parë - Mbret i Shqiptarëve, si një nga udhëheqësit më të famshëm ushtarakë dhe politikë të kohës së tij, si një prijës patriot dhe trim, me një inteligjencë dhe zgjuarësi të jashtëzakonshme...”.

Noli u këndoi trimërive të Ahmet Zogut

Ju z. Myftaraj shkruani gjithashtu se “Zogu nuk shkrehu asnjë pushkë kundër serbëve, as kur këta hynë në Shqipëri në 1915, me synim për të dalë në Durrës”.

Për të provuar se ju sërish gaboni, po citoj një shkrim me vlerësime superlative të Nolit për luftërat dhe heroizmat e Zogut kundër serbëve, në Mat dhe në të gjithë Shqipërinë e Mesme, në vitet 1914-1915. Në këtë shkrim të tij, që nga Amerika, botuar në gazetën “Dielli” të datës 16 shkurt 1916, kushtuar figurës së Ahmet Zogut, Fan Noli është frymëzuar nga një letër që ka marrë nga Nikollë bej Ivanaj, pjesëmarrës në ushtrinë shqiptare të udhëhequr nga Ahmet Zogu. Ishte fjala për veprimet luftarake të asaj ushtrie, për të paralizuar kryengritjen rebele të Haxhi Qamilit të vitit 1914, si dhe për qëndresën e suksesshme të saj në përballimin e forcave esadiste dhe atyre serbe.

Noli, i cili e njihte edhe më parë veprimtarinë patriotike të Zogut, që nga pjesëmarrja në Kuvendin historik të Vlorës më 28 nëntor 1912, nuk i kursen lavdet e merituar për Zogun, në të gjitha cilësitë pozitive njerëzore dhe aftësitë e tij si ushtarak dhe burrshteti i denjë për një vend të përparuar evropian.

Në shkrimin e tij Noli, ndër të tjera, thekson tekstualist: “Nga letra që botuam dje, mësuam që i dëgjuari atdhetar, zoti Nikollë bej Ivanaj ndodhet në ushtrinë shqipëtare të Ahmet bej Matit. Zoti Ivanaj, në vend që të mbetet në Shkodër a të shkojë në Europë, mori malet, kapërceu Mirditën dhe vajti në Malësinë e Matit, që të përhapë nëpër malësorët e Gegërisë propagandën kombëtare. Tani mësojmë që ushtëria malësore, me të cilën ndodhet zoti Ivanaj, do të ketë hyrë në Tiranë..., a në Elbasan..., dhe do të kenë ngritur flamurin e Shqipërisë kudo që ka shkelur.

Ahmet bej Mati, me të cilin bashkëpunon Nikollë bej Ivanaj, është djalë fare i ri, i hollë, i gjatë, me leshra të verdha, me sy të kaltër, duket më tepër si inglis a skandinav. I urtë në fjalë, të cilat i ka të pakta dhe të matura, i ëmbël në mënyrat dhe në sjelljet, jep më tepër përshtypjen e një diplomati evropian, se sa të një bajraktari të malësive të egra. Shënjt nga fytyra, por luan nga zemra dhe hekur nga karakteri. Dhe e provoi me punë. Mati është i vetëm vend i Gegërisë që s’u shkel nga serbi, as në luftën ballkanike, as në luftën evropiane. Ahmet Zogolli, në krye të matjanëve të tij, e mprojt nga armiku i huaj dhe e mbajti lart flamurin e Skënderbeut. Tani mësojmë nga letra e Ivanajt që lufton në krye të një ushtërije prej 1500 malësorësh, që ka grirë 20 mijë serbë, që ka zënë 10 mijë robër prej syresh dhe po baret

(ecën) kundër Durrësit...

Kur të shkruhet plotësisht historia e këtij trimi malësor, i cili, i rrethuar prej armiqësh nga të gjitha anët, qëndroi si shkabë në malet e tij dhe nuk iu unj as serbit, as Esatit, as u korruptua me ryshfetet e armiqëve, bota do të këndonjë me çudi dhe admiratë një epokë heroike që kapërcen atë të kalorësve të qëmotshtëm.

E paçim sa malet.”.

Rënia e qeverisë së Ismail Qemalit dhe Zogu

Ja si shkruan Ismail Qemali për rënien e qeverisë së Vlorës në kujtimet e tij: “... Qeveria ime mundi të vendosi qetësinë duke siguruar një administratë normale. Por megjithë rezultatet e kënaqëshme, e ardhmja mbetej ende e errët, derisa çështja e Sovranit të ardhshëm nuk ishte vendosur. Për këtë arsye u drejtova Fuqive të Mëdha një kërkesë të ngutëshme si vijon: ‘Qeveria e Përkohëshme e Shqipërisë, që për njëmbëdhjetë muaj po has vështirësi të panumërta, ka mundur të mbajë qetësinë dhe rendin në një vend të sulmuar nga çdo anë nga armiq, të betuar që ta çfarosin – por tani e tutje nuk e merr më mbi vete këtë zotësi... Nxitohemi t’ju parashtrijmë për konsideratë shprehjen e njëzëshme të dëshirës së popullit e të Qeverisë t’onë, për caktimin në Fron të një Sovrani, i cili me qenien e tij vetëm do të mjaftonte të bashkonte të tëra klasat e popullit në punën për fuqizimin e Shqipërisë dhe organizimin e administratës. Me shpresë se Fuqitë garantonjëse do ta marrin kërkesën tonë parasysh me seriozitet...”.

Unë iu drejtova Komisionit të Kontrollit duke i lutur... ndaj nevojës së ngutëshme për hipjen në Fron të Sovranit të ri...

Në rast se arsye të veçanta pengonin ardhjen e Princit, kërkova që Komisioni të marrë përsipër qeverisjen e vendit në emër të tij, ose Fuqitë t’i jepnin udhëzime Komisionit për të qeverisur në emër të tyre. Sipas mendimit tim, vetëm kjo ishte rruga e vetme për të rregulluar vështirësitë e brendshme, duke pushuar intrigat që synonin të sillnin çrregullime në vend. Kërkesa ime më së fundi u pranua nga Fuqitë, dhe përfaqësonjësit erdhën të më njoftojnë se ishin emëruar nga qeveritë e tyre të ndryshme për të marrë në dorë qeverimin e vendit. Më poshtë Qemali vazhdon: “Sot, më 22 janar 1914, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit u mblodh..., i bindur se mjeti i vetëm për t’i dhënë fund anarkisë dhe çrregullimit në vënd, është të ngrihet një qeveri e vetme për tërë Shqipërinë...”

Komisioni ndërkombëtar i Kontrollit..., i ngarkuar për këtë nga Fuqitë e Mëdha, merr përsipër qeverimin e Shqipërisë në emër të qeverive përfaqësuese përkatëse...

Firmosur: Ismail Qemali, Nadolny, Petroviç, Krajevski, Harry Lamb, Leoni, Petrov”.

(A e shihni z.Myftaraj se diplomati i madh, i plakur në politikë, nuk ishte në gjendje të qeveriste, ndaj edhe kërkonte ndihmë nga të huajt, ndërsa Ahmet Zogu bëri zap të gjithë armiqtë e jashtëm, rebelët dhe kopukët e Shqipërisë, që në moshën 17 vjeçare! “Minjtë duan dacin” z.Myftaraj, që të futen nëpër vrima e gjirize. Shtëpia do zot, shteti do shtetarë!)

Shqiptarët e mirëpritën ardhjen e Vidit

Në kushtet e kaosit, anarkisë, pranisë së ushtrive të huaja, terrorit të bandave dhe rrezikimit edhe të kufinjve që kish vendosur Konferenca e Ambasadorëve, vendimi i Fuqive të Mëdha për emërimin e një Sovrani në fronin shqiptar dhe mbrojtja e tij bashkë me sovranitetin e territoreve të mbetura, ishin shpëtimtare për Shqipërinë. Asokohe, autoriteti i Qeverisë së

Vlorës kufizohej në trekëndëshin Vlorë-Berat-Lushnje.

Vendimi i 6 Fuqive të Mëdha, i datës 29 korrik 1913, në mbështetje të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve, për Shqipërinë përcaktonte formimin e një “Principate Sovrane, të trashëgueshme e neutrale, nën garancinë e Fuqive...”.

Vilhelm Vidi, pinjoll i një dinastie të vjetër të Renanisë, shkurorëzuar nga Napoleoni, ishte nip i Mbretëreshës Elisabetë të Rumanisë (Karmen Silvës). Ai zbriti në Durrës nga një kryqëzor më 7 mars 1914, bashkë me familjen dhe shpurën personale, dhe çuditërisht zgjodhi Durrësin për kryeqytet.

Ardhjen e tij e priti me gëzim populli dhe e gjithë paria shqiptare. Ndërmjet krerëve shqiptarë, Princ Vidit i uroi mirëseardhjen edhe Ahmet Zogu, si përfaqësues i krahinës së Matit, i cili, ashtu siç i takonte, i premtoi “besnikëri dhe bashkëpunim nëse e lypte nevoja”.

Mendjendrituri Ismail Qemali në kujtimet e tij, për ardhjen e Vidit, shkruan: “... Pak kohë pas kësaj kërkesë, (pra drejtuar Fuqive të Mëdha për vendosjen në fronin e Shqipërisë të një Sovrani të njohur e të mbrojtur prej tyre), u ndie të zihesh në gojë emri i Vidit në lidhje me Shqipërinë...”.

“... u njoftova pakë kohë më vonë zyrtarisht se gjashtë Fuqitë e Mëdha kishin arritur një vendim njëzëri dhe kishin zgjedhur për Sovran të Shqipërisë Princ Guljelm Vidin...”.

“... Nisja e tij u njoftua po ende nuk po vinte. Këto vonesa të pashpjeguara u shfrytëzuan nga Turqit e Rinj, që filluan fushatën e tyre me vrull, në favor të një princi turk. Mbreti ynë vuri këmbën në tokën e shenjtë të Atdheut, i shoqëruar nga Flota e Gjashtë e Fuqive të Mëdha... Me anijen që solli Princ Vidin kishte sjellë edhe 10 milion franga, që Austria e Italia kishin parapaguar, nga shuma e 75 milion frangave që Fuqitë kishin vendosur të derdhnin, e që s’kishin ardhur ende...”.

Vijon në numrin e ardhshëm

Polemikë me z.Kastriot Myftaraj rreth shkrimit "Zogistëve u hyn paniku nga zbulimi i të vërtetave" (4)

vijim...

Politika e Zogut para dhe pas Luftës së Parë Botërore

I vendosur për të zbatuar vendimet e Kuvendit të Pavarësisë, Zogu ideoi zhvillimin e një Kuvendi Kombëtar në Elbasan, me synimin e zgjedhjes së një Asambleje Kombëtare, që do të merrte vendimet për krijimin e një qeverie dhe të një administrate vendore në të gjitha territoret e vendit.

Nga Astrit Kola

Kaosi dhe anarkia shoqëruan qeverisjen e Vidit

Më 22 janar 1914, me kërkesën dhe pëlqimin e Fuqive të Mëdha, Ismail Qemali dha dorëheqjen. Komisioni i Kontrollit që mori në dorëzim kompetencat dhe çelësat e qeverisjes së vendit, nuk e çau fort kokën për detyrimet që kish ndaj shqiptarëve, por shtyu ditët në limonti deri në ardhjen e Princ Vidit. Në këto kushte, situata e rendit doli jashtë kontrollit, çka dikur e kish detyruar edhe të gjorin plak, Ismail Qemalin, që të negocionte me Beqir Grebenenë në kërkim të një dore të fortë, aq më tepër që edhe ministri ushtarak i qeverisë, Esat Pashë Toptani, e kish braktisur dhe kish formuar qeverinë e Durrësit. Pra Vidi e gjeti rendin të pastabilizuar, por kundër këtij realiteti ai nuk veprroi. Ndonëse, në kërkim të dorës së

fortë, Vidi emëroi Esat Pashën si ministër të Brendshëm, situata e rendit u përkeqësua. Ja si e përshkruan Ismail Qemali qeverisjen e Vidit dhe paaftësinë e tij në kujtimet e veta: “Mbretërimi i shkurtër i Vidit, i pasur më shumë me ngjarje të çuditshme sesa në vepra që kishin për qëllim riorganizimin e një shteti të porsalindur, vinte në dukje kujdesin e pakët që treguan Fuqitë e Mëdha në zgjedhjen e Sovranit për një vend, lumtëria e të cilit varej vetëm në një zgjedhje të përshtatshme. Ne shpresuam, por përkundrazi, gjendja sa vinte e po ngatërrohej më shumë dhe, në një kohë të shkurtër, u bë me të vërtetë kritike... Demonstratat popullore në të gjithë vendin morën një karakter kërcënonjës; por në vend që të përpiqej që të qetësojë popullin kur ngatërresat arrijnë kulmin, Princi e priti popullin me top... Princi, duke vepruar ndënjë shtytjen e një ndikimi që nuk jam i zoti ta shquaj, përsëri mori masa të rrepta, duke pasuar një vijë veprimi që nuk ka shëmbëll në analet e Qeverisë... Konsulli italian më dorëzoi një telegram nga ministri i Jashtëm i Italisë, San Giuliano, me anë të të cilit kërkonte pikëpamjet e mia rreth punëve shqiptare dhe rreth masave që duhet të merreshin tani, meqenëse gjendja po bëhej gjithnjë e më alarmonjëse..., dhe, si pasojë, shkova në Romë...”.
Sapo u ktheva në Vlorë, mësova... se Durrësi ishte rrethuar nga të katër anët dhe asnjë lëvizje nuk ishte e mundur midis Durrësit dhe pjesës tjetër të vendit. Autoriteti suprem i Mbretit tonë ishte kufizuar në këtë qytet të vogël me 5 mijë banorë, pa ndonjë rëndësi... U nisa për në Durrës me 15 përfaqësues të parisë së Vlorës, për t’i parashtruar Princit pikëpamjet tona rreth situatës, pikëpamje që pajtoheshin me ato që kisha arritur në marrëveshje me San Giuliano-n.

Në një takim vetëm për vetëm me të, i tregova rreth vendimeve që kishim marrë dhe për masat që mendonim të merreshin. Princi më dha përshtypjen se nuk kish asnjë ide të tijën rreth gjendjes së punëve dhe se as nuk shikonte dot gjendjen shumë kritike të punëve të përgjithshme. Dukesh që nuk ishte i zoti që të bëjë një vërejtje, ose që të bëjë një pyetje si pasojë e mendimit të tij personal. Ndërsa po i shtjelloja masat e ndryshme që duhet të merreshin për të dalë nga këto vështirësi, asnjëherë nuk më pyeti se si mendoja për t’i vënë këto masa në praktikë...”.

Në një takim vetëm për vetëm me të, i tregova rreth vendimeve që kishim marrë dhe për masat që mendonim të merreshin. Princi më dha përshtypjen se nuk kish asnjë ide të tijën rreth gjendjes së punëve dhe se as nuk shikonte dot gjendjen shumë kritike të punëve të përgjithshme. Dukesh që nuk ishte i zoti që të bëjë një vërejtje, ose që të bëjë një pyetje si pasojë e mendimit të tij personal. Ndërsa po i shtjelloja masat e ndryshme që duhet të merreshin për të dalë nga këto vështirësi, asnjëherë nuk më pyeti se si mendoja për t’i vënë këto masa në praktikë...”.

Në një takim vetëm për vetëm me të, i tregova rreth vendimeve që kishim marrë dhe për masat që mendonim të merreshin. Princi më dha përshtypjen se nuk kish asnjë ide të tijën rreth gjendjes së punëve dhe se as nuk shikonte dot gjendjen shumë kritike të punëve të përgjithshme. Dukesh që nuk ishte i zoti që të bëjë një vërejtje, ose që të bëjë një pyetje si pasojë e mendimit të tij personal. Ndërsa po i shtjelloja masat e ndryshme që duhet të merreshin për të dalë nga këto vështirësi, asnjëherë nuk më pyeti se si mendoja për t’i vënë këto masa në praktikë...”.

Gafat antishqiptare të Vidit

Në postin e Sovranit të vendit, sidomos i garantuar edhe nga Fuqitë e Mëdha, të cilat ishin bërë garante gjithashtu edhe për zbatimin e vendimeve të Konferencës së Londrës për sovranitetin e kufinjve të Mbretërisë së Vidit, ky i fundit as që e kish konceptin dhe as që arrinte të kuptonte rëndësinë e problematikës së komplikuar në marrëdhëniet me fqinjët, e jo më të sillej si Sovran i një shteti “Sovran”. Kështu, me papërgjegjshmërinë më të skajshme, ai hyri në negociata me “Qeverinë e përkohshme të Epirit të Veriut”, krijuar nga Greqia dhe drejtuar nga antishqiptari Zografos, dhe në zbatim (!!!) të Protokollit të Korfuzit të majit 1914, i njohu kësaj qeverie të drejtën e “Autonomisë...” dhe të drejta të tjera, që binin në kundërshtim me interesat shqiptare, e që, më pas, hapën oreksin e Greqisë dhe “vorio-epirotëve”.

Ky veprim, me të drejtë, u përjetua si tradhti kombëtare nga Krahu Kombëtar, nga të gjithë nacionalistët shqiptarë, ndër të cilët edhe Zogu.

Ahmet Zogu i ofroi ndihmë ushtarake Vidit për vendosjen e rendit, por ai e refuzoi...

Ja si shkruan Terenc Toçi për raportet e Zogut me Vidin: “Zogu është treguar fisnikërisht i sinqertë me Princ Vidin, të cilin Fuqitë e Mëdha e patën hipur në fronin e Shqipërisë. Por Sovrani i atëhershëm i Shqipërisë - i cili, ndonëse pati mbetur me përshtypje shumë të mira për intelektin e fuqishëm të Zogut..., - nuk pati intuitën të kuptonte se kush ishte Zogu, dhe nuk pati në krah gjithashtu as dikë që do të dinte t’ia mbulonte boshllëqet që ai shfaqte në të kuptuarit e gjërave.

(Terenc Toçi, gazeta “Atdheu”...).

Në kujtimet e tij, Ismail Qemali shkruan: “Ky mbretërim i hidhur dhe i kotë, arriti në çastet e tij të fundit... Princi kish humbur çdo autoritet dhe sovraniteti i tij kish humbur krejt. Asnjë fond financiar nuk kish ngelur nga të 10 milionët që i qenë dhënë si paradhënie, të cilat Princi i kishte shpenzuar në mënyrë fare të pa mënt, në gjëra si në krijimin e Gjyqit të Lartë të Diktimit (cour de Cassation), në një kohë kur nuk kishte as gjyqe të thjeshtë të shkallës së parë; emërimi i inspektorëve për edukatën botërore, kur nuk kishte ende shkolla; dhe emërimi i ministrave (ambasadorëve) për në vënde të huaja, të cilët nuk luajtën fare nga shtëpia, përveçse morën rroga të majme”.

Për të ilustruar miopinë, paaftësinë dhe papërgjegjshmërinë politike të Vidit, Bernd Fisher shkruan: “Për fatqeqësinë e tij të mëvonshme, Vidi e pat pranuar fronin, pa qenë plotësisht i vetëdijshëm se çfarë kishte bërë...”.

(B.J.Fischer “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”, f. 19)

Dështimi i hatashëm i Vidit

Ju z.Myftaraj, për të përbaltur Ahmet Zogun me tradhti, shkruani se “Zogu u tregua i pabesë edhe ndaj Mbretit Vid, i cili i dha armë, municion, pare e ndihma të tjera, pasi Zogu i premtoi se do ta ndihmonte për të shtypur rebelimin. Zogu e tradhëtoi Vid-in në një moment të vështirë”.

Paaftësia proverbiale e Vidit për menaxhimin e situatave, sidomos pas shpërthimit të kryengritjes së Haxhi Qamilit, e stimuloi anarkinë dhe çoi në precipitimin e shpejtë të ngjarjeve dramatike. Vidi jo vetëm që nuk e armatosi dhe financoi Zogun, sikundër ju z.Myftaraj shkruani, por nuk i dha asnjë mandat për të vepruar. Megjithatë, kjo shmangie, jo e rastit, nuk i hiqte të drejtën Zogut që të kuptonte se ky Sovran nuk duhej respektuar deri në inaktivitet të plotë, aq më tepër kur veproi në kundërshtim me interesat kombëtare në raportet zyrtare ndërshtetërore me fqinjët, duke stimuluar agresivitetin e tyre për coptimin e trojeve të tjera, për të cilat Zogu dhe ithtarët e tij kishin luftuar me heroizëm të pashoq.

Në kujtimet e tij Terenc Toçi thekson: “Nëse Princ Vidi, kur zbriti fillimisht në Durrës, do t’u kishte besuar forcave ushtarake të Zogut, vullnetarëve të Shkodrës dhe të Kosovës, të paktën do të kishte arritur të shmangte vëllavrasjen ndërmjet shqiptarëve... Zogu bëri gjithçka mundi për të shmangur këtë. Ai u përballi i vetëm me ata që mohonin atdheun”.

Zogu u tregua shumë i kujdesshëm në veprimet e tij politike dhe ushtarake, por afërmendsh që fatet e pasuesve dhe krahinës së tij nuk i la në mëshirën e pasivitetit fatal të Vidit, aq më tepër kur kuptoi se ai e humbi totalisht mbështetjen ndërkombëtare, sidomos pas shpërthimit të LPB, kur u bë e qartë se askush nuk po pyeste më për shqiptarët dhe fatet e tyre, pra as për vendimet ndërkombëtare për “Sovranitetin” e shtetit të ri shqiptar.

Zogu ishte tepër inteligjent për të kuptuar, sa hap e mbyll sytë, se mbështetja e Vidit nga garantët kryesorë të tij, Austria dhe Italia, po shkonte me shpejtësi drejt zeros, ndërkohë që Gjermania as që e kishte në hesap këtë teveqel të rrjedhur të cilin, Kajzeri, që e njihte sa i vllente lëkura, e këshilloi të mos e synonte fronin e Shqipërisë, por Vidi nuk e dëgjoi, pasi i kish marrë koka erë për fron e pushtete.

Nëse Zogu e kuptoi menjëherë hiç-vlerën e Vidit, konform kodit të besës prej malësori, nuk iu kundërvu dhe kurrë nuk e cënoi, qoftë edhe verbalisht, autoritetin e tij prej Sovrani, ndonëse mori masa efektive për të neutralizuar pasojat negative të marrëzive të tij qeverisëse.

Ja si e përshkruan Ismail Qemali situatën e pashpresë të Vidit në kujtimet e tij: “Megjithëse Vidi dërgoi ministrin e tij të Financave në Romë dhe në Vjenë për ndihma të reja, Italia dhe Austria e bënë veshin të shurdhër. Si spekulatori që ka humbur tregtinë e filluar, Vidi e kuptoi se nuk i kish mbetur gjë tjetër veçse të largohej. Lufta e madhe kish filluar dhe shpejt do të mbulonte Evropën të tërë. Flota e Fuqive të Mëdha e la Durrësin në fatin e tij dhe u largua. Dhe Princ Vidi e pasoi duke hypur në një jaht Italian, që ia kishin lënë ta përdorte... Ai nuk bëri asgjë, s’bëri asnjë përpjekje që t’i kuptonte bashkatdhetarët e mi e të merrej vesh

me ta”.

Ndërsa studiuesi serioz Ilir Ushtelenca, nga analiza e zhvillimeve të atëkohshme, konkludon: “Në maj të atij viti, nën udhëheqjen e Haxhi Qamilit u ngrit në këmbë gjithë fshatarësia e Shqipërisë së Mesme, për të rrëzuar Mbretin e importuar dhe Qeverinë e Durrësit...”.

(Ilir Ushtelenca “Diplomacia e Mbretit Zog I”, f. 27)

Më 3 shtator 1914, Vidi u largua nga Shqipëria, duke lënë pas anarki totale, zhgënjim dhe ndjenjën e braktisjes së një populli të tërë nga Fuqitë e Mëdha. Për Shqipërinë dhe shqiptarët, si gjithmonë, menduan vetëm nacionalistët, ndër të cilët shkëlqente Ahmet Zogu.

Në analizën e tij për periudhën e “mbretërimit” të Vidit, Terenc Toçi konkludon: “Nëqoftëse Vidi do të ishte mbështetur në kohën e duhur në fuqinë e krahut dhe të mendjes së Udhëheqësit 18-vjeçar shqiptar (Zogut – A.K.), ai do ta kishte shpëtuar, në mos tjetër..., procedurën e likuidimit të mbretërisë së tij efemere; dhe nuk do ta kishte përcjellë në botën e qytetëruar dyshimin se atë e kishin braktisur nacionalistët shqiptarë”.

Ndërsa Bernd Fisher i vë vulën tek thekson se “Periudha e Princ Vidit ishte më tepër për t’u marrë si shembull se si nuk duhet ndërtuar dhe qeverisur një monarki nga një monark”.

(B.J.Fischer “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”, f. 142)

Vizioni i Zogut për shpëtimin e vendit gjatë viteve 1912-1915

Pas refuzimit për të shërbyer pranë Ismail Qemalit, (dhe më pas pranë Vidit), Zogu iu përmbajt zotimit për të njohur sovranitetin e qeverisë së Vlorës, për zbatimin e vendimeve të Kuvendit për jetësimin e Pavarësisë dhe konsolidimin e shtetit të ri shqiptar - si rruga e vetme për evitimin e coptimit të territoreve të Shqipërisë londineze. Por fatkeqësisht, Qeveria e Vlorës nuk arriti ta shtrinte sovranitetin në të gjithë territorin e vendit, të cilin kish detyrimin dhe që e mori përsipër ta qeverisë. Jo vetëm kaq, por koncepti i Ismail Qemalit për vendosjen e rendit bazohej tek ndihma ndërkombëtare e Komisionit të Kontrollit, tek ish kaçaku e më vonë shqytari i tij, Sali Vranishti, dhe tek çeta e tij, që garantonin qetësinë nga hajdutët vetëm në krahinën e Vlorës. Dhe së fundi, duke kulmuar naivitetin dhe mungesën e vizionit qeverisës, Qemali u bazua tek ndihma e Beqir Grebenesë (e që i kushtoi shumë reputacionit të tij para ndërkombëtarëve, të cilët mezi e çliruan nga akuzat, në këmbim të dorëheqjes), akuza për “organizimin e çetave të ish kaçakëve”, (përfshirë edhe Çerçiz Topullin), për t’i përdorur si krah i armatosur në mbrojtje të qeverisë së Vlorës dhe autoritetit të saj, që asokohe shtrihej në pak rrethe!!!

Aftësitë e rralla, mbështetjen e fortë dhe fuqinë ushtarake të Zogut i kuptoi mirë Esat Pasha, teksa i kërkoi bashkëpunim për të marrë në zotërim pushtetin, për çka Zogu refuzoi prerë, duke i dhënë kështu spunto armiqësisë së përjetshme midis tyre.

Nëse Zogu do të pranonte ofertën e Esatit, në bashkëpunim me të, brenda pak kohësh do të arrinte ta bënte zap vendin. Por refuzoi, sepse, në atë kohë, ambiciet pushtetore që binin ndesh me interesat kombëtare, në optikën e Tij përbënin tradhti ndaj Atdheut, dhe Ai nuk mund ta pranonte këtë.

Nëse Zogu sulmoi dhe mori Krujën mu në hundët e rebelëve të Haxhi Qamilit, këtë e bëri për t’i shërbyer vendosjes së rendit dhe ruajtjes së autoritetit e sovranitetit të një monarku të gjithëpranuar dhe të garantuar nga ndërkombëtarët, çka konvenonte me idenë e tij për domosdoshmërinë e konsolidimit të shtetit të ri shqiptar. Po kur pa se i gjithë vullneti i Vidit përmbli dhe vetëm në ruajtjen e Durrësit-rezidencë, thënë ndryshe vetëm në ruajtjen e lëkurës së tij, (megjithëse Vidi nuk ngurroi t’i qëllonte kundërshtarët me top), atëherë Zogu vendosi t’i kthejë 2 mijë luftëtarët e tij në Mat, për të evituar gjakderdhjen dhe luftën civile, që u interesonte vetëm armiqve të Shqipërisë. Por Zogu u tërhoq drejt Matit vetëm pasi e lau shpirtin, teksa u bëri rixha rebelëve, me anë të një letre, ku u bënte thirrje që të ndalonin gjakderdhjen, ndërkohë që ata kishin pushtuar Tiranën dhe Shijakun, ku bënë masakra të përgjakshme.

Por më parë se të ndodhnin këto zhvillime, Zogu kish mbledhur në kuvend parinë e Matit e të Dibrës, së cilës u bëri të qartë gjendjen katastrofike të vendit, që qeverisej njëkohësisht nga tre qeveri: “Anarkia esadisto-haxhiqamiliste, Qeveria fantazmë e Vidit dhe Komisioni i Kontrollit, me seli në Vlorë dhe në Shkodër.

Fatkeqësisht, krerët shqiptarë asnjëherë nuk e kuptuan protestën e drejtë të Zogut për mospranimin e sovranëve të huaj. Sipas tij, “e drejta e zgjedhjes së një trashëgimtari të kurorës së Skënderbeut ishte atribut vetëm i popullit shqiptar, dhe mund të bëhej vetëm me zgjedhjen dhe miratimin e Sovranit nga një Asamble Kombëtare të zgjedhur nga populli”. Por paria “europeisto-ndërkombëtariste”, e cila ishte mësuar dhe edukuar nën perandorinë turke, duke pritur e miratuar vetëm vendime dhe fermane padishahësh (ashtu si edhe sot), nuk e rroku idenë e propozimit të Zogut, dhe delegacioni i Qeverisë së Durrësit u nis për në Gjermani, për t’i përcjellë mesazhin dhe dëshirën për kurorëzim Vidit, (me kurorën e Sovranit të Shqipërisë), dhe kësaj marrëzie ia panë mirë hajrin.

Si konkluzion: Ahmet Zogu e kish kuptuar se shpëtimi i Shqipërisë ishte vetëm produkt i atdhetarëve shqiptarë, i vullneteve të fuqishme për ta bërë këtë, dhe pastaj, sigurisht, edhe nëpërmjet mbështetjes dhe aleancave ndërkombëtare.

Lufta Parë Botërore i shembi të gjitha këto iluzione, por kurrë qartësinë dhe drejtësinë e parashikimeve dhe zgjidhjeve politike të Ahmet Zogut.

Lufta Parë Botërore dhe Zogu

Ju z.Myftaraj shkruani se “Ahmet Zogu qe një frikacak që gjithë jetën u qe shmangur luftrave...”, por zhvillimet e poshtëtrajtuarja ju përgënjeshtrojnë.

Shpërthimi i LPB më 28 korrik 1914, lufta civile esadisto-qamiliste, pozicionimi i palëve ndërluftuese, pushtimi i vendit nga ushtritë e huaja gjatë viteve 1914-1915, shndërrimi i tij në një shesh beteje dhe, së fundmi, futja e ushtrisë austriake në Shkodër më 2 janar 1916, i dhanë fund durimit të Zogut dhe detyrimit të Tij për mbrojtjen vetëm të Matit të papushtuar e të pamposhtur, sidomos pas epopesë së lavdishme të grykave dhe “Shkallës së Dëshëve” me trupat serbe, në verën dhe vjeshtën e vitit 1915.

Me anë të sekretarit personal Sali Vuçiterna, Zogu lajmëroi kryekomandantin e trupave austriake, August Kral-in, se “Do të veprojmë në emër të Shqipërisë dhe do të shkojmë në Krujë, kryeqytetin e Arbërisë dhe Skënderbeut, prej nga ku do të thërras në një Kuvend përfaqësuesit e të gjitha krahinave shqiptare, për të formuar Asamblenë Kushtetuese që do të vendosë për fatin e Atdheut”.

Gazeta “Besa”, 2 tetor 1931.

Pas dy ditësh, në krye të 2 mijë burrave Zogu u nis për të marrë Krujën, por atje kishin hyrë trupat austriake, duke shfrytëzuar paralajmërimin e Tij.

I dëshpëruar, Zogu iu drejtua Tiranës, por edhe atje kishin hyrë austriakët. Atëherë, më 27 janar 1916, sulmoi Durrësin dhe e mori, duke e detyruar Esat Pashën të marrë arratinë. Në Durrës ngriti flamurin kuqezi të Skënderbeut, pasi shqeu flamurin me yll të zi e fushë të kuqe të Esat Pashës dhe ngriti pushtetin lokal.

Marshimi i forcave të Zogut vazhdoi drejt Kavajës, Peqinit, Elbasanit, Lushnjës, Fierit, Beratit e Skraparit. Populli kudo e priti si shpëtimtar.

“Në Durrës Zogu u lëshoi udhëzime të përpikta të gjitha nënprefekturave, që të formonin menjëherë organet e qeverisjes lokale. Ai e ristabilizoi qeverinë e Vidit me Aqif Pashë Biçakçiun si ministër të Brendshëm. Nga ana tjetër, Zogu riktheu në detyrë gjithë kabinetin qeverisës të Vidit. Ministrat e Vidit ishin larguar nga Durrësi për shkak të dhunës dhe terrorit, por nuk kishin dhënë dorëheqjen”.

K. Dako “Shënime”, faqe 64-66

Zogu ideoi Kuvendin Kombëtar të Elbasanit

I vendosur për të zbatuar vendimet e Kuvendit të Pavarësisë, Zogu ideoi zhvillimin e një Kuvendi Kombëtar në Elbasan, me synimin e zgjedhjes së një Asambleje Kombëtare, që do të merrte vendimet për krijimin e një qeverie dhe të një administrate vendore në të gjitha territoret e vendit. Ndërkohë, ushtria bullgare kish kaluar Manastirin dhe po afrohej drejt Shqipërisë së Mesme, kështu që Zogu mori masa për mbrojtjen e Elbasanit dhe të zonave që kish vënë nën administrim.

Pas krimeve të përbindshme të ushtrive greke e serbe, në kushtet kur Jugu i Shqipërisë ishte pushtuar nga grekët, Vlora nga italianët, Lindja e vendit nga bullgarët dhe Veriu nga austriakët, mbajtja e Kongresit të Elbasanit ishte vendimtare.

Më 18 shkurt 1916 Asambleja Kombëtare zgjodhi komisionin provizor me në krye Zogun, i cili vendosi thirrjen e Kuvendit Kombëtar. Më 3 mars, Zogu, me cilësinë e kryetarit të këtij komisioni, njoftoi hapjen e Kongresit Kombëtar të Shqiptarëve, që do të fillonte punimet më 18 mars 1916. Në Kongres do të merrnin pjesë përfaqësuesit e të gjitha trevave shqiptare, (edhe nga Kosova e Çamëria), si dhe përfaqësuesit e kolonive shqiptare në Bukuresht, Sofie, Zvicër e SHBA. Paskëtaj Zogu i shkroi një letër August Kral-it, në të cilën pasi e njoftonte për vendimet, i shprehte bindjen se Austro-Hungaria do ta mirëkuptonte këtë nisëm dhe i lutej me kortezi që ta ndihmonte për të “zgjeruar kufijtë e Shqipërisë sipas parimit të Kombësisë, pra që Kosova dhe Çamëria t’i bashkohen përsëri territoreve shqiptare”.

Suajër “Albania”, faqe 260-261.

Shqiptarët e mirëpritën ardhjen e ushtrive austriake dhe Zogu pranoi të bashkëpunonte me Austrinë, sepse besuan në deklaratën e Komandantit të Përgjithshëm të Fuqive Austriake, që shprehej: “se vinin si miq në Shqipërinë mike, për të përzënë që këtej ushtritë serbe”.

Por “miqtë” austriakë i kthyen Zogut një përgjigje të ashpër, ku theksonin se “... në territoret e Austro-Hungarisë, në kohë lufte, nuk lejoheshin organizimet e asambleve për qëllime politike dhe, për pasojë, Kongresi i Elbasanit do të konsiderohet i paligjshëm”.

Dhe për ta vënë Zogun para faktit të kryer, austriakët pushtuan Elbasanin, penguan hyrjen e delegatëve të njoftuar për Kuvend, (me pretekstin se në qytet kishte rënë kolera dhe se do të vendosej karantina), si dhe prishën të gjithë administratën vendore, nga e cila varej e gjithë administrata e zonave të çliruara.

Atëherë Zogu u bind se Austria ishte rrjeshtuar me pushtuesit e tjerë, kundër interesave të shqiptarëve. Ai refuzoi gradën dhe uniformën e kolonelit austriak, refuzoi veshjen e ushtrisë së Tij me uniformën me shiritin verdhë e zi, dhe e veshi ushtrinë me uniformën kombëtare.

Zogu, me Shqipërinë dhe kundër Austro-Hungarisë

Si hakmarrje për refuzimin për t’u takuar me delegacionin austriak të kryesuar nga Princi Vinshgrec, për “mosbindje ndaj autoritetit perandorak të ushtrisë austriake” dhe pas arrestimit të sekretarit personal Sali Vuçiterna, austriakët vranë 3 oficerë të Tij në Mat, ndërsa Zogun, në gjendje izolimi e shoqëruan drejt vendlindjes, pasi më parë ia kishin çarmatosur besnikët. “... Po për tre nga oficerët besnikë të Zogut, të cilët u pushkatuan nën pretekstin se gjoja po konspironin kundër Trupës Vepruese Ushtarake austriake, populli i Matit automatikisht dhe pa e zgatur më shumë, vuri në zbatim ligjin e talionit (hakmarrjes kokë për kokë), kundër oficerëve e ushtarakëve austriakë, duke vranë 4 oficerë dhe ushtarët e tyre...”.

(Terenc Toçi “Atdheu”, tetor 2000).

Atëherë austriakët e lutën Zogun që të shkonte në Shkodër për të biseduar me August Kral-in, çka Ai e pranoi për të mos i rrezikuar edhe më shumë matjanët, pas fillimit të ekspeditave ndëshkimore të ushtrisë austriake.

“Dueli ndërmjet përfaqësuesit dinak të imperializmit austro-hungarez dhe pinjollit të nacionalizmit shqiptar, ka qenë dramatik. I pari ishte struktur në formulën... e ‘bashkëpunimit të sinqertë’ - ndërsa Zogu e kundërshtonte vazhdimisht, duke i deklaruar se sinqeriteti dhe

shtypja nuk mund të bashkëjetonin, sepse pretendimi i Austrisë për t'i siguruar vetes të drejtën e administrimit të brendshëm të Shqipërisë, ishte i papajtueshëm me sovranitetin e një populli të pavarur, të cilin po e zhvishnin nga të drejtat e tij të ligjshme, si zot në vendin e vet.

'A mund t'ju duam me të vërtetë, nëse duhet t'ju shërbejmë, nëse na vihet në diskutim e drejta për të qenë zotër në shtëpinë tonë?!!

Ju keni ardhur këtu për të përzënë serbët dhe jo për të shtypur shqiptarët; ju jeni duke bërë një luftë, për të cilën ne nuk jemi fajtorë. Nëse sëbashku kemi interesa të ndërsjellta, për të luftuar serbët, koinçidencë kjo që është e dobishme edhe për ne, gjithsesi ne nuk mund të heqim dorë nga sovraniteti ynë tokësor. Duke i përzënë serbët nga Shqipëria, ju keni eliminuar një padrejtësi të madhe dhe do të bënit një punë të merituar duke ia kthyer vendit tonë të gjitha tokat ku flitet gjuha jonë; - por fatkeqësisht, në vend të kësaj vepre kalorsiake drejtësie, a mos po doni të zini vendin e armiqve tanë? Këtu nuk bëhet fjalë për tokat e tyre, po për tokën shqiptare!

(Terenc Toçi "Mbreti i Shqiptarëve", "Atdheu", po aty.)

Dy vitet e Zogut në Vjenë dhe kthimi në Shqipëri

Pas vdekjes së perandorit Franc Jozef, me rastin e kurorëzimit të Karlit I-rë, në përbërje të delegacionit shqiptar për ceremoninë e kurorëzimit, u ftua edhe Ahmet Zogu. Në Vjenë Zogu u prit me nderime të mëdha, ndonëse marrëdhëniet e Tij me austriakët ishin të përkeqësuar. Kur tentoi të kthehej në atdhe në përfundim të ceremonive, austriakët i bënë të ditur se nuk mund ta lejonin të largohej për arsye se prania e Tij "në Shqipëri pengonte veprimet ushtarake të Austro-Hungarisë".

"Protestat as që pinë ujë fare... Një mysafir i ardhur në Austri për t'i paraqitur Perandorit urime, po trajtohej si një rob lufte... Qeveria e Vjenës nguli këmbë në të vetën. Zogut iu desh t'i nënshtrohej realitetit dhe të priste me durim zhvillimin e ngjarjeve...".

Terenc Toçi "Atdheu".

Ju z.Myftaraj shkruani se "Ahmet Zogu qe një feudal osman i pashkolluar. Shtetari modern është një intelektual, një njeri i arsimuar..., e që më e pakta ka lexuar shumë. Ndryshe nuk mund të ketë kapacitetin e duhur për të ndërtuar një shtet modern. Shtetaria moderne është një disiplinë mjaft e komplikuar që kërkon njohuri historike, politike, juridike, të marrëdhënieve ndërkombëtare etj. Këto njohuri fitohen nga shkollimi dhe leximi".

Pikërisht këtë që pretendoni ju, bëri Ahmet Zogu në Vjenë.

Gjatë qëndrimit dyvjeçar, nëntor 1916-nëntor 1918, Zogu studioi shkencat ushtarake, politologji, histori, diplomaci, jurisprudencë dhe konstitucionalizëm. Tashmë Ai i zotëronte si armë perfekte të dy kulturat, atë orientale dhe atë perëndimore, të përvetësuar në dy metropolet e mëdha të dy perandorive të famshme.

"Jo më kot, duke vizituar Muzeumin Perandorak, Ai kërkoi dhe pá përkrenaren e Skënderbeut, madje dhe e vuri në kokë. E pastaj u orvat ta tundte edhe shpatën e tij të madhe! Në këtë, Ai sikur kërkonte një bekim dhe një frymëzim. Dhe ashtu, siç i kërkoi, iu dhanë që të dyja.

(T. Toçi, po aty)

Konica e krahasoi Zogun me Skënderbeun

Ju z.Myftaraj akuzoni se "Ahmet Zogu qe një feudal provincial osman..., që nuk nuk kishte erudicion. Dhuntitë e Ahmet Zogut qenë ato të feudalit oriental...".

I mrekulluar nga Ahmet Zogu, pas njohjes nga afër dhe pas meritave madhore që në vitet e para të angazhimit në politikë, Faik Konica shkroi: "Ahmet beu më duket i shënuar nga fati që të lozë rolin më të madh në histori të Shqipërisë. Nëqoftëse vete mbarë, fytyra e Zogut do të shtjerë në historinë tonë një hije më të madhe se hieja e Skënderbeut. Përkrahjet për këtë

vepër herkuliane janë të shumta. Pengimet janë edhe më të shumta se përkrahjet”. Faik Konica “Shqipëria si m’u duk” (Pjesa e Dytë, botuar në gazetën “Illyria”, në Nju Jork, 13-15 mars 1995).

Meritat e sipërthëna, kontributet madhore dhe vlerësimet e merituar, shpjegojnë arsyet e suksesit të bujshëm politik të Ahmet Zogut, që në rininë e hershme. Nuk ka e nuk mund të ketë të tjera. Megjithëse edhe këto ishin dhe janë mëse të mjaftueshme. Ndryshe nuk mund të ndodhte, qoftë edhe për shkak të determinizmit historik.

Edhe ju duhet ta pranoni këtë determinizëm të konkretizuar z.Myftaraj. Nëse nuk e pranoni, do të binit në pozitat e disa pseudoanalistëve dhe pseudostudiuësëve pa vepra, të cilët kur analizuan në një debat televiziv të paradokohshëm figurën e Zogut, e lidhën suksesin e Tij në mënyrë perfide me “çeta matjanësh”, që i përmendnin orë e çast, athua se po flisnin për Zani Çaushin dhe bandën e tij.

Pasues të armatosur kanë patur edhe të tjerë politikanë e atdhetarë asokohe, por askush nuk pati formatin e prijësit, mendjen e ndritur, largpamësinë e jashtëzakonshme, inteligjencën epërore, këmbënguljen, guximin e rrallë dhe intuitën politike si Ai – që u bë prijës i popullit të Tij.

Përfundimi i LPB dhe Shqipëria

Më 22 qershor 1919 u nënshkrua Traktati i Versajës midis Antantës dhe Gjermanisë, që sanksionoi disfatën e kësaj të fundit dhe Bllokut Qendror, ku bënte pjesë edhe Austro-Hungaria. Por ky traktat vendosi që ushtritë aleate të qëndronin në Shqipëri derisa fati i saj të caktohej nga Konferenca e Paqes, që do të mbahej në Paris. Që në fillim u pa qartë se kjo konferencë “paqeje” do të zbatonte Paktin e Fshehtë të Londrës për coptimin e trojeve shqiptare.

Në këto kushte, më 19 dhjetor, në Tiranë u mbajt një mbledhje me qëllimin e përgatitjes së një Kongresi Kombëtar Shqiptar. Në vijim të saj, më 25 dhjetor, në Durrës u mbajt një mbledhje tjetër, nga e cila doli Qeveria e Përkohshme e Durrësit, që si vendim të parë miratoi dhënien e Vlorës në favor të Italisë, ndërsa pjesën tjetër të vendit vendosi ta linte nën një protektorat ndërkombëtar.

Në kushtet e një rreziku të madh për vendin, aq më tepër që Qeveria e Durrësit dërgoi një delegacion në Paris për të bërë të ditura vendimet antishqiptare të saj, pas një qëndrimi të shkurtër në Itali, Zogu u kthye në Shqipëri, por jo duke u kthyer nga Serbia, sikundër shkruan z.Myftaraj, për çka ai nuk sjell kurrfarë dokumenti.

Zogu nuk kishte asnjë interes për të shkuar në Serbi pas kthimit nga Italia – përderisa kish vendosur të kundërshtonte hapur vendimet e Qeverisë së Durrësit.

Zogu e dinte mjaft mirë se vendimet e kësaj qeverie përbënin tradhti ndaj interesave kombëtare, aq më tepër që ishin marrë nga një qeveri që, gjoja, përfaqësonte interesat e shqiptarëve.

Zogu e dinte mirë se këto vendime i konvenonin Beogradit, sepse vinin në pikëpyetje dhe hidhnin poshtë, (bash në kryeqytetin e aleatëve të serbëve, në Paris), vendimet e Kongresit të Pavarësisë dhe ato të Konferencës së Ambasadorëve të 1913 për kufinj të Shtetit shqiptar. Zogu e dinte mirë se pranimi i vënies në diskutim të këtyre vendimeve, ishte një inkurajim i drejtpërdrejtë i planeve të Beogradit për coptimin e Shqipërisë. Ai ishte koshient për faktin se, çdo negociim me serbët do të shkatërronte të ardhmen e Tij politike, dhe do ta radhiste atë në bandën e tradhtarëve që ishin gati të shisnin edhe trojet e Shqipërisë, të mbetura nga coptimi i vitit 1913.

Raportet ndërkombëtare para, dhe pas Kongresit të Lushnjës

Më 12 tetor 1918, Turhan Pashë Përmeti dhe përkrahës të tij, me anë të një memorandumi

drejtuar Italisë, i njihnin asaj, “në emër të popullit shqiptar” të drejtën e një Protektorati ndaj Shqipërisë.

Më 29 korrik 1919, Italia dhe Greqia nëpërmjet traktatit Tittoni–Venizellos vendosën aneksimin në favor të Greqisë të Korçës dhe Gjirokastrës, ndërsa Italisë i njëjti e drejta e mandatit zotëruar të pjesës tjetër të Shqipërisë.

Në shtator 1919, Niti i propozoi Titonit që të binte dakord me Pashiqin për një ndarje të Shqipërisë së mbetur (pra pa Korçën dhe Gjirokastrën), midis Jugosllavisë dhe Italisë. Këtë plan kriminal në Janar 1920 e miratuan edhe Llojd Xhorxhi e Klemansoi, dhe më pas edhe Milerandi, që zëvendësoi këtë të fundit. Por të gjitha këto plane i hodhi në erë Presidenti amerikan Uillson.

Uodëll shkruan se “faktori kryesor që e shpëtoi Shqipërinë nga coptimi përfundimtar, ishte veprimi i vetë shqiptarëve në mbrojtje të vendit të tyre. Duke mos gjetur mbështetje tek paqebërësit e Parisit, udhëheqësit shqiptarë formuan një qeveri në Janar 1920 dhe u ngritën e dëbuan nga vendi të gjitha ushtritë e huaja”.

Në librin “Problemet e shqiptarëve gjatë Konferencës së Paqes 1919-1920”, 1978, faqe 480, Robert Lari Uodëll shkruan se “... Në optikën e Fuqive të Mëdha, një Shqipëri e pavarur do të ishte një qenie e padëshirueshme dhe se duhej të bëhej coptimi i saj midis Italisë, Jugosllavisë dhe Greqisë, duke ruajtur një pjesë të Shqipërisë së Mesme, me një pavarësi nominale, nën kujdesin e një Fuqie të Madhe”.

Konferenca e Paqes që i mbylli punimet më 10 prill 1920, përveç hartës politike të vitit 1913, i dha Italisë të drejtën për të mbajtur nën zotërim Vlorën dhe rrethinat e saj, dhe me një mandat special për zgjerimin e trevave nën sundimin italian, në rast të një coptimi të vendit midis shteteve fqinje.

Në qëndrimet e dyzuara të politikës dhe diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë, sipas Pastorelit, në faqen 407 të veprës “Shqipëria në politikën e jashtme italiane 1914-1920, diplomatët dhe shtetarët më të rëndësishëm italianë: Sonino, Xholiti, Sforca, San Xhuliano dhe Orlando, ishin për një Pavarësi të Shqipërisë, por gjithmonë nën ndikimin e fortë të Italisë, si urë e ekspansionit të saj në Ballkan, ndërsa Titoni, Niti dhe Shaloja kanë qenë për coptimin e saj. Në fillim të marsit 1920, një ndër udhëheqësit e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” ministri i Drejtësisë Hoxhë Kadriu, bëri të ditur se “Qeveria shqiptare është gati me hy në bisedime të mëqarta me qeverinë jugosllave në Beligrad ose në një vend tjetër, që do të shihet i përshtatshëm për t’i nxjerrë italianët jashtë Ballkanit, e sidomos jashtë Vlorës”.

Mbi bazën e këtyre interesave të ndërsjella u dërgua me një mision të fshehtë në Beograd deputeti Sejfi Vllamasit... Misioni i Vllamasit, në fakt dështoi...”.

(Paskal Milo “Shqipëria dhe Jugosllavia” 1918-1927, faqe 106-107)

Vijon

Polemikë me z.Kastriot Myftaraj rreth shkrimit “Zogistëve u hyn paniku nga zbulimi i të vërtetave(5)

1920, roli i Ahmet Zogut në Luftën e Koplikut

nga Astrit Kola

vijon nga numri i kaluar

Qeveria e Durrësit – qeveri e tradhtisë

Ju z.Myftaraj shkruani: “Sa për praktikat e dhunshme për arritjen e qëllimeve politike, njerëzit e Klikës dhe Partisë Popullore nuk filluan t’i përdorin në 1924, por që në 1919-1920, kur

përdorën atentatet politike për të rrëzuar Qeverinë e dalë nga Kongresi i Durrësit, që nuk qe më pak legjitim se Kongresi i Lushnjes...”.

Ju nuk sillni asnjë fakt për të vërtetuar “praktikat e dhunshme të Klikës dhe Partisë Popullore” gjatë viteve 1919-1920. Por nëse të tilla quani hedhjen poshtë të vendimeve të Qeverisë së Durrësit, ky është veprimi më atdhetar i Klikës, e cila abrogoi me përbuzje vendimet tradhtarë të Kongresit dhe Qeverisë së Durrësit, që, nën egjidhën e “Protektoratit ndërkombëtar”, pasi i falën Vlorën Italisë, flakën në hendek Aktin e Shenjtë të Shpalljes së Pavarësisë, të cilin Konferenca e Ambasadorëve, në mbledhjen e 20 Dhjetorit 1912, e konsakroi ndërkombëtarisht tek e shpalli Shqipërinë Shtet të Pavarur, Sovran dhe Neutral, nën sigurimin e përbashkët të Fuqive të Mëdha, dhe për çka autorizoi bash Komisionin e Kontrollit për administrimin e Shtetit Shqiptar...

Pikërisht këtu, pra tek Pavarësia dhe njohja e saj, z.Myftaraj, e kanë burimin dhe frymëzimin qëndrimet e prera të Zogut në Kongresin e Lushnjes, për hedhjen poshtë të vendimeve të Qeverisë tradhtarë të Durrësit!

Jo z.Myftaraj! Qëndrimet e Zogut në Lushnje dhe veprimet e tij kundër serbëve, italianëve dhe grekëve, gjatë periudhës së ushtrimit të postit të ministrit të Brendshëm, hedhin poshtë pohimin tuaj për “ligjshmërinë” e Kongresit dhe Qeverisë së Durrësit.

Kongresi i Durrësit nuk u zhvillua me delegatë nga të gjitha trojet shqiptare, dhe promovoi një qeveri të “Përkohshme”. Kjo qeveri proitaliane, u ndërtua si antipod i qeverisë proserbe të Selanikut me kryeministër Esat Pashë Toptanin, e cila mbështetej nga Serbia dhe Franca. Nacionalistët shqiptarë me në krye Zogun, me vendimet e Kongresit të Lushnjes dhe formimin e Qeverisë legjitime të dalë prej tij, neutralizuan dhe skartuan politikisht dy krijesat monstra proitaliane e proserbe të Durrësit dhe Selanikut, bashkë me planet e padronëve antishqiptarë që qëndronin pas tyre, që i frymëzonin e financonin.

Edhe më vonë, vendosmëria e Zogut për luftë pa kompromis, në postin e komandantit të operacioneve ushtarake antiserbe të Krahut Lindor në Veri të vendit, (krahas komandantit tjetër, Bajram Currit – komandant i Krahut Perëndimor) - hedh poshtë aluzionin tuaj për takim në Beograd dhe marrëveshje të Tij me serbët.

Po përse duhet të besojmë në shpikjen tuaj të marrëdhënieve të Zogut me serbët, apo sepse Zogu i vrau dhe i sakatoi serbët në të gjitha betejat!!!

Qeveria e Durrësit, si qeveri e tradhtisë, bashkë me delegacionin e tradhtarëve që dërgoi në Paris, (gjoja për të mbrojtur të drejtat e Shqipërisë), ushqueu me argumenta “diplomatikë” Serbinë dhe Francën për të mbajtur padrejhtësisht në Shqipëri trupat serbe, deri në coptimin e saj.

Lidhur me këtë situatë të turpshme që antishqiptarët franko-serbë, të ndihmuar edhe nga tradhtarët shqiptarë, krijuan në Lidhjen e Kombeve, Mit’hat Frashëri shkruan: “Spalajkoviç, delegat i Serbisë në Lidhjen e Kombeve, deklaroi më 26 shtator 1921..., ‘se ushtria serbe qëndron në Shqipëri sipas urdhërit të gjeneralit Franchet d’Espery, (francez), komandant i vjetër i ushtrisë Lindore (të Antantës – A.K.)’, dhe se ‘nuk do të lëvizë prej andej pa një urdhër tjetër!!!’”

“Delegati i Francës, senatori Reynald, nuk e ka denoncuar këtë deklaratë kaq të paturpshme...”.

Kongresi i Lushnjes shpëtoi Shqipërinë

Ju z.Myftaraj duhet ta dini se ishte pikërisht Zogu që, në bashkëpunim me atdhetarët me të cilët kish tentuar të realizonte Kongresin e Elbasanit, tashmë vendosi të bëjë një të tillë Kongres Kombëtar në Lushnje, për vazhdimin dhe konsakrimin e vendimeve shpëtimtare të Kongresit të Pavarësisë të 28 Nëntorit 1912.

Pasi lajmëroi patriotët shqiptarë dhe pasi vendosi që Kongresi i Lushnjes të bëhej me shpejtësi, brenda tre javësh, Zogu menjëherë shkoi në Mat, ku rrufeshëm organizoi forcat e

armatosura, me të cilat do të marshonte drejt Lushnjës dhe do të mbronte Kongresin. Tashmë për Zogun ishte e qartë se, pa një vendim dhe veprim politik të menjëhershëm, rrezikoheshin të coptoheshin edhe trojet e mbetura nga Konferenca e Londrës e vitit 1913. Që në fillim Zogu bëri të ditur se nuk do t'i njihte kurrfarë autoriteti Qeverisë së Përkohshme të Durrësit, e jo më të njihte vendimet e saj për t'i lënë Italisë Vlorën dhe për ta bërë Shqipërinë Protektorat Ndërkombëtar, në një kohë që LPB kishte mbaruar; grekët mbanin Korçën e Gjirokastrën, italianët Vlorën dhe ultësirën bregdetare, ndërsa serbët kishin pushtuar Veriun dhe synonin të merrnin Shkodrën.

Në këtë sipërmarrje madhore Zogu u mbështet tek anëtarët më nacionalistë të Krahu Kombëtar.

Sejfi Vllamasi është i pasaktë kur thotë se “Zogu qysh në 1917 ka qenë në bashkëpunim me organizatën ‘Krahu kombëtar’.”

(S.Vllamasi, f. 173.).

Sipas ambasadorit amerikan në Shqipëri, gjatë viteve 1930-1935, (cituar në librin “Mbreti Zog kallxon historinë”, botimi i parë i vitit 1993), Ahmet Zogu hyri në “Krahu Kombëtar” në fund të vitit 1921, pasi neutralizoi me kosto minimale kryengritjen e Mirditës, pak para se të shpërthente rebelimi i Dhjetorit. Pra, ju gaboni përsëri z.Myftaraj, kur shkruani se “Zogu hyri në politikën shqiptare si anëtar i Klikës, e cila që krijuar në vitin 1914 me synimin për të sunduar Shqipërinë”.

Në mesin e vitit 1920, karriera e Zogut kulmoi me arritjet e shkëlqyera në postin e ministrit të Brendshëm, ku u emërua për meritat e tij të mëparshme dhe si komandanti ushtarak që mbrojti Kongresin me matjanët e tij, dhe aspak për shkak të “aderimit të tij tek Krahu Kombëtar që në vitin 1917”. Kësisoj, nuk kemi arsye të besojmë pohimin tuaj se “kontaktin e Ahmet Zogut me Klikën e ka bërë Faik Konica në vitin 1917”, pasi ju nuk servirni ndonjë provë për këtë pohim.

Kontributet nacionaliste të “Klikës” në Kongresin e Lushnjës

Ju z.Myftaraj shkruani: “Historia se Ahmet Zogu, në moshën 24 vjeçare, në janar 1920, zbriti në Lushnjë për t'i hyrë sfidës së ndërtimit të shtetit modern shqiptar, është një mit historik, një përrallë e bukur...”.

Është e drejta juaj të mendoni kështu, ndonëse parashtrimi i mëposhtëm vërteton të kundërtën e konkluzionit tuaj!

Organizata “Krahu Kombëtar”, apo “Klika”, do të ishte faktori kryesor në organizimin dhe vendim-marrjen shpëtimtare të së Djathtës shqiptare në Kongresin famëmadh të Lushnjës. Qysh më 31 dhjetor 1919, në Lushnjë u mblodh një komision organizator i Kongresit, i cili, ditën e dytë të mbledhjes së tij, formuloi thirrjen dhe programin, që ua dërgoi të gjitha bashkive të vendit, duke shpallur si qëllim kryesor “Sigurimin e Bashkimit Kombëtar”. Në këtë mënyrë filloi edhe zgjedhja e delegatëve.

Qeveria e Durrësit u përpoq ta prishte këtë kongres, që kur mori vesh lajmin për zhvillimin e tij. Mirëpo, nga 13 anëtarët e saj, vetëm Fejzi Alizoti gjendej në Durrës, ndërsa Myfit Libohova, Petro Poga, Mustafa Kruja dhe Sami Vrioni, ndodheshin në krahinat e tyre. Pjesa tjetër ndodhej në Paris, në përbërje të delegacionit zyrtar pranë Konferencës së Paqes. Alizoti, me anë të një letre dërguar inspektorit të Përgjithshëm të Qeverisë së Durrësit në Lushnjë, zotit Avni Dabulla, më 6 janar 1920 e porosiste atë të merrte masat e duhura për pengimin dhe mosmbajtjen e Kongresit.

(“Dokumente e materiale historike...”, Tiranë 1959, dok. nr.11, faqe 12).

Suksesi i Qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, i siguroi një vazhdimësi politike Krahu Kombëtar. Organizata do të hynte fuqishëm në zgjedhjet e para në vend, duke fituar një shumicë deputetësh. Me fillimin e jetës parlamentare, më 24 prill 1921, brenda radhëve të

Këshillit Kombëtar, organizata formoi Partinë Popullore.

Parashtrimi i mësipërm dëshmon njëmend rolin vendimtar të “Krahu Kombëtar” në shpëtimin e fateve të vendit, dhe kjo është kryevepra e këtyre atdhetarëve të mëdhenj, që organizuan dhe realizuan me sukses Kongresin e Lushnjes dhe vendim-marrjen e jetësimin e saj në qeverisjen e mëvonshme. Dhe kjo kryevepër atdhetare kurrësi nuk është për t’u qortuar, (pra as nga z.Myftaraj). Ajo meriton nderim dhe brerore lavdie, krahas shpëtimtarëve të Atdheut.

E nëse kjo sipërmarrje madhore realizoi njëkohësisht edhe ambicjet për pushtet të këtyre protagonistëve mendjendritur, përfshirë edhe Zogun, kjo nuk përbën kurrfarë sakrilegji. Në politikë, dhe në çdo fushë të jetës shoqërore, është e natyrshme dhe e nënkuptuar ambicja për të bërë karrierë. Madje ajo është stimuli dhe mekanizmi më i përkryer, e askush nuk di të na thotë ndonjë tjetër mekanizëm më “human” apo më të “moderuar”. Ndërsa principet e pastra, (ose jo) dhe rrugët e mënyra e realizimit (të ndershme, ose jo), janë problem tjetër. Por në të gjitha rastet, “kuti matës” është efektiviteti dhe rendimenti i punës shoqërore, pra ndikimi për zhvillimin dhe prosperitetin e vendit, gjithmonë duke patur si pikë referimi dhe Yll Polar interesat e shoqërisë, Atdheut dhe Kombit. Politika, shoqëria dhe koha bëjnë bilancin e arritjeve apo dështimeve, e nëse ai rezulton tejet pozitiv, sikundër “bilanci” i kontributeve madhore të Ahmet Zogut, atëherë, lavdia dhe piedestalet janë të merituar.

Ja vendimet shpëtimtare të Kongresit të Lushnjes

1.Kongresi nxori jashtë ligjit Qeverinë tradhtarë të Durrësit dhe abrogoi të gjitha ligjet dhe vendimet e saj në dëm të interesave kombëtare.

2.Hodhi themelet kushtetuese të Shtetit të ri Shqiptar, të Pavarësisë dhe tërësisë së tij territoriale, ashtu sikundër u vendos në Kuvendin e Pavarësisë më 1912.

3.Statuti Themelor i Shtetit Shqiptar, i miratuar në këtë kongres, përcaktonte që Shqipëria të kishte si formë regjimi Monarkinë kushtetuese. Deri kur shqiptarët të zgjidhnin vetë Mbretin e tyre, të drejtat dhe atributet e tij do t’i ushtronte Këshilli i Lartë i Regjencës, i përbërë nga 4 regjentë, të zgjedhur nga Asambleja e Kongresit.

4.Kongresi miratoi 4 regjentët, që ishin Monsinjur Luigj Bumçi, Aqif Pashë Elbasani, Abdi bej Toptani dhe Dr. Mihal Turtulli.

5.Këshilli i Lartë i Regjencës emëroi Qeverinë e re me kryeministër Sulejman Delvinën, ministër të Jashtëm Mehmet Konicën dhe ministër të Brendshëm Ahmet Zogun.

6.Kongresi e shpalli Tiranën kryeqytet të Shqipërisë.

Një nga vendimet më të rëndësishme të këtij kongresi ishte ai i ndërmarrë në fushën e politikës së Jashtme, për dërgimin e një delegacioni në Konferencën e Paqes në Paris, për të mbrojtur me Ekskluzivitet të Drejtat Sovrane të Popullit shqiptar.

Teksti i protestës që delegacioni do të parashtronte në Konferencën e Paqes, u hartua nga Ahmet Zogu dhe ishte si më poshtë vijon: “Asambleja Kombëtare Shqiptare e mbledhur në Lushnje, proteston kundër vendimit, i cili dënon një shtet neutral si Shqipëria, një nga kombet më të vjetra të Europës, që të kënaqë orekset imperialiste të qeverive të vendeve fqinje. Kjo Asamble kërkon njohjen e një Pavarësie të plotë të Shqipërisë, me kufij etnikë e natyralë shqiptarë, të tillë që të riparojnë padrejtësitë që i janë bërë asaj nga Kongresi i Berlinit i vitit 1878 dhe Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1913. Asambleja Kombëtare ka vendosur të mos pranojë asnjë mandat ose protektorat të huaj në Shqipëri, dhe s’ka pretendim tjetër veçse atij që Shteti e Kombi Shqiptar të mbeten në vendin që u takon në gadishullin e Ballkanit, duke u dhënë fund, njëherë e mirë, mizorive të cilave u është ekspozuar nga jashtë, si dhe të jetojë në paqe e harmoni me fqinjët. Shqiptarët janë gati të bëjnë çdo sakrificë, bile të derdhin edhe pikën e fundit të gjakut kundër çdo vendimi që do të vinte në rrezik Pavarësinë dhe tërësinë e tyre kombëtare”.

Ku janë interesat serbe këtu z.Myftaraj!? Apo mos vallë Zogu mori në Serbi tezat për Shqipërinë etnike në kufinj të vitit 1978, për t’i inkorporuar në deklaratën dërguar

Konferencës së Paqes në emër të shtetit, popullit dhe Kombit shqiptar!!!

Para se Kongresi të mbyllte punimet, Këshilli i Lartë i Regjencës vendosi dhe urdhëroi që Ahmet Zogu të shkonte në Tiranë për të vendosur rendin dhe stabilizuar qeverinë e re. Kur qeveria kombëtare u vendos në Tiranë, kishte pushtet vetëm në territorin midis luginave të lumenjve Vjosë dhe Mat. Korça, Pogradeci dhe Shkodra ishin nën sundimin ushtarak francez. Viset e bregut të Drinit, gjenerali francez Fransua d'Esperi ua kish dorëzuar serbëve, pas largimit të ushtrisë së mundur austriake. Prefekturat e tjera ishin nën sundimin ushtarak të Italisë, përfshirë Vlorën. Një pjesë e Jugut të vendit ishte nën sundimin grek. Ushtria dhe xhandarmëria nuk ekzistonin dhe mungonin totalisht armët, municionet veshmbathjet, ushqimet dhe mjetet financiare për të organizuar Forcat e armatosura Kombëtare, që do të drejtoheshin nga Ahmet Zogu.

Gjatë 293 ditëve që Zogu mbajti postin e ministrit të Brendshëm, organizoi ushtrinë dhe xhandarmërinë, duke vendosur totalisht rendin dhe qetësinë. Më 20 shkurt 1920, Zogu mori në dorëzim arkivën e Qeverisë së Durrësit dhe në mars të atij viti prapësoi serbët dhe hyri në Shkodër, nga e cila po largoheshin trupat franceze të gjeneralit De Fortu. Krahinat e Korçës dhe Gjirokastrës ishin vendosur nën autoritetin e Qeverisë Kombëtare të Tiranës.

Në korrik të vitit 1920, i vendosur për të larguar me çdo kusht ushtritë e huaja nga Shqipëria, (konform vendimeve të Kongresit të Lushnjes), Zogu ideoi çlirimin e Vlorës nga ushtria italiane.

Pas ultimatumit të famshëm dhe refuzimit të Piacentinit, Vlora u muar me sulm të koordinuar të ushtrisë shqiptare dhe vullnetarëve popullorë më 22 korrik 1920. Paskëtaj, trupat italiane brenda 10 ditëve u larguan drejt Italisë, çka shënoi edhe largimin përfundimtar të ushtrive pushtuese nga territori administrativ shqiptar.

Më 2 gusht 1920, me një protokoll dypalësh u konsakrua njohja nga Italia e kufinjve shqiptarë të vitit 1913 dhe angazhimi italian për të përdorur të gjithë influencën në funksion të respektimit të Pavarësisë shtetërore të Shqipërisë.

“Hatëre s’kish në personin e tij (Zogut – A.K.)... Ai që punonte kundër Atdheut, për të ishte armik dhe dënohej pa mëshirë”.

(Gazeta “Dielli”, Korçë, 24 janar 1921, botuar nga Mihal Grameno.)

Viti 1920 sipas Bernshtajnit dhe Mit’hat Frashërit

Ju z.Myftaraj shkruani se “Klika i dha 24 vjeçarit Ahmed Zogu postin e ministrit të Brendshëm në qeverinë e krijuar në Lushnjë”.

Jo z.Myftaraj, ju gaboni kur aludoni se ishte Klika ajo që ia dha si dhuratë Zogut postin e ministrit të Brendshëm. Këtë post Atij ia dha nevoja politike për të stabilizuar shtetin e brishtë shqiptar. Tingëllon absurd aluzioni juaj për dhurime postesh nga ata që e shihnin mirë se cili ishte shpëtimtari i situatës, teksa garantoi me forcën e armëve zhvillimin normal të Kongresit të Lushnjes, ndërkohë që të tjerët kishin ardhur vetëm me duar në xhepa dhe dëshirën e zjarrit për të bërë Shqipërinë, çka nuk mjaftonte po të mos ishte Ai, të cilit i dhanë shumë më pak sesa meritonte, por gjithsesi i dhanë mbi supe shpresën e shqiptarëve, që vetëm shpatullat e Tij mund ta mbanin e ta jetësonin.

Në veprën “Mbreti Zog kallxon historinë e tij”, ish ambasadori amerikan Herman Bernshtajn, u kushton rëndësi të veçantë ngjarjeve të vitit 1920, ku spikat Kongresi i Lushnjes, kontributi i Zogut për organizimin, mbrojtjen dhe vendimet e tij shpëtimtare, si dhe roli i Tij personal në stabilitetin e rendit dhe regjimit të kufinjve shtetërorë konform vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve më 1913.

“Zogu me pasuesit e Tij u nis nga Mati për në Lushnjë, duke kaluar midis fuqive ushtarake italiane. Ai komandoi një fuqi prej 2500 vetësh nga Shqipëria e Mesme, dhe bashkë me fuqitë e tjera bëri rrethimin e qytetit.

Lushnja ishte kryeqendra e ushtrive italiane, dhe këto fuqi u përqëndruan mbi këtë qytet për të

ndalur mbledhjen e e kongresit atdhetar, por duke druajtur cilësitë luftarake të luftëtarëve matjanë, italianët vendosën se do të ishte punë më e urtë ta linin kongresin të mbaronte punët e tij qetësisht.

Të kënaqur që fuqitë e Zogut, që kishin zënë pozicione strategjike rreth Lushnjës, do të mjaftonin për t'i mbrojtur, delegatët filluan diskutimet për çka do të bënin më vonë. U formua këtu një qeveri provizore dhe Zogu u zgjodh me unanimitet ministër i Punëve të Brendshme, duke e autorizuar të kthehej në Tiranë për të marrë frenat e qeverisë në duart e Ti. Megjithë kundërshtimin Italian, Zogu u nis menjëherë drejt kryeqytetit të ri.

Zogu dhe fuqitë e Tij u ndeshën përballë me fuqitë italiane dhe armët e tyre. Oficeri që komandonte ushtrinë italiane, urdhëroi Zogun të ndalojë marshimin e Tij drejt Tiranës. Zogu e njoftoi oficerin se ai nuk mund të qëndronte dhe të ndalte marshimin e Tij, dhe i tha se, po qe se ka urdhër, le të shtjerë kundër tyre. Oficeri u përgjigj se urdhërat e tij janë që të qëllojë me plumb këdo që do të shikojë se po shkon në Tiranë!

Zogu e këshilloi oficerin italian të çojë në vend urdhërat e marra. Por ai nuk qëlloi kundër fuqive të Zogut dhe ato marshuan drejt Tiranës, ku arritën më 11 shkurt 1920.

Zogu tashmë e ndjente më tepër përgjegjësinë mbi shpatullat e Tij, sepse shqiptarët i mbanin tek Ai të gjitha shpresat për lirinë e tyre.

Duke parë dhe kuptuar mirë rrezikun e madh në të cilin gjendej vendi, Zogu lëshoi një komunikatë për popullin, ku thuhej: “Armiku nuk do të lëvizë më nëpër vendin tonë si nëpër shtëpinë që nuk ka zot; trupat tona do jenë mburoja dhe kështjella që do të përballojë pushkët dhe topat e armiqve”.

Në mars 1920, Ahmet Zogu vendosi të marrë Shkodrën e okupuar nga ushtria franceze, për t'ia bashkëngjitur territoreve të administruara nga qeveria dhe shteti i ri shqiptar. Dhe para se francezët t'ua dorëzonin Shkodrën aleatëve historikë, serbëve, Zogu në krye të trupave hyri natën në Shkodër dhe e vuri qytetin plotësisht nën kontroll. Populli e priti me gëzim e hare, sepse e kish shumë frikë pushtuesin serb.

Tashti që viset e Veriut ishin pa të huaj, u bë e mundur të hapej i pari parlament shqiptar më 27 mars 1920.

Këshilli Kombëtar, që përfaqësonte vullnetin e popullit shqiptar, e aprovoi qeverinë e Tiranës dhe tregoi besimin e tij duke deklaruar: “Qeveria e zgjedhur nga vullneti i popullit, me punën e saj energjike dhe patriotike e ka bërë Shqipërinë të lirë, independente dhe integrisht si tokë”.

Qeveria kish parim të mos i njohë Italisë asnjë autoritet mbi Shqipërinë, ndaj e tërë administrata u muar përsipër nga Qeveria e Tiranës, e cila emëroi autoritetet civile në vend.

Në prill 1920 Gjirokastra, e cila ndodhej nën administrim italo-shqiptar, sipas një marrëveshjeje të fshehtë të bërë në Romë - u muar me forcë nga trupat e Zogut, dhe ushtria italiane, e trembur, ia mbathi drejt Vlorës, qyteti i fundit nën pushtimin e saj.

Duke qenë se delegatët në Kongresin e Lushnjës deklaruan se Shqipëria do të çlirohet nga fuqitë e huaja, Zogu mendoi se ishte koha që të mbushej ky premtim. Ai e dinte se diplomacia s'kishte ç'të bënte në këtë rast, dhe i vetmi mjet ishte fuqia e armatosur dhe lufta. Kësisoj, kur kërkesa për boshatisjen e Vlorës u injorua nga italianët, luftëtarët shqiptarë u lëshuan me fuqitë e tyre kundër qytetit të fortifikuar të Vlorës.

Herman Bernshtain (Ambasador i SHBA në Shqipëri 1930-1935) “Mbreti Zog kallxon historinë e tij”, faqe 16-21, Tiranë, botim i vitit 1993.

Ndërsa Mit'hat Frashëri, në veprën (“Fati i Shqipërisë”, faqe 164), shkruan: “Të alarmuar, patriotët shqiptarë mbajtën një Mbledhje të gjerë Kombëtare në Lushnje (20 Janar 1920) dhe, megjithë kundërshtimin e italianëve, formuan një qeveri prej 6 ministrash dhe zgjodhën një Këshill të Lartë (Regjenca - shën i A.K.) prej 4 anëtarësh, të cilët duhet të kryenin bashkërisht funksionin e kreut të shtetit; njëkohësisht, 37 delegatë krijuan parlamentin e parë.

Kongresi i Lushnjës është pikënisja e rilindjes së Shqipërisë.

Pika e parë e programit përmbante Integritetin absolut dhe Sovranitetin e Shqipërisë, pa asnjë

lëshim nga kufijtë e vitit 1913. Por problemi ishte që ky program të realizohej. Shkodra vazhdonte të ishte nën një administratë franko-shqiptare, ndërsa italianët e ndjenin veten si në shtëpinë e tyre në Jug. Por në unitetin e territorit të Shqipërisë kishte një mangësi, e shkaktuar nga prania e serbëve në rajonet e Lindjes dhe Veriut...

Serbët kishin deklaruar në Konferencën e Paqes (8 dhe 20 janar 1920), se ishin për një Shqipëri të pavarur, brenda kufijve të vitit 1913. Gjithashtu ata nuk kishin pranuar coptimin e Shqipërisë në shkëmbim të Rijekës (Marrëveshja Llojd Xhorxh-Klemanso-Niti – janar 1920). Por ndërkaq ata nuk pranonin të lironin tokat shqiptare dhe qeveria e Tiranës më kot përpiquej të bindte Beogradin që të tregojë i arsyeshëm. Përkundrazi, serbët e shumëfishuan dhunën ndaj banorëve të zonave të pushtuara; nga shtatori në tetor iu vu flaka 40 fshatrave të Malësisë së Dibrës dhe Lumës, dhe 24 fshatrave të tjerë në Veri të Shqipërisë; 738 njerëz, gra dhe fëmijë, u therën ose u dogjën të gjallë...

Kjo provë e rëndë pati si lehtësim të vetëm pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve më 17 Dhjetor 1920...

Ka dy vjet që Shqipëria është bërë faktor paqeje dhe stabiliteti në Ballkan... (La Paix par le Droit – 17 tetor 1921)

Anëtarët nacionalistë të “Krahu Kombëtar”

Vllamasi shkruan: “Partia Popullore ka qenë grupi parlamentar i Krahut Kombëtar”. (S.Vllamasi: f. 337.)

Anëtarë civilë të Krahut Kombëtar kanë qenë: Eshref Frashëri, Sotir Peci, Aqif Pasha (Biçakçiu), Hoxha Kadri, Ahmet Zogu, Sejfi Vllamasi, Rexhep Mitrovica, Sali Nivica, Qazim Kokoshi, Osman Myderrizi, Ali Begaj, Maz’har Këlliçi, Bajram Fevziu, Sheh Ibrahim Karbunara, Faslli Frashëri, Kolë Tromara, Riza Dani, Maliq Bushati, Xhemal Naipi, Kostaq Kotta, Llano Borshi, Neki Starova, Neki Ruli, Syrja Pojani, Skënder Pojani, Xhevat Korça, Halim Gostivari, Leonidha Frashëri, Bedri Pejani, Salih Vuçiterni, Qemal Mullai, Qamil Bala, Salih Butka, Hasan Qinami, etj.

Nga këta elementë nacionalistë, sipas Vllamasit, nga “Krahu Kombëtar” u larguan Aqif Pasha, Hoxha Kadri, Kostaq Kotta, Riza Dani e Xhevat Korça.

Ndërsa anëtarë ushtarakë të organizatës “Krahu Kombëtar”, etiketuar ndryshe “Klika”, kanë qenë: Ismail Haki Tatzati, Meleq Frashëri, Preng Jaku, Kamber Sejдини, Ali Shefqeti (Shkupi), Xhavit Leskoviku, Shefqet Korça, Osman Tetova, Ahmet Lepenica, Dhimitër Bala, Koço Muka, Hysni Lepenica, Idriz Dizdari, Ferit Frashëri, Tosun Selenica, Hysen Nikolica, Qani Starja, Ahmet Kajca e Xhemal Malindi (S. Vllamasi, “Ballafaqime...”, faqe 340).

Sipas z.Kastriot Dervishi, një dëshmitar tjetër i kohës, Mustafa Kruja, shkruan se “... Krahun Kombëtar e patën formuar disa intelektualë të dalë nga shkolla politike e turqve të rinj (pra shkollë me pikëpamje nacionaliste, gjithmonë nëse z.Myftaraj, apo të tjerë, nuk i konsiderojnë xhonturqit si antinacionalistë apo komunistë). Ata ishin oficerë dhe civilë, të cilët zhvilluan një propagandë intensive kundër qeverisë së Durrësit, duke e quajtur si ‘vegël pasive të imperializmës italiane’.”

Për Mustafa Krujen, “njerëzit e Krahut Kombëtar ishin ata që u bënë themeluesit e Partisë Popullore, thujse të gjithë nga Jugu, të paraqitur si ‘patriotë e të kulturuar’ dhe, nga ana tjetër, ‘me ambicje të pafre për pushtet’”. (Mustafa Kruja “Antologji historike”, Elbasan 2001, faqe 294–295).

Kryetari i organizatës në këtë kohë, ishte Eshref Frashëri.

Nga të gjithë këta elementë, (me ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimet e mëvonshme shqiptare), shumica dërrmuese e mbylli jetën me kontribute të mëdha atdhetare, dhe pavarësisht bindjeve dhe lëkundjeve politike, pothuajse të gjithë luftuan deri në fund për Kauzën e Shqipërisë Etnike.

Duke i analizuar gjërat kështu, bie poshtë çdo etiketim i tyre si “prokomunistë”; “bolshevikë”;

“marksistë” apo “komunistë”, sepse, që të gjitha këto ideologji simotra, e përjashtonin kategorikisht nacionalizmin dhe Kauzën e Shqipërisë Etnike, gjithmonë në interes dhe në emër të “Revolucionit proletar” dhe “Komunizmit internacionalist (pra pa atdhe – A. K.)”. Nëse z.Myftaraj mendon ndryshe, le të na e thotë, me argumenta, dhe është e drejta e tij e pamohueshme të na e thotë, gjithmonë në emër të polemikës që u shërben të gjithëve.

Zogu dhe heroika e “riatdhesimit” të Shkodrës

Në fund të dhjetorit të vitit 1918, ministri i Jashtëm i Italisë, Sonino, i kërkoi Parisit që të ndikonte mbi Beogradin që të tërhiqte trupat serbe nga Peshkopia Hasi dhe Luma, por ministri i Jashtëm i Francës, Pishon, iu përgjigj se “Dispozitat e Traktatit të Londrës nuk ia hiqnin të drejtën serbëve që të pushtonin Shqipërinë e Veriut”. Pikërisht këtu e ka zanafillën edhe plani serb për aneksimin e Shkodrës, sidomos pas aneksimit të Rijekës (Fiumes) prej Italisë. Pra Franca inkurajoi haptas Serbinë, që të shpejtonte për të kompensuar territorin e humbur dalmat me Shkodrën shqiptare - kryeqendrën metropolitane të qytetërimit ballkanik, e cila i siguronte Mbretërisë SKS edhe daljen në Adriatik.

Më datë 11 mars 1920, qeveria shqiptare e dalë nga Kongresi i Lushnjës, autorizoi Zogun që të merrte në dorëzim administrimin e qytetit të Shkodrës dhe rrethinave të tij.

Qeveria-Delvina nuk emëroi ndonjë prefekt për Shkodrën. Funkcionin dhe zyrën e prefektit në Shkodër e mori ministri i Brendshëm Ahmet Zogu, i cili njëkohësisht u emërua “Guvernator” i Shkodrës.

Zogu emëroi dy zëvendës-prefektë për të kryer detyrën e Prefektit, me kompetenca të plota, e që ishin atdhetarët e njohur Sulço Beg Bushati dhe Shuk Serreqi, ndërsa Bajram Fevziu u caktua këshilltar i Prefekturës së Shkodrës.

Gjatë gushtit të vitit 1920, pas nënshkrimit të Protokollit italo-shqiptar për lëshimin e Vlorës në duart e Qeverisë dhe Shtetit shqiptar, Shkodra mbeti kryeobjekti i Qeverisë Delvina. Për këtë qëllim, në Shkodër u shpërngul pjesa më e madhe e kabinetit të kryeministrit Delvina, në formën e një ekipi special qeveritar, të drejtuar nga Ahmet Zogu, e në të cilin bënin pjesë Hoxha Kadriu, Sotir Peci, Ndoc Çoba dhe Bajram Curri (asokohe ministër pa portofol).

Me porosinë dhe nën drejtimin e Ahmet Zogut, më 1 gusht, pranë Bashkisë së Shkodrës u krijua Komisioni Përkujdestar i Ushtrive Vullnetare, i cili përbëhej prej 7 vetësh: Musa Juka – kryetar i Bashkisë, Ndrejë Vogli – nënkryetar i Bashkisë, Elez Sokoli, Kolë Çoba, Jonuz Repishti, Lec Boriçi dhe Loro Pistulli. Ky komision, më pas, u zgjerua dhe u shndërrua në një intendencë të rregullt për rekrutimin e luftëtarëve vullnetarë dhe furnizimin e frontit të luftës, qëllim për të cilin edhe u shtua me Pjetër Kokën, Patuk Saraçin, Het Gjyrezin, Zenel Mandiqin, Kolë Gjinajn dhe Halit Rrojin.

Më 12 shkurt 1920, reparte të ushtrisë jugosllave pushtuan Malin e Taraboshit. Duke zotëruar lartësinë e tij pranë qytetit të Shkodrës, serbët siguronin kushte të favorshme për ta sulmuar qytetin. Ndërkaq, në Shkodër ndodhej komanda e forcave aleate, me në krye gjeneralin francez Bardi de Fortu.

Për qeverinë shqiptare të dalë nga Kongresi i Lushnjës, ishin plotësisht të qarta lidhjet e Parisit me Beogradin, në dëm të sovranitetit të Shqipërisë.

Ministri i Brendshëm Ahmet Zogu, pas bisedimeve me gjeneralin francez, në telegramin e datës 26 shkurt 1920 i kërkoi xhandarmërisë së Shkodrës të ndihmojë popullin për t’u organizuar ushtarakisht dhe për t’u përgatitur për një luftë të ashpër. Me këtë rast, “më 1 mars 1920 Zogu urdhëroi vendosjen në vijën e kufirit të 150 xhandarëve shqiptarë, gati për luftë”. (A.Q.SH Tiranë. Fondi Ministria e Punëve të Brendshme, dosja 115, dokumenti nr. 457).

Me urdhër të Zogut, dy kompani të xhandarmërisë u vendosën në fshatin Kastrat, në veri të qytetit të Shkodrës. Njëherazi me vendosjen e këtyre dy kompanive, Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare” i krijuar enkas në Shkodër, organizoi dhe nisi për në Kastrat rreth 200 vullnetarë nga malësitë, të armatosur nga shteti. Në drejtim të Shkodrës u nisën edhe disa dhjetëra

vullnetarë matjanë, pasues besnikë të Zogut.

Lufta e Koplikut e vitit 1920 dhe roli i Ahmet Zogut

Ju z.Myftaraj shkruani se “Luftën e Koplikut të korrikut 1920, kundër serbëve, për të cilën mburren zogistët, në fakt e kanë komanduar dy burra trima shkodranë, kapiten Taip Shkodra dhe kapiten Hamit Gjylbegu. Zogu erdhi nga Tirana me shumë zhurmë dhe u vendos në selinë e prefekturës në Shkodër, prej ku “drejtonte” operacionin. Ai nuk shkoi në fushëbetejë”. E vërteta e bazuar në dokumenta arkivore, flet krejt ndryshe z.Myftaraj. Ja çfarë thonë arkivat: Në korrik 1920, Beogradi dhe Cetina thurën planin për pushtimin e Shkodrës, që tanimë ishte zbrazur nga ushtritë franceze.

Më 26 korrik malazezët sulmuan në Hot e Grudë, duke vrarë brenda pak minutash 80 burra, duke djegur shtëpitë dhe grabitur bagëtitë”.

(Gjon Zeka “Nëpër luftëra, në liri”. Tiranë 1932, faqe 19).

Shqiptarët u vërsulën kundër hordhive serbo-malazeze duke i ndjekur ato deri në Tuz.

Në mbështetje të kufitarëve u rrjeshtuan edhe dy kompanitë e xhandarmërisë shqiptare dhe në luftime u vranë dhjetëra ushtarë jugosllavë. Ndërkaq, Zogu organizoi mbrojtjen e Shkodrës me forcat e xhandarmërisë dhe me vullnetarët matjanë.

“Më 27 korrik, tre batalione jugosllave iu drejtuan Kastratit, të cilin e pushtuan pas luftimesh të ashpra. Menjëherë, qindra vullnetarë u armatosën për t’u nisur drejt frontit”.

(A.Q.SH Tiranë. Fondi “Komiteti i Kosovës”, dosja 14, dokumeni 707).

Zogu e mori situatën në dorë dhe organizoi sëbashku me atdhetarët shkodranë Komitetin “Mbrojtja Kombëtare” dhe më 1 gusht ministri i Brendshëm drejtoi marshimin kundër armikut në tri drejtime, me oficerët Has Ferri, Taip Shkodra, Bajram Hyseni, Zeqir Beqja, Preng Dashi etj..

“Pas disa luftimesh në Vrrakë, ata iu drejtuan Koplikut ku, deri më 5 gusht, u zhvilluan luftime të ashpra.

Me qindra vullnetarë të Shqipërisë së Mesme iu drejtuan Shkodrës. Vetëm në javën e parë të muajit gusht, arritën në breg të Bunës “mbi 300 vullnetarë nga Kruja, Ishmi dhe Shijaku...”. (AQSH Tiranë. Fondi i Min. P. Br., dosja 115, fleta 93, datë 7 gusht 1920).

Më 21 gusht 1920, forcat jugosllave nisën sulmet dhe brenda disa orësh kaluan Qafën e Podgoricës dhe brinjat e Malit të Veçeçikut për të dalë në malësitë e Shkrelit. Zogu dërgoi në Shkrel një prej oficerëve më trima, Rexhep Shalën, në krye të 300 vullnetarëve të Shkodrës.

Më 22 dhe 23 gusht, forcat jugosllave zunë vijën: Kastrat-Shkrel-Koplik-Kelmend.

Ndërkohë, qeveria shqiptare vazhdonte traktativat me kancelaritë evropiane, për t’i shpërngulur forcat jugosllave përtej kufirit të vitit 1913, por Beogradi kishte vendosur ta merrte Shkodrën me çdo kusht.

Krerët e Shkodrës, Malësisë së Madhe, e deri ata të viseve përtej kufijve politikë, iniciuan në Postribë një kuvend bese për luftë kundër armikut, duke e shtyrë gjakmarrjen deri në shporrjen përfundimtare të tij nga kufijtë e Shqipërisë. “Në luftime u rrjeshtuan edhe 200 luftëtarë të Gjakovës e Prizrenit, ndërkohë që 260 vullnetarë të tjerë kosovarë qëndronin në gatishmëri në Shkodër dhe prisnin urdhër për t’u nisur drejt frontit”.

(A.Q.SH Tiranë. Fondi “Lufta e Koplikut” dosja “Përpyekjet me ushtrinë serbe”, faqe 57).

Edhe banorët e malësive të Hotit, Grudës dhe Postribës dhanë një kontribut të çmuar në luftën e Koplikut. Mbi 40 vullnetarë shqiptarë ranë dëshmorë në fushën e betejës dhe gati dhjetë luftëtarë të tjerë, nga radhët e xhandarmërisë dhe njësisë kufitare shqiptare.

Ministri i Brendshëm Zogu, jo vetëm në ato ditë, por edhe më pas, në vitet e Monarkisë u përkujdes personalisht për familjet e ushtarakëve të rënë në Koplik.

Ndërkaq, në ditët e para të shtatorit 1920, Zogu urdhëroi dhe komandoi në Koplik goditjen përfundimtare kundër forcave serbo-malazeze.

Të dërrmuar ushtarakisht, më 20 shtator, në qytetin e Shkodrës serbo-malazezët nënshkruan

një marrëveshje me qeverinë shqiptare, sipas së cilës trupat jugosllave do të tërhiqeshin menjëherë nga kufijtë politikë shqiptarë.

Në krye të delegacionit serb ishte Neshiqi, ndërsa pala shqiptare përfaqësohej nga Dr. Turtulli dhe Nuri Vila.

Oficerët e ushtrisë shqiptare që luftuan heroikisht në luftën për Shkodër-locen janë: Rexhep Shala, Taip Shkodra, Hamid Gjylbegu (dha dorëheqjen në gusht 1920), Sulejman Fehmiu, Zef Serreqi, Prenk Tushaj, Qamil Kadri (Boksi), Hasan Bushati, Sandër Toska, Padër Cirili (Cani), Abaz Kupi, Ndok Gjeloshi, Sokol Qerimi, Halit Sulejmani, Shaban Bejlegu, Dom Loro Caka, Ndrekë Pepa, Hasan Xherahi dhe Man Hoti, Has Ferri, Bajram Hyseni, Zeqir Beqja, Preng Dashi. Nga këta vetëm disa kanë qenë oficerë të karrierës, të tjerët ishin prijës popullorë, deri edhe klerikë, që u graduan në betejat heroike.
Vijon numrin e ardhshëm

Polemikë me z.Kastriot Myftaraj rreth shkrimit “Zogistëve u hyn paniku nga zbulimi i të vërtetave”(6)

1920: Zogu përballë politikës së rebelimeve

Zogu ideoi dhe inicioi besëlidhjen e malësorëve

Më 6 mars 1920, bazuar në përvojën e suksesshme personale në besëlidhjet e malësive të Matit, Dibrës e Lurës, dhe në aftësinë për të depërtuar në shpirtin e malësorëve lridashës, Zogu inicioi një Asamble të Përgjithshme me bajraktarët dhe kryetarët e malësive të Prefekturës së Shkodrës, në të cilën u aprovuan këto vendime:

“1.U aprovue me unanimitet veprimi i delegatve të Shkodrës dhe i rrethet, që një vendimet e Asamblesë Kombëtare të Lushnjes dhe Qeverin’ e re të Shqipnisë, n’urdhnat e të cilëve lypset me u shtruem.

2.U pëlqye forcimi i “Besës” si mbas këtyne kushteve: Cilido, që nga data e soçme, qoftë Shkodran o Malsor, bahet vegël e të huejit, ose shkakton ndo një akt, i cili asht kundra interesave të vendit dhe në dobi t’anmiqvet të Shqipnisë, ka për t’u dënue nga Komisioni Shkodran i formuem bashkë me krenët e malsivet e të qarkut me këto dënime: Nxjerrja e tij jasht tokës shqiptare bashkë me familjen, tue iu sekuestrue veç kësaj dhe gjith pasuniya e tundshme dhe patunshme. Po një dënim i tillë ka për t’u zbatue edhe për gjithë ata qi i bajnë strehë këtyneve.

Nji i tillë vendim ka me dalë nga Komisioni i Shkodrës, i për bamë nga nji përfaqshues për çdo malsi, dhe n’eksekutimin e tij ka me u përdorun Kanuni i Malevet.

3.U lith “Besa” për mprojtjen e Atdheut kundra anmikut në konformitet me vendimin e marrun n’Asamblen Kombtare të Lushnjes, ku sa herë qi mund të sulmohet toka shqiptare, të gjithë do t’i dalin zot me armë në dorë, si mbas besës së dhanun.

Nji vendim i tillë i marrun me unanimitet, ka me i u bamun i dijtun popullit ndër kisha e xhamija të qytetit dhe të katundevet, si edhe ndër male e rrethe të Shkodrës.

Akti u firmue prej 72 krenvet të Shkodrës e të rrethit, nga të cilët janë për t’u përmendun emnat e Bajraktarvet dhe të Vojvodavet të posht-shënuem:

Uk Turku – Vojvoda i Këlmendit; Vatë Marashi – Bajraktar i Shkrelit; Selman Lami – Bajraktar i Reçit; Shaban Istrefi – Bajraktar i Koplikut; Islam Tahiri – Bajraktar i Buzë-ujt; Dud Selmani – Bajraktar i Grizhës; Abdullah Mehmeti – Bajraktar i Rjollit; Zejnel Alija – Bajraktar i Baksit; Cok Zeneli – Bajraktar i Sumas; Adem Tafa – Bajraktar i Drishtit; Lush Prela – Bajraktar i Shalës; Lulash Gjeloshi – Bajraktar i Shoshit; Avni Kola – Bajraktar i Gimajt; Mirash Ndou – Vovoda i Kirit; Hil Ndou – Bajraktar i Toplanas; Zef Pali – Bajraktar

i Shllakut; Marash Peci – Bajraktar i Temalit; Geg Geika – Vojvoda i Shllakut.
Si përfaqësues të qytetit, të Malsivët e të rrethit të Shkodrës, në Asamblyen Kombëtare u zgjodhën: Xhemal Efendi, Kadiu i Shkodrës, Xhemal Beu, Pater Vinçenc Prendushi dhe Hil Mosi
(Përkthyer nga A. Giannini “Op. Cit.”, faqe 37)

Konsolidimi i shtetit shqiptar gjatë vitit 1920

Më 13-14 dhjetor 1920, Llojd Xhorxhi, Klemansoi dhe Niti, arritën një marrëveshje për coptimin e Shqipërisë midis tre vendeve fqinje; Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, dhe kjo u quajt “kompromisi anglo-franko Italian”.

(Dokumente të Politikës së Jashtme britanike, 1919-1939, Londër, 1962, volume IV, dok. 18).

Më 6 mars 1920, SHBA-të u dërguan Fuqive të Mëdha të Europës një letër të presidentit amerikan, në të cilën tekstualisht shkruhej: “Presidenti i SHBA-ve ripohon se nuk pranon asnjë plan që i jep Jugosllavisë shpërblime tokësore nga krahinat e Shqipërisë së Veriut, për të kompensuar trojet që ajo ka humbur gjatë...” (nënkuptohet kalimi i Fiumes, pra Rijekës, nga Mbretëria SKS nën administrimin e Italisë).

(S. N. Stavrinos “The Balkans”, faqe 361).

Më 13 gusht 1920, dibranët, të ndihmuar edhe nga vullnetarët matjanë të rekrutuar nga Zogu, i sulmuan serbët dhe i detyruan të tërhiqen përtej kufijve shtetërorë të vitit 1913. Por Qeveria jugosllave dërgoi përforcime ushtarake, duke refuzuar të njihte kufijtë e përcaktuar nga Fuqitë e Mëdha në Londër. Serbët, të ndarë në tre kolona, u drejtuan nga bregdeti dhe pushtuan Lezhën. Më pas ata iu afruan Tiranës. Pas hartimit të një proteste dërguar Fuqive të Mëdha, Zogu organizoi ushtrinë kombëtare dhe xhandarmërinë, duke thirrur njëkohësisht në ndihmë edhe vullnetarët nga radhët e popullit dhe, pasi i shkatërroi armiqtë, i detyroi të tërhiqen përtej kufijve.

Me rastin e këtyre ngjarjeve, Qeveria italiane, konform Protokollit dypalësh të 2 gushtit 1920, shprehu qëndrimin e saj në mbrojtje të Sovranitetit të Shtetit Shqiptar, me anë të një note proteste më datë 16 shtator 1920, drejtuar Lidhjes së Kombeve, ku përcaktonte se “... nuk mund të toleronte kurrfarë cënimi të tërësisë territoriale të shtetit shqiptar...”.

Një notë të tillë proteste bëri edhe qeveria britanike.

Ndërkaq, siç rezulton nga aktet e Lidhjes së Kombeve, serbët në territorin shqiptar kishin shkatërruar 6603 shtëpi, mbi 100 dyqane, dhe kishin vrarë mbi 2000 persona, ndërmjet të cilëve rreth 300 ishin djegur të gjallë.

Më 20 nëntor 1920, Zogu shpërndau qarkoren nr.8592, të shkruar e redaktuar personalisht, në të cilën theksonte: “Qeveria e ndërtuar në bazë vendimeve të Kongresit të Lushnjës, ka filluar punën e saj në një zonë që përfshihet ndërmjet Vjosës dhe brigjeve të Matit. Gjatë qeverisjes së saj ajo pati fatin që të realizonte idealin kombëtar e ta çonte kufirin shtetëror në linjat e vitit 1913”.

(Terenc Toçi, gazeta “Atdheu”, po aty).

Më 17 dhjetor 1920, Lidhja e Kombeve vendosi ta njohë Shqipërinë si shtet Sovran dhe ta pranojë atë me të drejta të plota si anëtare e saj, megjithë kundërshtimet e Francës që mbronte tezën serbe, sipas së cilës “Shqipëria s’ish një entitet politik i përcaktuar mirë”.

Kjo fitore e madhe në aspektin ndërkombëtar e gjeti vendin në mungesë stabiliteti politik, për shkak se, më 14 dhjetor 1920, kryeministri Sulejman Delvina dhe kabineti i tij dhanë dorëheqjen, kështuqë edhe Ahmet Zogu, në momentin më delikat të problemeve të brendshme, u detyrua të japë dorëheqjen duke deklaruar: “Sot, duke konsideruar se i shërbejmë atdheut, japim dorëheqjen dhe ia kalojmë pushtetin qeverisë së re. Jemi krenarë për patriotizmin e nëpunësve dhe i falenderojmë me gjithë zemër. Detyra e të gjithë patriotëve është t’i shërbejnë gjithmonë me besnikëri Qeverisë së re, për të mirën e popullit”.

“Mbas rreth 10 muajsh të një aktiviteti të pandërprerë e të palodhur, mbasi ia kishte ofruar

100 herë jetën Atdheut në këtë periudhë kaq të shkurtër, Zogu la qeverinë me një disiplinë prej një ushtari të mirë..., pa keqardhje, e pa asnjë dëshirë tjetër përveçse të mund të vazhdonte të punonte në ndonjë mënyrë tjetër për të mirën e atdheut. Lëshoi pushtetin me një gjest historik e fisnik: "Bindem!"

(Terenc Toçi, po aty).

Dhe si për t'i vënë vulën meritave të Zogut dhe ndjenjës së Tij të detyrës ndaj Atdheut, vjen vlerësimi i Konicës: "Për një burrë shpirtmadh si Ahmet Zogu, përpara çdo gjëje tjetër qëndron me letra të zjarrta fjala Detyrë..."

[Faik Konica 'Shqipëria si mu duk' (Pjesa e Dytë), botuar në gazetën 'Illyria' në Nju Jork, 13-15 mars 1935].

Klika nuk e përdori por e vlerësoi Zogun

Ju z.Myftaraj përdorni si instrument të analizës fantazinë kur, duke e interpretuar gabimisht Vllamasin, shkruani se "Klika (ajo përbëhej kryesisht nga jugorë) kishte shënuar katër persona mes krerëve nga viset sipër Lumit Shkumbin..."

Eshtë e vërtetë që Klika përbëhej kryesisht nga elementë jugorë, por ata ishin nacionalistë dhe për ta nuk kishte kuptim koncepti i përkatësisë krahinore në përzgjedhjen e burrave që do të qeverisnin vendin. Ky koncept mund të ketë ekzistuar në kokën e Vllamasit, por në veprën e tij ai nuk na bën të dyshojmë se kishte të tilla paragjykime krahinore.

Koncepti për përkatësitë që çojnë në dasi krahinore është juaji, dhe këtë koncept e keni shfaqur vazhdimisht në shkrimet tuaja.

Klika preferoi Abdi bej Toptanin, Bajram bej Currin, Aqif Pashë Biçakçiun dhe Ahmet bej Zogun, jo "... si njerëzit midis të cilëve duhet të zgjidhte...", por si njerëzit të cilët i përzgjedhi qëllimisht, pa rezerva e paragjykime, duke u dhënë besim e poste të merituar, për arsye të ndikimit të tyre madh në popull dhe aftësive të spikatura që ata posedonin.

Klika nuk lançoi fuqishëm kurrfarë "karriere politike" të Ahmet Zogut, sikundër pohoni ju z.Myftaraj - përveçse i njohu Atij meritat atdhetare dhe ia shfrytëzoi aftësitë sipas konceptit të saj nacionalist, në kohët më të vështira për vendin.

Vllamasi ka të drejtë kur pohon se "... në Shqipërinë e nën Shkumbinit fuqia personale nuk loste një rol me rëndësi...". Dhe kjo sepse, nën Shkumbin, askush nuk kish fuqi personale, pra ushtarake, për të bërë fatet e Shqipërisë, që asokohe bëheshin me forcën e armëve.

Jugu i vendit prej kohësh i kishte ndjerë mungesat e krismave të pushkëve të 3 çetave me nga 12 vetë, sikundër ishin ato të Çerçiz e Bajo Topullit dhe Mihal Gramenos, apo Sali Vranishtit e Sali Butkës.

Në kushtet kur shteti shqiptar kishte financa të pakta për të organizuar forcat e armatosura, mijëra pasuesit e Zogut dhe Currit ishin një thesar i vërtetë për të realizuar aksionet ushtarake të domosdoshme për largimin e ushtrive të huaja nga toka shqiptare. Pikërisht për këtë arsye u përzgjedh Zogu në postin e ministrit të Brendshëm, e më vonë, në fund të nëntorit 1921, në postin e komandantit ushtarak të operacioneve në Veri të vendit bashkë me Bajram Currin. Vllamasi ka shumë të drejtë kur pohon se "Zogu ka qenë i krijuar për atë situatë...", pra për situatë lufte. Dhe kjo për shkak të mbështetjes popullore, aftësive të rralla organizative, luftarake dhe trimërisë së pashoqe, çka përcaktoi edhe suksesin e operacioneve ushtarake të drejtuara e udhëhequra personalisht prej Tij kundër serbëve, italianëve e grekëve në të gjithë territorin e vendit.

Nëse Zogu pranoi të "përdorej", Ai e dinte mirë destinin e tij Hyjnor si Shpëtimtar i Atdheut. Zogu e dinte mirë se detyra e luftëtarit atdhetar ishte lufta, drejt së cilës ai shkante si ushtar i bindur, gjë që u shndërrua më vonë në një investim madhor politik, mbi të cilin kulmoi më pas edhe karriera e Tij politike prej shtetari që Atdheun e bëri me pushkë dhe mendje të ndritur.

Ai i justifikoi plotësisht besimin e popullit dhe atdhetarëve shqiptarë, duke përgatitur

gradualisht pistat e triumfit të ardhshëm politik.

Por ju përsëri gaboheni z.Myftaraj, kur shkruani se "...kriteri i Klikës që aftësia për intriga të paskrupullta dhe krime politike".

Ju tashmë duhet të jeni bindur se, ishte pikërisht Klika ajo që kontribuoi dhe vendosi për fatet e vendit, sidomos në Kongresin shpëtimtar të Lushnjës. Nëse këtë kryevepër atdhetare (pra Kongresin e Lushnjës), ju e barazoni me "intriga të paskrupullta dhe krime politike", atëherë ne duhet të besojmë se veprat madhore politike e kombëtare qënkan intriga dhe krime politike, apo produkt i tyre!!!

Nëse në politikë intrigat janë të natyrshme, çka nuk ka përse të mos kenë ekzistuar edhe në kohën që po analizojmë, këto nuk janë gjë tjetër përveçse një nga vektorët më të parëndësishëm të komponentes politike që, në rastin e Klikës në vitin 1920, ishte kryevepra atdhetare e Kongresit që shpëtoi Shqipërinë. Vetëm ju z.Myftaraj merrni guximin të pohoni se shpëtimi i Atdheut konsiderohet krim politik dhe produkt intrigash!!! Ju shkruani se "zogistët nuk kanë pse krenohen që për këtë rol u zgjodh Zogu"!!!.

Zogistët kanë të drejtë të krenohen që, për të bërë rolin e Shpëtimtarit të Atdheut, u përzgjedh njëzëri Zogu, i cili këtë detyrë e kreu me nder. Dhe kjo do të thotë se ata kanë të drejtë të krenohen për kontributet madhore kombëtare të Tij, që sot janë shndërruar në kartë të fuqishme morale për ithtarët e Zogizmit - për të marrë sërish në dorë fatet e vendit.

Tashmë zogistët kanë në duar një thesar që quhet "trashëgimia etatiste" e Atij që i mori dhe i mbrojti pushtetet për të bërë Shqipërinë dhe jo për ta lënë vendin në dorë të antishqiptarizmit që bëri rebelimet gjakatare deri në fund të shekullit të kaluar, e që sot bën zullume mbi pushtete kriminale e të kriminalizuara.

Ju shkruani se "Zogu..., i duhej Klikës", e cila mendonte ta përdorte si "hanxhar" për të "nënshtruar Shqipërinë, dhe pastaj ta flakte tutje".

Vendosja e rendit, autoritetit të shtetit dhe tërësisë territoriale të përcaktuara si objektiva politike në Kongresin e Lushnjës, nuk ishin përdorim "hanxharësh" dhe "kasapësh" për të nënshtruar Shqipërinë!!!

Ky është pohim absurd dhe vetpranim nga ju i koncepteve të gabuara për rolin dhe misionin e shtetit.

Zogun nuk e flaku askush pas kryerjes së detyrës së ministrit të Brendshëm, përkundrazi, Atij iu besua një detyrë tjetër tejet e rëndësishme, ajo e komandantit të operacioneve në Veri të vendit, kundër serbëve, si edhe Bajram Currit.

Zogu nuk ishte "kasapi" i Klikës por shpëtimtari i Atdheut

Ju z.Myftaraj gaboni kur i atribuoni Zogut epitelin "kasap" për t'i dhënë atij ngjyrat e një gjakatari. Zogu i emëruar nga Kongresi i Lushnjës, pra qoftë edhe nga Klika, nuk bëri tjetër veçse luftoi me okupatorët e huaj dhe, nëse i ka vrarë ata, nuk mund të etiketohet "kasap", sepse atëherë nuk e di sesi do t'ua vini ju emrin atyre që derdhin gjakun e tyre e të okupatorëve për hir të çlirimit të Atdheut!!!

Në dhjetor 1920, disa javë pas krijimit të kabinetit të Iljaz Vrionit, në të cilin Zogu mbajti sërish postin e ministrit të Brendshëm (kabinet i krijuar më 16 nëntor 1920, pas dorëheqjes, më 15 nëntor, të qeverisë së kryesuar nga Sulejman Delvina), Zogu i paraqiti dorëheqjen kryeministrit Vrioni, sepse nuk ishte në një mendje me disa politika të kësaj qeverie.

Pra askush nuk e "flaku" Zogun, por Ai dha dorëheqjen z.Myftaraj - aq më tepër që nuk kishte ndonjë detyrim konkret, pasi në këtë kohë Ai nuk ishte anëtarësuar në organizatën Krahu Kombëtar!

Diplomacia dhe kufijtë e rrezikuar të shtetit shqiptar

Meqenëse zgjidhja përfundimtare e problemit të kufinjve shtetërorë po vonohej nga Fuqitë e

Mëdha, në shtator 1920, qeveria e Sulejman Delvinës hodhi një hap inteligjent dhe të domosdoshëm, tek kërkoi anëtarësimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve.

Më 12 tetor, në cilësinë e kryetarit të delegacionit shqiptar pranë Konferencës së Paqes, Pandeli Evangjeli e përsëriti kërkesën për anëtarësimin e Shqipërisë.

Në përgjigjen e datës 20 tetor, Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes i kërkoi Evangjelit paraqitjen e dokumentave të nevojshëm rreth Statutit të Kongresit të Lushnjës, që e përcaktonte Shqipërinë si një shtet Sovran. Në notën e saj të 8 nëntorit, qeveria shqiptare përgjigjej se “Pavarësia e konsakruar në Lushnje bazohej në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913 dhe dokumentat e Pavarësisë, ishin të njëjta me ato të konfirmuara nga ky vendim dhe aktet përkatëse të njohjes së Sovranitetit të shtetit shqiptar, si dhe në ato të Protokollit të Firences së vitit 1914, të nënshkruara dhe të publikura nga 6 Fuqitë e Mëdha”. Njëkohësisht në notë argumentohej se nuk bëhej fjalë për një shtet të porsaformuar, por për një shtet që kishte ekzistuar që para LPB, dhe që gjatë konfliktit mbarëbotëror kishte qëndruar neutral, ndonëse kish vuajtur pasojat e tmerrshme të përplasjes së blloqeve ndërluftuese.

Ja si u pranua Shqipëria në Lidhjen e Kombeve

Në mbledhjen e 11 dhjetorit të Lidhjes së Kombeve, delegati francez, Viviani, kërkoi shtyrjen e shqyrtimit të kërkesës së Shqipërisë, me pretekstin e shfuqizimit të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve dhe të Protokollit të Firences (!!!), për t’i dhënë kështu mundësi Jugosllavisë e Grerqisë që ta coptonin Shqipërinë dhe për ta vënë Lidhjen para faktit të kryer, duke nulifikuar kështu kërkesën e Shqipërisë për anëtarësim, sepse nëse shteti shqiptar do të copëtohej e gllabërohej, Lidhja nuk do të kish çfarë të pranonte në gjirin e saj. Propozimi i Vivianit u pranua pas votimit që rezultoi 13 : 8.

Por përfaqësuesi i Afrikës Jugut, Lordi Sesil, dashamirës i shqiptarëve, propozoi dhe insistoi që kërkesa e Shqipërisë të shqyrtohej dhe votohej në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, pasi në votimin e parë kishin marrë pjesë vetëm 21 vende.

Në mbledhjen e Asamblesë ndodhi mrekullia: Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve, pasi fitoi 35 vota pro përkundrejt 7 abstenimeve, ndonëse de jure njohja u shty deri në afatin e përcaktimit përfundimtar të kufinjve, pas shqyrtimit të pretendimeve të fqinjëve.

Por menjëherë pas pranimit, Shqipëria kërkoi njohjen formale të kufinjve shtetërorë dhe rregullimin e njëkohshëm të mosmarrëveshjeve me Jugosllavinë dhe Greqinë për çeshtjet kufitare të mbetura pezull, deri në ratifikimin përfundimtar të kufinjve shtetërorë konform vendimeve të Fuqive të Mëdha në vitet 1913 dhe 1914, kërkesë që u përsërit nga kryeministri Vrioni edhe në maj të vitit 1921.

Këshilli i Lidhjes e vuri kërkesën shqiptare në rendin e ditës së punimeve më 25 qershor, duke ftuar edhe përfaqësuesit jugosllav e grek për të paraqitur pretendimet. Në këtë seancë, përfaqësuesi shqiptar kërkoi emërimin e një komisioni nga Lidhja, për studimin në vend të kufinjve, për respektimin e vendimeve që i përcaktonin ato.

Përfaqësuesit jugosllav dhe grek, në sintoni kërkuan hedhjen poshtë të kërkesës shqiptare, me pretekstin se Konferenca e Ambasadorëve, ose Këshilli Suprem i Lidhjes, kishin kompetencë për caktimin përfundimtar të kufinjve ndërshtetërorë me Shqipërinë.

Por ndërkohë kish shpërthyer kryengritja e Mirditës, e cila ishte organizuar enkas për të krijuar pretekstin e ndërhyrjes jugosllave për pushtimin e trojeve shqiptare.

Miratimi i Komisionit Ndërkombëtar për “Mirditën”

Më 16 gusht 1921, delegati shqiptar në Lidhjen e Kombeve, Fan Noli, i kërkoi Lidhjes të ndërhynte për rivendosjen e paqes midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë.

Më 2 shtator 1921, Noli dhe delegati jugosllav Jovanoviç, dolën para Këshillit të Lidhjes. Noli dëshmoi me prova kërcënimin e paqes midis dy vendeve, për shkak të intervencionit të

bandave jugosllave brenda territorit shqiptar, për të ndihmuar në krjimin e Republikës Separatiste të Mirditës dhe kërkoi largimin e trupave jugosllave nga territori ynë, por Jovanoviç lexoi shkresat drejtuar qeverisë jugosllave nga Presidenti i “Republikës së Mirditës”, ku pretendohet se qeveria e Tiranës nuk njihej si përfaqësuese e popullit dhe nuk kishte autorizim apo mandat për ta përfaqësuar atë, dhe se si përfaqësuese legjitime e shqiptarëve duhej të njihej “Qeveria e Mirditës” në egzil, në Jugosllavi, ndaj dhe për këtë arsye delegati jugosllav kërkoi dërgimin në vend për verifikim të një komisioni të Lidhjes. Në replikën e tij Noli iu përgjigj Jovanoviçit se “qeveria e Mirditës e kishte selinë në Prizren, pra në një territor që ndodhej brenda kufinjve administrativë të Mbretërisë SKS dhe, si e tillë, ishte një qeveri e krijuar nga serbët, dhe duke qenë larg shqiptarëve të krahinave që pretendonte se qeveriste, kjo qeveri natyrshëm që nuk mund të përfaqësojë asgjë”. Por Jovanoviç, i vënë me shpatulla pas murit, kaloi në sulme brutale tek e akuzoi Shqipërisë si një “shtet inekzistent, në fazë embrionale dhe anarki të plotë” dhe se për këtë arsye, “meqenëse ndodhej pa kufinj të përcaktuar, shteti shqiptar nuk kish territore të përkufizuara dhe nuk mund të pretendonte për cënim kufinjsh dhe territoresh, sepse nuk mund të kish dhunim të kufinjve që nuk ekzistonin”.

Kjo marrëzi e detyroi Këshillin që t’i tërhiqte vëmendjen Jovanoviçit, që të mos i ngrinte më problemet e mosekzistencës së kufinjve të një shteti Sovran dhe anëtari të Lidhjes.

Më 15 shtator, Lordi Sesil i kërkoi Këshillit kalimin për shqyrtim dhe votim të vendimit në Konferencën e Ambasadorëve.

Pas një seance ku Noli shkëlqeu me polemika të mprehta dhe argumenta të shkëlqyera, më 2 tetor Konferenca e Ambasadorëve vendosi që të dërgojë në Shqipëri një komision kontrolli për verifikimin e problemit në vend.

Më 6 tetor, Konferenca përzgjedhi Komisionin me përbërje prej tre anëtarësh: me në krye finlandezin Thefleff, kolonelin Schaeffer nga Luksemburgu dhe majorin norvegjez Meinich. Konferenca i kërkoi Komisionit që të shkonte në Shqipëri brenda datës 1 nëntor, çka u realizua me sukses, duke shënuar arritjen më të madhe diplomatike për shtetin e ri shqiptar. Delegati britanik Fisher, në mbledhjen e posaçme të Këshillit të Lidhjes së Kombeve, që u mbajt në Paris më 16 nëntor 1921, e akuzoi Jugosllavinë se “kishte nxitur dhe ndihmuar kryengritjen e Mirditës”.

Zogu sërish ushtar i Atdheut në vitin 1921

Më 17 shtator 1921, me urdhër të Pashiqit trupat serbe pushtuan “Vijën e Demarkacionit”, sikundër quhej vija ushtarake Lurë-Muhur-Arras-Sinë-Katër Grykët.

Në këtë kohë Ahmet Zogu ishte deputet i thjeshtë, por qeveria, duke e ditur se vetëm Ahmet Zogu mund të rivendoste gjendjen dhe të largonte serbët, e ngarkoi Zogun në detyrën e Komandantit të Përgjithshëm të Krahut Lindor.

Të tmerruar nga ky emërim, serbët i përforcuan trupat e tyre me Regjimentin 21 të Këmbëorisë së Shkupit dhe Regjimentin e Këmbëorisë të dislokuar në Vranjë, ndërsa gjatë muajit nëntor i përforcuan edhe me 6 regjimente te tjera të Këmbëorisë. Por megjithatë, Zogu i përzuri trupat serbe dhe arriti të neutralizojë njëkohësisht edhe rebelimin e Mirditës.

Por pikërisht në këto momente dramatike për shtetin shqiptar, Hasan Prishtina dhe përkrahësit e tij rrëzuan qeverinë e Pandeli Evangjelit, me kobure në kokën e kryeministrit.

Difuzioni dhe shkartisja e klasës politike

Megjithë suksesin politik që u kurorëzua me rrëzimin e qeverisë së Iljaz Vrionit, “Bashkimi i Shenjtë” nuk arriti t’i kënaqë ambicjet për poste ministrore të pjesëmarrësve të tij, ndaj dhe fundi i vitit 1921, qoftë edhe për shkak të ngjarjeve tragjike, shënoi shumë shpejt edhe fillimin e krizës së këtij grupimi amorf karrieristësh.

Deputetët e Korçës u shkëputën nga ky formacion politik dhe iu bashkuan grupit të ri të formuar nga Iljaz Vrioni, (të cilin më parë këta arrivistë e “flijuan” me një interpelancë absurde tek e akuzuan për përvetësim të kompetencave të vartësve), që tashmë filloi të quhej grupi “Indipendent”. Por edhe ikanakët nga Partia Popullore, formuan një parti të re të quajtur “Partia Kushtetuese”, me deputetë të Elbasanit, Beratit, Tiranës e disa të tjerë.

Më 2 dhjetor 1922, pasi u bë sërish ministër i Brendshëm, Zogu e mori nën kontroll Krahun Kombëtar (Klikën) dhe gjithë Partinë Popullore, Këshilli Kombëtar i së cilës përbëhej nga 20 përkrahës të Shefqet Vërlacit, nga 18 përkrahës të Ahmet Zogut si dhe 3 të tjerë të grupit Independent të Iljaz Vrionit, që përkrahnin Ahmet Zogun. Partia Popullore përfaqësonte si mendimin konservator, ashtu edhe atë liberal. Fraksionet e saj qëndronin pezull mbi aleanca të brishta, thuajse formale, por që gjithsesi formonin një grupim që i dominonte rivalët politikë. Në shtator 1923, me largimin e mjaft figurave, dikur kryesore, Partia Popullore kaloi tërësisht nën drejtimin e hekurit të Ahmet Zogut, dhe për shkak të prirjeve të theksuara reformatore në qeverisjen e vendit, ajo krijoi lidhje të fuqishme dhe raporte të drejtpërdrejta me popullin, duke e justifikuar plotësisht emrin e saj.

Pas largimit nga Partia Popullore, shumë nga kundërshtarët e Zogut aderuan në Partinë Përparimtare, që u krijua në shtator 1923. Kjo parti e re përfshinte në gjirin e saj latifondistë të mëdhenj dhe atdhetarë të shquar si Shefqet bej Vërlaci, Iliaz bej Vrioni, Mehdi bej Frashëri, etj., si dhe elementët antizogistë që vinin nga Komiteti “Mbrotjtja e Kosovës”, si Hoxha Kadriu (që ishte edhe kryetar i partisë), Hasan Prishtina, Bajram Curri, etj.

Partia Përparimtare ishte forca që u shpërbë shumë shpejt, për shkak të kontradiktave që ekzistonin midis drejtuesve të saj, arrivistë të tërbuar. Iljaz Vrioni, pas krijimit të grupit Independent, flirtoi haptas me Partinë Popullore të drejtuar nga Ahmet Zogu, ndërsa Shefqet Vërlaci e pasoi duke kapërcyer “gardhin” dhe duke u bërë ndër figurat më kryesore të Partisë Popullore.

Terenc Toçi e përshkruan mjaft mirë shkartinjen e klasës politike në këtë segment kohor, tek shkruan: “... U krijuan grupe politike në një vend, ku populli në maxhorancë dërrmuese nuk ishte pjesëtar i ndonjë partie.

... u krijua edhe njëfarë unioni, i mbiquajtur “Bashkimi i Shenjtë”, që synonte të pajtonte partitë me një..., ndarje ‘racionale’ të karrigeve ministrore.

Nuk mohoj se të gjithë, ose pothuaj të gjithë, kishin ide patriotike, por në masë dërrmuese atyre u mungonte vizioni i saktë për problemet jetësore që duhej të përballonin, si dhe aftësia për të kuptuar kapacitetin e vet politik dhe administrative”.

Klika dhe kryengritja separatiste e Mirditës

Ju z.Myftaraj shkruani: “Sa për praktikat e dhunshme për arritjen e qëllimeve politike, njerëzit e Klikës dhe Partisë Popullore nuk filluan t’i përdorin në vitin 1924, por..., për të vazhduar me... shtypjen e dhunshme të Mirditës në vitet 1920-1921, që i detyroi krerët e Mirditës të pranojnë ndihmën serbe për të shpëtuar nga dhuna e Klikës në pushtet...”.

Ju gaboni qëllimisht z.Myftaraj, sepse kur shpërtheu rebelimi i Mirditës, nuk ka patur kurrfarë represioni në këtë krahinë. Dhe kjo sepse qeveria nuk kishte mundësi të bënte represion, ngaqë ishte angazhuar totalisht, qoftë ushtarakisht, qoftë diplomatikisht, në zgjidhjen e krizës së rrezikshme të kufinjve veriorë me Jugosllavinë.

Së dyti, edhe po ta kishte këtë pikësynim, qeveria nuk ishte në gjendje të luftonte në dy fronte, aq më tepër që, për shkak të pozicionit gjeografik të Mirditës, do t’i duhej të angazhonte trupat e saj midis dy zjarresh, në hapësira tejet të ngushta, çka do të ishte vetvrasje dhe asgjësim i sigurtë i tyre dhe njëkohësisht motivim i planeve politike e diplomatike dhe i gjithë aksionit anti-shqiptar, ndërkombëtar të Beogradit e Cetinës, pikërisht në kohën kur Pashqi kishte dislokuar afro 50 mijë trupa të armatosur gjer në dhëmbë, gjatë gjithë kufirit ndërshtetëror, në Lindje dhe Veri.

Pikërisht në fund të qershorit 1921, tamam në kohën që Qeveria shqiptare ishte përkushtuar totalisht për të zgjidhur krizën e kufinjve, Pashiqi frymëzoi dhe stimuloi shpërthimin e rebelimit të separatistëve të Mirditës.

Më 17 korrik, nga Prizreni, Kapidani i Mirditës Gjon Marka Gjoni, shpalli krijimin e Republikës Separatiste të Mirditës dhe u kërkoi fqinjëve e Fuqive të Mëdha njohjen e saj. Por Fuqitë e Mëdha e kuptuan lojën e Beogradit dhe reaguan ndaj lojës trashanike të marrjes nën shtetuj të një krijese katolike nga shteti më ortodoks i Ballkanit, shtetarët e të cilit, që në kohën e Stefan Dushanit, janë shuguruar e mbajtur në pushtet nga Kisha Ortodokse Serbe.

Zogu dhe rebelimi i Mirditës

Në kohën kur shpërtheu kryengritja e Mirditës, Zogu ishte thjesht deputet, ngaqë kish dhënë dorëheqjen si ministër i Brendshëm më 14 nëntor 1920, kur ra kabineti i Sulejman Delvinës. Qeveria e Iljaz bej Vrionit, e trembur nga rebelimi, dërgoi menjëherë forca ushtarake, nën komandën e Ali Riza Kosovës, për ta marrë nën kontroll situatën në Mirditë, por trupat qeveritare ranë nën zjarrin e rebelëve të gënjyer e të armatosur më së miri, me ndihmën e serbëve. Ali Rizai u përgjigj flakë për flakë dhe në luftime pati të vlarë nga të dy krahët. Por operacionet qeveritare dështuan dhe flaka e rebelimit kërcënonte të përhapej.

Dhe si gjithmonë u shenjua sërish Ai, i vetmi që mund të rivendoste rendin dhe të paqëronte situatën, Ahmet Zogu, i cili, këtë herë, mori si krah të djathtë në drejtimin e operacionit ushtarakun Hysni Dema.

Zogu e pranoi detyrën si ushtar i bindur dhe e paqësoi Mirditën pa gjak, vetëm e vetëm me ndërhyrjen miqësore të bajraktarit të Oroshit, atdhetarit të shquar Prengë Marka Prenga.

Në këmbim të besës së mirditorëve Zogu premtoi faljen e kryengritësve të armatosur dhe heqjen e taksave e xhelepeve për Mirditën, premtim të cilin e mbajti gjatë gjithë kohës që qëndroi në pushtet, pra deri më 7 Prill 1939.

Jo vetëm kaq, por pas paqëtimit të Mirditës, djemtë e armatosur mirditorë, e që të mashtruar kishin luftuar kundër ushtrisë qeveritare, me urdhër të bajraktarit të Oroshit Prengë Marka Prenga, iu atashuan trupave të Zogut dhe, vullnetarisht, e mbështetën atë në rivendosjen e rendit pas Grushtit të Shtetit të Dhjetorit 1921, si dhe për shtypjen e rebelimit të të njejtëve autorë, në Mars të vitit 1922.

Mit'hat Frashëri, në në veprën ("Fati i Shqipërisë", faqe 179), shkruan: "Në këtë kohë, një kryengritje shpërtheu në Mirditë... Fuqitë e qeverisë dërguar kundër rebelëve, qenë të paafta ta shtypnin rebelimin..., dhe rendin e qetësinë nuk mundën t'i vendosnin. Më së fundi, qeveria iu drejtua Zogut që të merrte përsipër komandën e Fuqive ushtarake për të shtypur rebelimin dhe vendosur rendin. Brenda një kohe të shkurtër, Zogu mundi ta paqësojë vendin dhe rendi mbretëroi sërish në krahinën e Mirditës".

Vijon në numrin e ardhshëm

Polemikë me Kastriot Myftarajn (7)

1921, rezistenca e Zogut përballë grushtit të shtetit

Për fatin e tyre të keq dhe të shqiptarëve, (sepse Grushti i Shtetit la pasoja të rënda dhe krijoi precedentin e paligjshmërisë, që inkurajoi rebelimin pas tre muajsh dhe "revolucionin" pas 18 muajsh) - puçistët që ju mbrojnë z.Myftaraj - duke sulmuar Zogun - kishin vendosur të merrnin me çdo kusht dhe çdo çmim pushtetin, teksa përfituan nga mungesa e Tij në Tiranë.

Nga Astrit Kola

Vijon numri i kaluar

Zogu dhe grushti i Shtetit i Dhjetorit 1921

Ju z.Myftaraj shkruani: “Dhe kështu e përdori “Klika” Ahmet Zogun (pra si kasap dhe hanxhar – shën. i A.K), duke filluar që në rastin e rrëzimit të qeverisë së Hasan Prishtinës, në dhjetor 1921”.

Por e vërteta qëndron ndryshe z.Myftaraj. Nuk ishte Zogu rrëzuesi i Hasan Prishtinës, por deputetët, që në këtë rast dëshmuar një lartësi politike të admirueshme. Ja si qëndron e vërteta për ngjarjet në fjalë:

Ndërkohë që Zogu ndodhej në krye të operacioneve ushtarake në Veri të vendit, kabineti Vrioni dha dorëheqjen më 16 tetor 1921, për t’ia lënë vendin kabinetit të kryesuar nga Pandeli Evangjeli, i cili dha dorëheqjen më datë 6 dhjetor 1921, nën presionin e Hasan Prishtinës, pra pas 50 ditësh qeverisjeje formale. Në planin ndërkombëtar, Qeveria-Evangjeli kishte arritur një sukses të jashtëzakonshëm kur, më datë 9 nëntor, 4 Fuqitë e Mëdha: Anglia, Franca, Italia dhe Japonia, morën dy vendime të rëndësishme në favor të Shqipërisë: së pari, njohën Pavarësinë dhe Sovranitetin e Shqipërisë, duke rikonfirmuar njëkohësisht edhe kufinj të vendosur në Konferencën e Ambasadorëve, (me përjashtim të Vermoshit dhe Shën Naumit), dhe, së dyti, ia besuan Italisë mbrojtjen e paprekshmërisë së kufinjve territorialë, deri në të drejtën për ndërhyrje të armatosur për mbrojtjen e tyre në rast nevojë...

Megjithatë, ky sukses diplomatik dhe politik nuk e mbrojti dot Qeverinë-Evangjeli, sepse Hasan Prishtina, nën inkurajimin e mbështetësve të tij, e detyroi Evangjelin të jepte dorëheqje duke i vënë koburen në kokë dhe, në mungesë të deputetëve, (që ishin me pushime) – Hasan Prishtina kreu një grusht shteti të pastër.

Pas dorëheqjes së Evangjelit u krijua një qeveri nën kryesimin e Qazim Koculit, por ajo jetoi vetëm një ditë, (vetëm 24 orë), pasi u rrëzua nga Hasan Prishtina, i cili e kishte ndarë mendjen të bëhej kryeministër, qoftë edhe me dhunë.

Pas dorëheqjes së Koculit më datë 7 dhjetor, Këshilli i Lartë i Regjencës bëri një gafë trashanike kushtetuese në mes të parlamentit, sepse në vend që të propozonte kryeministrin dhe ta ngarkonte me formimin e qeverisë, bëri të kundërtën – emëroi ministrat, duke formuar një kabinet të jashtëligjshëm, sipas dëshirave të kryeministrit puçist Hasan Prishtina.

Ndërkohë Zogu po paqëtonte Mirditën, (tetor-nëntor 1921 – A.K.).

Grushti i Shtetit i detyroi deputetët dhe ministrat t’ia mbathnin për në Elbasan. Menjëherë u vendos një gjendje terrori. Brenda dy ditësh filluan protestat e deputetëve të zënë në befasi, të popullit, ushtarakëve dhe intelektualëve, që kërkonin njëzëri shkarkimin e Hasan Prishtinës. Ja si e përshkruan këtë situatë Mit’hat Frashëri në artikujt e botuar në (“Le Monde Nouveau” (boulevard Raspail, Paris), nga 15 gushti deri më 1 shtator 1922, botuar në librin “Fati i Shqipërisë”, faqe 179-180):

“... Ja ç’ka ndodhur me pak fjalë: Në muajin dhjetor 1921, një lloj grusht-shteti përmbysi qeverinë e Pandeli Evangjelit dhe vuri në pushtet Hasan Prishtinën. Dhoma e deputetëve ndodhej me pushime, por e gjithë popullsia manifestoi pakënaqësinë e vet. Funkionarët u hodhën në grevë dhe në tërë vendin u manifestua mosmiratimi...

Kabineti i Hasan Prishtinës ra brenda 4 ditëve, dhe me rikthimin e Dhomës erdhi në fuqi qeveria e tanishme, nën kryesinë e Xhaferr Ypit...”.

Deputetët e ikur në Elbasan, u njoftuan nga Zogu që “menjëherë të ktheheshin në krye të detyrës, të mos trembeshin nga asgjë dhe nga askush, por të bënin detyrën...”.

Mirëpo edhe kur u rimblodhën në parlament, deputetët e tmerruar thirrën sërish, si gjithmonë, Ahmet Zogun “për të stabilizuar situatën”, ndryshe ata “do të iknin...”.

Ndërkohë Zogu, (që po drejtonte operacionet ushtarake në Veri kundër serbëve, si komandant i Krahut Lindor), u nis menjëherë drejt kryeqytetit.

“Urdhri i parë i Hasan Prishtinës në krye të qeverisë ishte ai drejtuar Zogut, ku e urdhëronte

që t'ia dorëzonte Bajram Currit (në atë kohë komandant i operacioneve antiserbe në Krahun Perëndimor) komandën e Përgjithshme të Ushtrisë shqiptare. Këtë urdhër Zogu nuk e zbatoi, por sapo e urdhëroi parlamenti, Ai u nis menjëherë për në Tiranë, ku hyri më 17 dhjetor 1921”.

(J. Suajër “Albania”, faqe 379-380)

Parlamenti i filloi sërish punimet më 21 dhjetor. Akti i parë dhe më i rëndësishëm i deputetëve ishte rrëzimi i Këshillit të Lartë të Regjencës, me motivacionin “Për shkelje të Statutit Themeltar të Shtetit, pas emërimit arbitrar të Hasan Prishtinës dhe ministrave të Kabinetit të tij”. Gjithashtu, parlamenti mori vendimin për heqjen e mandateve të deputetëve bashkëfajtorë të Hasan Prishtinës, të cilët i etiketoi “komplotistë”.

Parlamenti ngarkoi z.Xhaferr Ypi për formimin e kabinetit, dhe kryeministri, më 24 dhjetor, emëroi menjëherë Zogun në postin e rëndësishëm të ministrit të Brendshëm.

Me të marrë detyrën, Zogu ndërmori masa energjike për stabilizimin e rendit, duke filluar nga çarmatimi i popullatës, çka siguroi qetësinë brenda pak ditësh.

Në një letër drejtuar At Paulin Margjokajt, antizogisti Mustafa Kruja, për Zogun dhe situatën e vendit pas dështimit të Grushtit të Shtetit të Dhjetorit 1921, thekson: “...Kur them se rolin kryesor në Partinë Popullore e luante Klika, Eminenca gri e saj ishte Zogu..., që kishte një zgjuarsë të pakrahasueshme në raport me shokët”.

(Letërkëmbimi i Mustafa Krujës me At Paulin Margjokajn, njëri nga autorët e Historisë së Shqipërisë).

Ja si u përgatitën ushtarakisht “puçistët” në Dhjetor 1921

Më 21 dhjetor 1921, pas rrëzimit të qeverisë së Hasan Prishtinës dhe kthimit të Zogut në Tiranë me kërkesën e deputetëve të parlamentit, Hasan Prishtina dhe besnikë të tij i bënë një letër Elez Isufit, me përmbajtjen e mëposhtme:

“Të nderçmit zotit Elez Isufi në Dibër! Ahmet Zogu me anëtarët e vet, në parlament e përjashta, kanë vendosun me formue një qeveri për me ndjekun rreptësisht të tanë kundërshtarët. Na jemi tue qëndrue si burrat e do të qëndrojmë deri në vdekje, sadopak që të jetë fuqia jonë. Ahmeti po mbështetet mbi Meleq Frashërin, Shefqet Korçën...

Parlamenti, tue kujtue se Ahmeti e ka fuqinë në dorë e tue pas frikë që të mos qesë ngatërresa, duket se ka me ja dëgjue të tana dëshirat. Prandaj e shofim shumë të nevojshme që zotnija jote, sa më shpejt e me sa ma shumë fuqi, të mundesh të nisësh e të vish për Tiranë për me ja mbushun mendjen parlamentit se fuqinë nuk e ka Ahmet Zogu. Përndryshe kanë me na ndodhë shumë punëra të liga...

Për Bajram Begun s’dimë gja fare se ku gjendet. Nëqoftëse e keni asaj ane, merruni vesh edhe me zotërinë e tij. Por ama shpejt.

Me nderime: Hoxha Kadriu, Mustafa Kruja, Kristo Dako, Ramiz Daci, Ibrahim Gjoci, Osman Lita, Hasan Prishtina, Riza Dani, Isuf Xhelili, Hysen Efendiu, Dan Cami.

Tiranë, më 21 dhjetor 1921”.

(A.Q.Sh. faqe 84, Elez Isufi, viti 1921, dosja 56).

Hoxha Kadriu pohon Grushtin e Shtetit

Në kujtimet e tij të shkruara për ngjarjet e Dhjetorit 1921, ndonëse i redaktuar, censuruar dhe transliteruar nga Nevila Nika, një ndër protagonistët më aktivë të Grushtit të Shtetit, Hoxha Kadriu, na sjell të gjalla zhvillimet dramatike të atyre ditëve. Ai shkruan tekstualisht: “Midis Qazim Koculit dhe anëtarëve të Këshillit të Naltë (regjencës – A.K.), Aqif Pashës dhe MonsinJOR Bumçit në njërën anë dhe, në anën tjetër, me Hasan Prishtinën, Mustafa Krujën, Ramiz Dacin, Zija Dibrën, Ahmet Daklin e Riza Danin, ishte arritur një marrëveshje për të gjetur mënyrën se si do t’i propozonin Pandeli Evangjelit që të jepte dorëheqjen. Për këtë

arsye, Zija Dibra ishte larguar nga Ministria e Punëve Botore dhe kabineti i Evangjelit kish mbetur me Bajram Fevziun si ministër i Brendshëm. Qazim Koculi pranoi të bëhet ministër i Luftës.

Hasan Prishtina, Mustafa Kruja dhe Ramiz Daci..., të përcjellur prej dibranëve të armatosur, shkojnë në Hotel 'Internacional' për t'i dhënë një zgjidhje të shpejtë kësaj çështjeje.

Kapiten Osman Gazepi vazhdonte me demonstrimin e tij të forcës, me urdhër të Mustafa Maksudit. Dibranët e armatosur përgjohin para Hotelit 'Internacional'.

Kur erdha para Hotel 'Europa', takova Mustafa Krujën. E pyeta për gjendjen dhe m'u përgjigj: 'Klika ka shtyrë në kryengritje ushtrinë, gjindarmërinë, policinë dhe nënpunësit...

Flitet se Ahmet Zogu do ta sulmojë Tiranën nga Mirdita, por nuk besoj! Ka frikë dhe ruhet se mos i bijnë nga mbrapa fuqitë e Bajram Currit dhe të Elez Isufit...".

Për fatin e tyre të keq dhe të shqiptarëve, (sepse Grushti i Shtetit la pasoja të rënda dhe krijoi precedentin e paligjshmërisë, që inkurajoi rebelimin pas tre muajsh dhe "revolucionin" pas 18 muajsh) - puçistët që ju mbronin z.Myftaraj - duke sulmuar Zogun - kishin vendosur të merrnin me çdo kusht dhe çdo çmim pushtetin, teksa përfituan nga mungesa e Tij në Tiranë.

Akoma pa ardhur Elez Isufi, i paduruari për pushtet, kreu i puçistëve Hasan Prishtina, e detyroi Pandeli Evangjelin, me kobure në kokë, për të dhënë dorëheqjen.

Rotacion normal qeveritar mund të sjellë një dorëheqje e tillë z.Myftaraj?!!

Si e vlerësoni ju faktin e largimit nën panik të deputetëve të tmerruar drejt Elbasanit? Kaq burracakë thua të kenë qenë ata burra guximtarë, që bënë aq shumë për Shqipërinë?!

Jo z.Myftaraj? Ata u larguan për të mos shkuar për dhjamë qeni nga armët vrastare, thjesht sepse puçistët dëshironin të lanin hesapet me kundërshtarët, pasi të merrnin pushtetin.

Ndryshe përse do të duhej Zogu në Tiranë, (thirrur nga deputetët), dhe Elez Isufi, Bajram Curri e Halit Lleshi (thirrur nga puçistët)?!

E përse të mos nisej Zogu drejt Tiranës, nëse e thërrisnin kolegët deputetë për të stabilizuar rendin(?), apo Ai duhej vetëm për të luftuar me armiqtë!!! Përse Zogu duhet t'ia dorëzonte komandën e trupave Bajram Currit, që t'ia hanin kokën lehtësisht pasi të vetëçarmatosej, dhe pasi të bënte lojën e puçistëve??!

Por, për turpin dhe fatin e keq të puçistëve, zhvillimet e mëvonshme i përgënjeshtroan mashtrimet e tyre se "... Ahmet Zogu me anëtarët e vet, në parlament e përjashta, kanë vendosur me formue një qeveri për me ndjekun rreptësisht të tanë kundërshtarët...".

Po faktin që Qazim Koculi qëndroi vetëm një ditë kryeministër, sa për të motivuar puçin me "krizë qeveritare", dhe me "pamundësi për formim kabinet", përse e fsheh Nevila Nika z.Myftaraj, si mendoni ju? Përse kriza qeveritare duhej zgjidhur nëpër hotele nga puçistët e shoqëruar me "dibranë të armatosur", dhe jo në parlament, aq më tepër kur deputetët mungonin se ishin "me pushime"??!

A mund të quhet situatë normale ajo që e detyronte Osman Gazepin të "demonstronte forcë" pas urdhrimit të zv/ministrit të ligjshëm të Luftës, Mustafa Maksud, dhe kur, për kondrapeshë dhe presion, "... dibranët e armatosur përgjohin" dhe vigjëlonin "para Hotelit..."?!!

Nëse situatën do ta supozojmë "normale", përse puçistët kërkuan ndihmë ushtarake!!!

A mund të ishte normale situata z.Myftaraj, kur puçisti Mustafa Kruja i pohonte puçistit bashkëpunëtor Hoxha Kadriu që "Nuk besoj se Ahmet Zogu do ta sulmojë Tiranën nga Mirdita...Ka frikë dhe ruhet se mos i bijnë nga mbrapa fuqitë e Bajram Currit dhe të Elez Isufit..."?!!

Si mendoni ju z.Myftaraj, nga cilët rrezikohej rendi kushtetues, nga trupat ushtarake të shtetit, që synonin normalizimin e situatës, apo nga çetat e armatosura të civilëve që marshonin drejt kryeqytetit për të imponuar me forcën e armëve ndryshimet e qeverisjes, të bëra me anë të shkeljeve të Statutit dhe me kobure në kokë e kryeministrit të votuar nga parlamenti, dhe në mungesë të deputetëve??! Por ju nuk mund të përgjigjeni z.Myftaraj, sepse ky parashtrim i bazuar në fakte e ka përgjigjen të nënkuptuar. Ju vetëm akuzoni pa të drejtë Klikën dhe Ahmet Zogun për "dhunë...", duke fshehur dhe mbrojtur dhunuesit e vërtetë.

Vijon në numrin e ardhshëm...

"Atdheu", 9 janar.